

**Raportimi në interes të publikut -
Mbrojtja e parimeve etike të raportimit përmes
Komisionit të Ankesave dhe Parashtresave**



Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni
Bul. Mit. Teodosij Gologanov, 54/2 1000 Skopje
www.semm.mk / info@semm.mk tel. 02 3 222 595

Prof. Dr. Sefer Tahiri
Mirçe Adamçevski



Këshilli për etikë në mediat e Maqedonisë
Bul. Mit. Teodosij Gologanov, 54/2 1000 Skopje
www.semm.mk / info@semm.mk
tel. 02 3 222 595

Raportimi në interes të publikut - Mbrojtja e parimeve etike të raportimit përmes Komisionit të Ankesave dhe Parashtresave

Mars 2017

Autorë:

Prof. Dr. Sefer Tahiri dhe Mirçe Adamçevski

Titulli i origjinalit:

“Raportimi në interes të publikut -

Mbrojtja e parimeve etike të raportimit përmes Komisionit të Ankesave dhe Parashtresave”

Botues:

Këshilli i Etikës në Media

Autorë:

Prof. Dr. Sefer Tahiri

Mirçe Adamçevski

Redaktore:

Dr. Snezhana Tërpevska

Dizajni:

Myprint

Shtyp:

Myprint

Tirazh:

30

Përgatitja e këtij botimi u mundësua me mbështetjen e projektit „#ReforMedia – Avancimi i bashkëpunimit ndërmjet shoqërisë civile, institucioneve dhe qytetarëve për zbatimin e reformave në sferën mediatike” të cilin e zbatojnë Instituti Maqedonas për Media dhe Instituti Paqësor nga Lubjana. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e plotë e autorëve dhe e Këshillit për Etikë në Media, dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron qëndrimet e BE-së.

Përmbajtja

Hyrja	5
Parimet themelore të raportimit gazetaresk	7
Saktësia dhe verifikimi i informacioneve (Sefer Tahiri)	7
Gazetari duhet të bëjë dallimin midis fakteve dhe mendimeve (Mirçe Adamçevski)	12
Gazetaria në (jo) distancë politike (Sefer Tahiri)	18
Gazetari do ta respektojë privacinë e individit, përveç në rastet kur kjo është në kundërshtim me interesin publik. Gazetari është i detyruar të respektojë dhimbjen dhe zinë (Mirçe Adamçevski)	24
Gazetari nuk do të flasë me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë dhe diskriminim (Sefer Tahiri)	28
Gazetari do të ruajë reputacionin dhe dinjitetin e profesionit të vet, do ta nxis solidaritetin e ndërsjellë dhe diversitetin e qëndrimeve dhe nuk do ta përdor median e tij për qërim hesapesh me personalitete tjera, përfshirë edhe kolegët e tij (Mirçe Adamçevski)	34
Vendimet e Komisionit	39
Gazetari duhet të publikojë informacione të sakta dhe të verifikuara (neni 1) ..	39
Jane Dimeski për Kurir	
Ksenofon Ugrinovski për Slloboden Peçat	
Gazetari do ta respektojë privacinë e individit (neni 7)	45
Avokati i Popullit për portalet Republika, Press24, Kurir dhe Puls24	
Dushica Mërgja për Sitel (edicioni elektronik)	
Gazetari nuk do të flasë me gjuhën e urrejtjes (neni 10)	50
Koalicioni «Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të marginalizuara për Sitel 3»	
OSBE për Sitel	
Gazetari duhet të bëjë dallim midis fakteve dhe mendimeve (neni 13)	56
Mitko Andreevski për gazetën Veçer	
Jane Dimeski për Kurir	

Gazetari duhet të ketë distancë profesionale nga subjektet politike (neni 14)... 63

Lidija Dimova për Republikën

Artan Grubi për Tetova sot

Gazetari do të ruajë reputacionin dhe dinjitetin e profesionit të vet (neni 16)... 66

Branko Geroski për Kanal 5

Zoran Fidanovski për Netpres

Pasqyra e ankesave të dorëzuara deri te Komisioni i Ankesave.....70

Hyrje

Këshilli i Etikës në Media i Maqedonisë (KEMM) në prill të vitit 2017 shënoi vitin e tretë të ekzistimit të tij. Gjatë tre viteve të para, përpjekjet kryesore të KEMM ishin të orientuara ndaj etablimit të tij në opinionin publik dhe ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e gazetarisë etike dhe vetërregullimit.

Përmes punës së vet aktive, KEMM angazhohej për mbrojtjen e pavarësisë së mediave, njëkohësisht duke përkujtuar edhe përgjegjësinë e madhe që kanë për mbrojtjen dhe përmbushjen e interesit të publikut.

Në tentimet për të afirmuar vetërregullimin, KEMM në mënyrë të përkushtuar punoi për informimin e publikut, i cili gjithnjë e më shumë reagon ndaj rasteve të raportimit joprofesional në media. Në periudhën prej tre viteve deri te KEMM janë dorëzuar rreth 200 ankesa, ndërsa numri i ankesave ndryshon thuajse çdo ditë.

Për ankesat nga publiku lidhur me përmbajtjet e publikuara në mediat e shkruara, elektronike ose mediat onlajn vendos trupi këshillëdhënës i KEMM, Komisionit i Ankesave, që përbëhet nga shtatë anëtarë. Në punën e tij, anëtarët e Komisionit e shfrytëzojnë Kodin e gazetareve të Maqedonisë, Deklaratën për raportim etik, Deklaratën e parimeve të Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve dhe korniza e dokumente tjera etike që i përmbajnë normat e raportimit profesional. Përveç kësaj, KEMM është në komunikim të rregullt edhe me Aleancën e këshillave të pavarur të etikës në media në Evropë (AIPCE), anëtar i së cilit është nga tetori i vitit 2015 si dhe me Rrjetin rajonal të këshillave etike të medias MediaNethics, përvojat dhe rekomandimet e së cilit mundësojnë tejkalimin më të lehtë të sfidave në zhvillimin e vetërregullimit në vend.

Në tentim për të sublimuar punën e deritashme të Komisionit të Ankesave dhe vendimet e tij që t'i bëjë më të kapshme për opinionin publik, KEMM u përcaktua që të përgatisë këtë publikim, qëllimi i së cilit është të ofrojë vështrim mbi respektimin e disa prej parimeve themelore të etikës gazetareske dhe të ofrojë pasqyrë të vendimeve më karakteristike, të miratuara nga Komisioni.

Për shkak të vëllimit të madh të materialit, publikimi nuk ofron pasqyrë të gjitha vendimeve të Komisionit të Ankesave, por vetëm të atyre që lidhen me shkeljen e parimeve më të rëndësishme të raportimit gazetaresk. Pasqyrë më e detajuar e vendimeve mund të gjendet në faqen e internetit të KEMM www.semm.mk.

Shpresojmë që ky publikim do të kontribuojë ndaj kuptimit më të mirë të kulturës së vetërregullimit dhe ndaj ngritjes së nivelit të profesionalizmit, transparencës dhe llogaridhënies së mediave. KEMM edhe më tej do të vazhdojë të luajë rol aktiv në debatin publik lidhur me praktikën gazetareske dhe do ta përforcojë pozitën e tij në publik dhe në fushën e punës së mediave.

relation or
point of view.
Ethics [eth'iks
moral choices
value of huma
principles th
the what is

Parimet themelore të raportimit gazetaresk

Saktësia dhe verifikimi i informacioneve
Sefer Tahiri

1. Vërtetësia dhe saktësia- themel i profesionit gazetaresk

Mediat konsiderohen pushtet i katërt në shoqëritë bashkëkohore, përkaj pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor. Ata funksionojnë si “qeni- roje” i interesit publik, për të mirën e publikut përkatësisht qytetarëve. Vërtetësia dhe saktësia janë parime kulmore të gazetarisë dhe pikërisht nga ata varet se vallë një media është kredibile ose jo. Nga gazetarët pritet të japin informacione të sakta dhe gjithëpërfshirëse, në bazë të së cilave qytetarët do të miratojnë vendime. Redaktorët dhe gazetarët çdoherë duhet të kenë parasysh që besimi shumë vështirë arrihet dhe shumë lehtë humbet.

Saktësia është parim i vjetër aq sa është edhe gazetaria, përkatësisht mbi këtë parim mbështetet profesioni gazetaresk. Informacionet që transmetohen përmes mediave duhet të jenë përkatëse me realitetin, do të thotë duhet të jenë të vërteta, prandaj është shumë e rëndësishme që të verifikohen nga së paku dy burime, të cilat janë midis vete të pavarura. Prej këtu del se gazetarët kanë të drejtë të kërkojnë informacione, t’i publikojnë, por edhe në mënyrë kritike t’i analizojnë. Informacioni duhet të jetë i saktë dhe i verifikuar. Çdo element i lajmit (raportit, kronikës) patjetër të jetë i saktë: ngjarjet, datat, vendet, citatet dhe të ngjashme. Një gabim rreth një fakti mund të hedh hije ndaj gjithë shkrimit gazetaresk.

Saktësia nuk nënkupton vetëm plasimin e fakteve, ndërsa gazetarët nuk janë vetëm “transmitues” që fuqishëm respektojnë rregullin e pesë pyetjeve: “Kush?” “Çka?” “Kur?” “Ku?” “Pse?” (dhe pyetjen e gjashtë “Si?”). Gazetarët nuk janë vetëm grumbullues të lajmeve, por nga ata pritet të hulumtojnë, raportojnë objektivisht dhe saktë për atë që ndodh. Zgjedhja e fakteve patjetër të sigurojë informacion objektiv dhe shqyrtim të të gjitha aspekteve të rëndësishme të temës për të cilën flitet.

Sipas Kodit etik të gazetarëve në Maqedoni, detyrë themelore e gazetarëve është t’i respektojnë të vërtetën dhe të drejtën e publikut të jetë i informuar në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë¹.

1 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, *Kodi i gazetarëve të Maqedonisë, Parimet e sjelljes* (Shkup, SHGM:2001). I disponueshëm më 25.2.2017: http://znm.org.mk/?page_id=1412

2. Standardet e saktësisë si parim themelor gazetaresk

Njëri nga standardet kryesore në gazetari janë saktësia dhe preciziteti në informim nga ana e gazetarëve. Shpejtësia nuk duhet të jetë më e rëndësishme nga saktësia dhe preciziteti. Mediat nuk duhet të publikojnë ose transmetojnë ndonjë lajm ose raport pa bërë hulumtim rutinor dhe adekuat që ta verifikojnë besueshmërinë e tyre. Gjithashtu është e rëndësishme që të gjitha lajmet, raportet, por edhe llojet tjera të zhanreve gazetareske, të kenë numër të mjaftueshëm të burimeve, të bazohen mbi dëshmi të fuqishme, të jenë në mënyrë bazike të verifikuara dhe të prezantohen me gjuhë të qartë e precize. Gazetarët duhet të shmangin deklaratat dhe spekulime të pabaza dhe të tentojnë tu japin mundësi palëve që janë të përfshira në ngjarje, procese ose dukuri t'i shprehin ose t'i sqarojnë qëndrimet e tyre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur gazetari shfaq dyshime dhe akuza ose kur dikush është objekt i sulmit dhe kritikës. Përveç kësaj, nuk duhet të shtrembërohen ose t'i keqpërdorin deklaratat e dhëna lidhur me ngjarjen konkrete, për të cilën raportohet.

Nëse ndodhin gabime në raportim, ata duhet të pranohen dhe të korrighen sa më shpejtë që është e mundur, në mënyrë të qartë dhe adekuate. Pranimi i gabimeve është guxim, ndërsa fshehja e tyre është e papërputhshme me dinjitetin profesional. Prandaj, është e preferuar që gazetari dhe media të kërkojnë falje për gabimin.

Kjo është në nivelin e një rregulli- mediat duhet të publikojnë korrigjim të qartë dhe në vend të dukshëm të theksojnë se është publikuar informacion jo i saktë dhe i shtrembëruar, ndërsa nëse është e nevojshme duhet të kërkojnë falje.

Saktësia dhe verifikimi i informacioneve janë pjesë e pesë neneve të Kodit etik të gazetarëve të Maqedonisë. Interpretimi i këtyre neneve bazohet mbi Doracakun për etikë në gazetari, i publikuar në vitin 2012 nga Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë².

Në nenin 1 theksohet se nevoja të raportohet në periudhë sa më shpejtë kohore nuk duhet assesi t'i cenohet saktësinë, kredibilitetin dhe profesionalizmin e shkrimit/ kronikës.

Gazetari duhet të sigurojë palën e dytë, që nënkupton edhe verifikim sistematik të të gjitha fakteve në një shkrim/ kronikë. Publikimi i informacioneve që kanë statusin e "të besueshmeve" është i mundur vetëm kur gazetari është i sigurt se e drejta e publikut të jetë i informuar është më e rëndësishme se sa detyrimi për respektimin e besueshmërisë së informacioneve.

Sipas nenit 2, kur gazetari nuk merr përgjigje nga pushteti për pyetje që vlerëson se janë të interesit publik, duhet ta njoftojë publikun se është cenuar e

² Tamara Çausidid dhe Zoran Bojarosvki, *Doracaku për etikë në gazetari*, (Shkup: 2012), i disponueshëm më 12 shkurt 2017, <http://znm.org.mk/wpcontent/uploads/2016/03/Прирачник-за-етика-во-новинарството-мај-2012.pdf>

drejta e tij të jetë i informuar. Pushteti nuk guxon që t'i shmang temat dhe çështjet që janë në interes të publikut, prandaj gazetari duhet të këmbëngul të marrë përgjigje nga institucionet dhe zyrtarët, ndërsa për jotransparencën e tyre duhet në mënyrë kritike ta informojë publikun.

Neni 3 flet për përgjegjësinë morale të gazetarit për informacionin e pasaktë të publikuar. Prandaj, ky nen kërkon nga gazetari që vetë të këmbëngul të publikojë përgënjeshttrim, korrigjim ose përgjigje në median në të cilën është publikuar informacioni i pasaktë, autor i së cilit është ai. Në atë mënyrë, gazetari e mbron edhe integritetin e vet, por edhe integritetin e medias ku punon. Ata që kanë qenë objekt i sulmeve ose edhe kritikës patjetër duhet të kenë mundësi të përgjigjen para se shkrimi/ kronika të publikohet, ndërsa nëse kjo nuk ndodh dhe nëse përgjigja vjen pas publikimit, ai duhet të jetë në gjatësi të arsyeshme, në lidhshmëri me temën dhe në formë dinjitoze. Përgjigja e publikuar nuk duhet të përcillet me koment polemizues editorial.

Neni 4 ka të bëjë me citimin e burimeve. Burimi i informacionit sipas rregullit duhet të identifikohet, përveç në rastet kur kjo mund të ndikojë ndaj sigurisë së tij ose sigurisë së personave tjerë. Adresimi i gabuar i burimit ose imagjinimi i burimit me qëllim që të prezantohen informacione të pasakta, jo të plota dhe informacione që nuk janë mjaftueshëm të verifikuara, konsiderohen shkelje e rëndë e standardeve gazetareske.

Neni 5 i përkufizon temat e raportimit që janë të interesit publik. Ata janë informacione që mund të kontribuojnë në zbulimin e: veprës kriminale keqpërdorimi i pozitës nga ana e bartësve të funksioneve publike, cenimi i demokracisë, korrupsioni, rastet e padrejtësisë, shkelja e të drejtave të gazetarëve, diskriminimi, cenimi i shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, paaftësia dhe jokompetenca e zyrtarëve publik. Interesi publik gjithashtu përfshin edhe informacionet që u ndihmojnë njerëzve të miratojnë vendime të karakterit publik dhe pengojnë manipulimin e mashtrimin e popullatës me deklarata dhe veprime të individëve dhe organizatave.

3. Vendimet e Komisionit të Ankesave që lidhen me parimin e vërtetësisë dhe saktësisë

Nga 149 raste, për të cilat janë ankuar qytetarë dhe subjekte politike (parti politike, organizata joqeveritare, organizata ndërkombëtare), madje 143 ankesa kanë të bëjnë me raportimin e pasaktë ose të pavërtetë.³ Analiza e rasteve që kanë qenë objekt i shqyrtimit nga Komisioni tregon se në një numër të madh të shkrimeve gazetareske është shkelur neni 1 i Kodit përkatësisht konstatohet se “pala e dytë”

³ Në numrin më të madh të këtyre ankesave palët e prekura ankohen edhe ndaj shkeljeve tjera të Kodit të gazetarëve të Maqedonisë, siç janë gjuha e urrejtjes, shpifja dhe fyerja, diskriminimi, animi politik etj, por në këtë kontekst analizohet vetëm shkelja e parimit për raportimin e saktë dhe të vërtetë.

thujase nuk është e pranishme fare në shkrime, për të cilat palët ankohen. Është me rëndësi të theksohet se thujase të gjitha ankesat kanë të bëjnë me shkrimet gazetareske ose kronikat në të cilat shfaqen dyshime ose akuza ndaj ndonjë personi apo grupi të caktuar përkatësisht drejtohen fyerje ose sulme të tipit: tradhtarë, të paguar, shërbimet e huaja etj. Kështu, në shkrimin me titull *"Agjentët që marrin më shumë se sa vlejën"*, i publikuar në portalin onlajn *"Republika"* më 11 nëntor të vitit 2014, ndaj të cilit reagonte Lidija Dimova, atëherë deputete e LSDM-së, u konstatua se pohimet në shkrim aspak nuk i përgjigjen asaj që u ofrua si dëshmi kundër parashtruesit të ankesës dhe se ai përmban akuza të pabaza. Gjithashtu, edhe në tekstin me titull *"Sheqerinska bën spiunim tek sekretari i panjohur francez me prejardhje greke"*, i publikuar në portalin *Kurir* më 8 nëntor të vitit 2014, akuzohet nënkryetarja e LSDM-së, ndërsa e njëjta aspak nuk është kontaktuar.

Konkluzion i përgjithshëm është se në Maqedoni rënia e cilësisë së raportimit mediatic është pasojë para së gjithash e mospajimit të "palës së dytë" përkatësisht mosdhënies mundësi të gjitha palëve të prekura në shkrimin gazetaresk ta shprehin qëndrimin e tyre. Kjo është shkak jo vetëm për mosbalancimin, por edhe për pasaktësinë e raportimit mediatic, sepse rregulli themelor gazetaresk thotë që një informacion duhet të verifikohet nga së paku dy burime. Madje edhe kur bëhet fjalë për akuza të rënda, shkrimet nuk kanë palën e dytë. Në shkrimin me titull *"Maqedonia, peng e qefjeve të Vanhaute"*, i publikuar në portalin *Netpres* më 26.10.2015, është publikuar fotografi e parashtruesit të ankesës Angella Ilievska, nën të cilën qëndron teksti "Vallë Vanhaute shndërrohet në idhull të vërtetë për LSDM-në?". Në fakt, bëhet fjalë për fotografi nga takimi midis Angella Ilievskës dhe Vanhautes, e marrë nga profili personal i Fejsbukut dhe e njëjta është keqpërdorur rëndë. Shkrimi përmban fraza degraduese dhe diskriminuese për Angellën, ndërsa ajo nuk është kontaktuar që të japë qëndrimin e saj rreth fotografisë. Në fakt, në shkrim thuhet "Edhe pse Vanhaute është me agjendë të ngarkuar të aktiviteteve, megjithatë gjen kohë që të fotografohet me socialdemokrate të reja. Mbetet e hapur çështja se vallë kjo është për shkak të mëditjes së tij prej 900 eurove ose për shkak të pamjes së tij".

Gazetari nuk duhet ta ul nivelin e raportimit profesional dhe të lejojë që shkrimi gazetaresk të mbështetet në informacione të njëanshme sepse në këtë mënyrë krijon mundësi që qytetarëve tu ofrohen gjysmë të vërteta ose gënjeshtër të paketuara si lajme të verifikuara dhe të vërteta. Produktet gazetareske nuk janë të plota ose nuk janë gjithëpërfshirëse nëse nuk bazohen mbi së paku dy pikëpamje të pavarura ose kundërshtuese ose nëse nuk përmbajnë fakte. Me fjalë tjera nëse nuk përmbajnë këndvështrime tjera mbi një çështje, nuk mund të konsiderohen si të sakta dhe objektive. Shkrimin me titull *"Kryepeshkopi Stefan në tryezë të "yndyrshme"* në agjërime të rrepta?!, i publikuar më 8.1.2016 në portalin e internetit *Libertas*, autori e bazon mbi informacione nga një burim anonim, por në atë shkrim nuk ka edhe një burim tjetër, i cili do të konfirmonte saktësinë dhe vërtetësinë e informacionit.

Është e rëndësishme të theksohet se mediat shpesh ballafaqohen me jotransparencën e institucioneve, kështuqë në disa raste të këtilla “pala e dytë” ndoshta nuk sigurohet për shkak të faktit se gazetarët nuk kanë pasur qasje deri te më shumë palë, para seë gjithash për shkak të jotransparencës së institucioneve. Më tej, nuk është i vogël numri i konferencave të shtypit në të cilat ftoheshin vetëm një pjesë e mediave përkatësisht vetëm ata që mbështetnin pushtetin.

Kodi i gazetarëve të Maqedonisë në nenin 4 parashikon se gazetarët mund të shfrytëzojnë burime anonime të informimit në shkrimet e tyre, kur nuk janë në gjendje në mënyrë eksplicite të prezantojnë burimin që përfaqëson pikëpamje tjetër. Por në praktikën gazetareske, formulimi keqpërdoret. Në fakt burimet anonime shpesh shfrytëzohen për publikimin e spekulimeve, në vend që të sigurohet informim gjithëpërfshirës ose i plotë i publikut për aspektet e ndryshme të çështjes.

Kjo është praktikë veçanërisht në një pjesë të mediave onlajn, për të cilat për një kohë të shkurtër vërtetohet se kanë publikuar gjysmë të vërteta ose gënjeshtër. Fakti që midis shkelësve më të mëdhenj janë mediat onlajn tregon tendencën e degradimit profesional dhe keqpërdorimit të lirisë së transmetimit të informacioneve përmes internetit për shkak të publikimit të të pavërtetave, gjysmë të vërtetave ose spekulimeve. Lehtësia dhe çmimi i ulët i përdorimit të internetit si platformë për informim lejojnë përhapjen e të gjitha informacioneve në internet.

Përderisa një numër i madh i informacioneve të disponuara iu lejon njerëzve t’i zgjerojnë horizontet e tyre të informimit dhe dijes, një pjesë e madhe e gazetarëve që punojnë në mediat informative onlajn vendore të plasojnë informacione të pasakta, konstruksione, por edhe gënjeshtër, me qëllim që ta manipulojnë publikun për shkak të interesave politike ose interesave tjera.

Sipas Kodit, përgjithësisht duhet të shmangët praktika e tërheqjes së një përmbajtjeje të publikuar në internet, ndërsa nëse ajo ndryshon ose hiqet, kjo duhet të shënohet qartë. Në praktikë, shpesh për shkak të presionit politik, kërcënimeve me padi për shpifje dhe fyerje dhe shumë shpesh edhe për shkak të korrupsionit të disa mediave onlajn, plotësisht fshihen përmbajtjet që janë publikuar. Nuk janë pas edhe mediat tradicionale, veçanërisht televizionet komerciale që janë proqeveritare, të cilat duke u vënë në shërbim të partisë politike në pushtet-VMRO- DPMNE, e jo në shërbim të interesit publik, shpesh harrojnë parimet për saktësi dhe verifikimin e informacioneve.

Gazetari duhet të bëjë dallim midis fakteve dhe mendimeve, midis lajmit dhe komentit

Mirçe Adamçevski

1. Për dallimin midis mendimit dhe faktit

Përzjerja e lajmit me komentin është njëri ndër problemet më të mëdha dhe më të shpeshtë në gazetari. Gjithashtu si mosdallimi midis faktit dhe mendimit. Sipas dëmit të tyre, kjo është e afërt me gënjeshtren, heshtjen e informacioneve, informimin jo të drejtë dhe manipulimin. Me këtë rrënohen të gjitha normat profesionale dhe etike, të parashikuara me kodekset gazetareske.

Në thelb, fakti është ajo që mundet të konfirmohet në mënyrë të pakontestueshme dhe të pahamendur. Gjatë vërtetimit të faktit, e nevojshme është qasja objektive, e cila patjetër duhet të mbështetet me dëshmi ekzakte. Në vërtetimin e fakteve nuk duhet të përzihet qëndrimi personal ose çfarëdo paragjykimi. Duke pasur parasysh se gazetarët kanë të drejtë të kenë qëndrim dhe mendim, një element shumë i rëndësishëm në punën e tyre është paanshmëria. Për shkak të mbrojtjes së saj, mendimet, qëndrimet, komentet në kronikat gazetareske duhet të ndahen qartë nga faktet.⁴

Gazetarët, si dhe çdo individ ka të drejtën e mendimit. Kanë të drejtë të shprehin qëndrim dhe gjykim vlerësues, por nuk duhet të tentojnë që mendimin e tyre ta kamuflojnë si fakt. Problemi tek gazetarët tanë, siç tregon përvoja e punës së Komisionit të Ankesave të KEMM, më shpesh është të shprehin mendime, të pambështetura me fakte ose shprehin mendime të huaja të “porositura”, që “shitën” si personale, por edhe këtu përsëritet gabimi- mosmbështetja me fakte. Ata në shprehjen e mendimeve. qoftë përmes komentit, vështrimit por edhe ndonjë zhanri tjetër gazetaresk, nuk mbajnë llogari për lajmin.

Kjo vërehet tek të gjitha llojet e mediave. Gazetarët sikur kanë harruar se “gazetaria bazohet mbi lajmin”⁵, se duhet patjetër tu përgjigjet pesë pyetjeve gazetareske: kush, çka, kur, ku dhe pse, por edhe pyetjes si, por edhe se pikërisht lajmi është fakti më i rëndësishëm, mbi të cilin bazohen komentet. Dhe pikërisht për shkak të qasjes së këtillë ndaj produktit gazetaresk kemi komentet, në të cilat nuk ka aspak lajm. Kjo dominon në mediat onlajn. Në këtë media shpesh punësohen gazetarë të rinj, të cilët ndonjëherë kanë dëshirë të flaktë të komentojnë pa lajme dhe pa fakte. Për shkak të kësaj, në këto media shpesh kemi komente pa lajme, të cilat thuajse janë vepër e ndonjë pune “kolektive”, jashtë redaksive të tyre.

4 “Kampanju za medijsku pismenost”, Medijska pismenost, i disponueshëm më 11 shkurt 2017, <http://www.medijskapismenost.net//>

5 Dubravka Valić Nedeljković, *Novinarski zanrovi*, (Novi Sad: Novinarska skola), i disponueshëm më 13 janar 2017, <http://novinarska-skola.org.rs/vodic/zanrovi/Novinarski%20zanrovi.pdf>

Në zhanret gazetareske komenti shkurt përkufizohet si “qëndrim personal i gazetarit i mbështetur me fakte”⁶. Rëndësia themelore e komentit është interpretimi dhe sqarimi i asaj që nuk shihet, që është nën sipërfaqe. Konsiderohet se me komentin jetësohet vlera më e lartë e shprehjes gazetareske. Për komentin është i nevojshëm argumentimi i mirë dhe “gjuha e fortë”. Gazetari i shfrytëzon ngjarjet ekzistuese, lajmet, faktet ose dokumentet, ligjet, vendimet, librat me qëllim që në mënyrë të popullarizuar t’ia sqarojë temën opinionit më të gjerë. Gjatë krijimit të komentit vjen në shprehje stili gazetaresk përkatësisht mjeshtëria e gazetarit gjatë kumtimit të fakteve, e interpretimit të tyre në mënyrë më interesante, ndërsa me fond të pasur të fjalëve të inkorporojë atraktivitet në shkrim. Pikërisht për këtë thuhet se është e nevojshme “gjuha e fortë gazetareske”. Komenti në thelb është interpretativ, por ndonjëherë është me strukturë më të rëndë dhe atëherë flasim për koment kritik, polemizues dhe analitik. Komenti analitik ka strukturë më të thelluar të kumtimit të qëndrimit në publik, duke ndriçuar aspekte të më shumë palëve për ngjarjen, për të cilën flitet. Analiza ndërtohet në bazë të njohurive paraprake dhe më pas merret qëndrim ndaj shkakut, për shkak të së cilit shkruhet vetë komenti.⁷

Për koment të suksesshëm është me rëndësi të reagohet shpejt, të jesh aktual dhe konkret. Pika nismëtare për të janë lajmet dhe raportet. Komenti duhet të japë përgjigje për atë që qëndron pas këtyre lajmeve, të vë në pah shkaqet dhe t’i parashikojë ngjarjet e ardhshme, të lidhura me atë që përmban ndonjë lajm. Ndërsa çdo lajm bazohet tek fakti. Nëse nuk ka fakt, nuk ka lajm.

2. Nuk ka fakte, nuk ka lajme, por ka mendime dhe komente!

Por praktika nuk e konfirmon atë që është thënë më sipër. Gazetarët më shumë dëshirojnë të komentojnë se sa të ofrojnë informacion të vërtetë. Dhe përziejnë gjithçka. Edhe lajm, edhe koment, por edhe fakte dhe mendime. Nga praktika e Komisionit të Ankesave pranë KEMM shihet se gazetarët me vetëdije, kuptohet jo të gjithë, por pjesa më e madhe e tyre, ndaj të cilëve janë parashtruar ankesa, nuk bëjnë dallimin midis fakteve dhe mendimeve, lajmit dhe komentit. Vendimet e Komisionit të Ankesave pranë KEMM tregojnë se ky lloj i shkeljes së etikës dhe profesionalizmit është i pranishëm menjëherë pas shkeljes së parimit për vërtetësi dhe saktësi përkatësisht prezantimit të pikëpamjeve të së paku dy palëve.

Neni 13 i Kodit të gazetarëve thotë: Gazetari duhet të bëjë dallim midis fakteve dhe mendimeve, midis lajmit dhe komentit⁸. Prej këtu edhe përshtypja se në

6 “Kampanju za medijsku pismenost”, Medijska pismenost, i disponueshëm më 11 shkurt 2017, <http://www.medijskapismenost.net/>

7 Zoran Bojarovski, Branko Geroski dhe tjerë, Зоран Бојаровски, Бранко Героски и др., *Të shkruarit për mediat e shkuara*, (Shkup, Instituti Maqedonas i Medias, 2005), fq.75

8 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, *Kodi i gazetarëve të Maqedonisë, Parimet e sjelljes* (Shkup, SHGM:2001). I disponueshëm më 25.2.2017: http://znm.org.mk/?page_id=1412

raste të këtilla nuk mund të flitet për profesionalizëm, por për raportim tendencioz me ndonjë prapavijë tjetër, e cila shpesh mund të jetë politike ose bëhet fjalë për ndikim ose varshmëri nga qendrat e fuqisë politike dhe ekonomike.

Shkrimtari dhe dramaturgu gjerman Zigmund Graf thotë: “Njëra nga dukuritë më të çuditshme është se gënjejemi se nga njerëzit e varur mund të presim mendim të pavarur”. Dhe me të vërtetë nuk ka asgjë më të keqe për gazetarinë profesionale se sa gazetari i varur. I varur nga pronari i medias, nga redaktori ose ndonjë fuqi politike ose fuqi tjetër.

Sipas Kodit të parimeve gazetareske të Belgjikës, “faktet patjetër duhet të grumbullohen dhe për to patjetër duhet të raportohet pa paragjykime”⁹ Gjithashtu thuhet se “Ndarja e fakteve me të cilat raportohet nga komenti patjetër duhet të jetë e dukshme. Ky parim nuk duhet ta pengojë gazetarin/median që t’i prezantojë mendimet e tij e as mendimet e të tjerëve.”¹⁰

Kodi kombëtar i sjelljes në Danimarkë, sa i përket kësaj çështjeje, ka një fjali të shkurtër: “Faktet duhet të ndahen nga komenti”¹¹.

Kodi etik i shoqatave gazetareske të Polonisë thekson: “parimi i ndarjes së informacionit nga komenti, do të thotë që struktura e porosisë është e tillë që i mundëson pranuesit qartë t’i ndajë faktet nga qëndrimet dhe mendimet.”¹²

Supozim është se në Maqedoni numri më i madh i gazetarëve janë arsimuar në studimet e gazetarisë dhe se e dinë se ku përfundon lajmi dhe ku fillon komenti. Shumë është keq nëse nuk e dinë këtë. Ky është defekt profesional i gazetarit. Nuk di mjaftueshëm, vlerëson gabimisht se çfarë është fakt i vërtetë dhe çfarë është lajm. Ose se gazetari me vetëdije ose pa të bie nën ndikimin e pronarëve mediatik, redaktorëve, por edhe bashkëbiseduesve- politikanë ose biznesmenë të fuqishëm. Gjithashtu në këto raste ka edhe probleme etike. Paraqitet animi, njëanshmëria, tendencioziteti. Harrohet se gazetari duhet të punojë profesionalisht dhe duhet tu shmangët të gjitha llojeve të presioneve.

Gazetarët, si edhe të gjithë njerëzit tjerë kanë bindje, qëndrime dhe mendime. Por publiku meriton raportim të bazuar mbi faktet dhe mbi analizën e mbështetur me informacione. Për këtë, qëndrimet dhe mendimet e gazetarit nuk guxojnë të ndikojnë mbi standardet e informimit të publikut, veçanërisht për tema, ngjarje dhe dukuri që janë me karakter konfliktuoz. Që të ofrojnë mbulim të plotë dhe kredibil të lajmeve dhe ngjarjeve, gazetarët patjetër duhet t’i lënë anash

9 Stevan Niksic, Ana Davico, *Etika novinarstva - Prirucnik za profesionalne novinare*, (Beograd, CPM> 2004), I disponueshëm më 11 janar, 2017 <https://www.scribd.com/document/26507848/Etika-novinarstva>

10 ibid

11 EthicNet, *The National Code of Conduct - Denmark*, i disponueshëm më 1 shkurt 2017, http://ethicnet.uta.fi/denmark/the_national_code_of_conduct

12 Stevan Niksic, Ana Davico, *Etika novinarstva - Prirucnik za profesionalne novinare*, (Beograd, CPM> 2004), I disponueshëm më 11 janar, 2017 <https://www.scribd.com/document/26507848/Etika-novinarstva><https://www.scribd.com/document/26507848/Etika-novinarstva>

pikëpamjet dhe perspektivat e tyre. Thjesht me pasqyrimin e një spektri të gjerë të qëndrimeve dhe mendimeve, gazetarët duhet të ofrojnë fotografinë e vërtetë për atë se çfarë në të vërtetë ndodh. Prandaj është e rëndësishme që në raportimin e tyre gazetarët të ofrojnë peshë përkatëse dhe përfaqësim të qëndrimeve dhe mendimeve të grupeve të ndryshme në shoqëri.¹³

3. Vendimet e Komisionit të Ankesave lidhur me nenin 13

Prej rreth 150 vendimeve të Komisionit të miratuara për shkeljen e etikës gazetareske, madje në 74 është konstatuar shkelja e parimit, e përcaktuar në nenin 13, për atë se *gazetari duhet të bëjë dallim midis fakteve dhe mendimeve, midis lajmit dhe komentit*.

Numri i madh i shkeljeve të këtij parimi flet për nevojën e edukimit të gazetarëve, ndërsa ndoshta edhe të vetë redaksive në tërësi së bashku me redaktorët, që lejojnë sjellje joetike.

Në rastin *Dimova për Republikën*, Komisioni i Ankesave diskutoi për parashtrësën e zonjës Lidija Dimova për një tekst të publikuar në edicionin onlajn të revistës *"Republika"* me titull *"Agjentë që marrin më shumë se sa meritojnë"*. Dimova në ankesë shkruan se "Shkrimi është i pasaktë, përmban gënjeshtra tendencioze dhe me këtë është dëmtuar reputacioni i saj si njeri, deputete e opozitës, por edhe ka frikë për sigurinë e saj...". Në përgjigjen e kryeredaktores së edicionit onlajn të revistës *"Republika"*, Biljana Zafirova thuhet se në shkrim janë shfrytëzuar deklaratat dhe fotografi të personave të apostrofuara dhe se "gazetarët kanë të drejtë të ngrenë dilema dhe çështje për dukuri që janë të rëndësishme për shoqërinë...Kujt i konvenon plasimi i informacioneve (të cilat doli se nuk janë të vërteta) që nuk janë në interes të Maqedonisë..."

Dhe me të vërtetë, mediat duhet të ngrenë çështje, por edhe të kërkojnë e të japin përgjigje të paanshme. Gjatë kësaj duhet të shmangët manipulimi me publikun në kërkim të përgjigjeve. Dhe pikërisht këtë e konstatoi Komisioni i Ankesave. Si ndryshe të vlerësohen pjesët e shkrimit në të cilin thuhet: "Ky është grupi i gazetarëve, analistëve politikë nga vendi që punojnë për secilin, por jo vetëm për vendin e tyre. Dikush redaktor, dikush tjetër analist politik, të gjithë me qëllim të njëjtë- të jenë të fokusuar në dy çështje që gjithsesi se nuk i sjellin asgjë pozitive vendit. Janë fokusuar në dy punë: si ta pështyjnë vendin jashtë dhe ta rrenojnë imazhin e tij dhe ta komprometojnë shtetin përmes kontestit me Greqinë fqinje, duke i ulur pozicionet e vendit të tyre. Për dy punë që janë në fokusin e tyre, pyetja është e njëjtë: Kujt i përgjigjet kjo?" Por shtrohet pyetja i kujt është ky mendim? I gazetarit? Ose komentit se: "Pështyjnë mbi gjithçka që është maqedonase, anko-hen në gjithçka që bëhet në Maqedoni. Mungon qëndrim i vërtetë argumentuar.

13 "Kampanju za medijsku pismenost", Medijska pismenost, i disponueshëm më 11 shkurt 2017, <http://www.medijskapismenost.net/>

Gjithçka reduktohet në ankesa për njëfarë regjimi, njëfarë diktature dhe robërie. Qëndrojnë pas çdo hapi që ndërmerret që Maqedonia të shkojë përpara, punojnë për interesa të huaja, shkelin mbi pozicionin e Maqedonisë... Por vallë këta agjentë marrin më shumë se sa meritojnë?!”

Gazetarët kanë detyrim që lajmet dhe informacionet t’i trajtojnë me paanshmëri përkatëse, tu japin peshë përkatëse ngjarjeve, qëndrimeve dhe mendimeve por edhe anëve kryesore të storjes. Lajmet duhet të bazohen mbi fakte, të cilat janë të verifikuara dhe të dëshmuara. Të jesh i paanshëm gjatë plasimit të lajmeve dhe informacioneve, do të thotë të përjashtohet çfarëdo qasje ose mendim personal ose i huaj i imponuar në formësimin e tyre dhe publikut t’i lihet të vije deri tek konkluzionet.

Në rastin Transparensi Interneshenëll (TIM) për portalin *Zhurnal.mk*, organizata dorëzoi ankesë për shkrimin: *“Skandal: Ambasada e Holandës dhe Transparensi Interneshenëll, i diskriminojnë shqiptarët dhe mediat shqiptare në Maqedoni?!“*.

Sipas ankuesit, bëhet fjalë për raportim jo korrekt dhe jo i saktë, për disa “informacione të pavërteta që TIM i diskriminon shqiptarët dhe mediat shqiptare”, si dhe për atë se përmbajtjet nuk publikohen edhe në gjuhën shqipe. Komisioni pranoi ankesën. Gjatë shqyrtimit të saj u vërtetua se portali shkruan: “Kjo ambasadë (holandeze), e cila promovon vlera të larta të demokracisë evropiane, nuk e pa të arsyeshme që projektet që financohen për të mirën e qytetarëve të Maqedonisë, t’i bëjë të kapshëm edhe për publikun, lexuesin dhe shikuesin shqiptar.”

Pastaj shkruhet se “Fushata e fundit e organizatës TIM... është dëshmi e qartë se bëhet diskriminim i skajshëm ndaj qytetarëve shqiptarë”. Komisioni vërtetoi se e nënvizuara më lartë është dezinformim dhe manipulim i publikut. Mediat dhe gazetarët kanë të drejtën e mendimit të vet, por supozimet ose qëndrimi i autorit duhet t’i përjashtojnë manipulimet. Nuk mundet që mendimi personal të ofrohet si fakt.

Parimet e sjelljes së gazetarëve të përcaktuara me Kodin e gazetarëve të Maqedonisë e theksojnë të drejtën e gazetarëve të komentojnë dhe të kumtojnë informacione, ide dhe mendime. por ata gjithashtu theksojnë se e drejtë dhe detyrim i gazetarëve është që të pengojnë censurën dhe shtrembërimin e lajmeve¹⁴. Më tej në kod thuhet edhe se duke i respektuar vlerat etike dhe standardet profesionale në transmetimin e informacioneve, gazetarët duhet të jenë të ndershëm, objektivë (...) dhe të saktë.¹⁵

Gazetarët kanë të drejtë të kenë mendimin e tyre, qëndrimin ose gjykimin vlerësues, por nuk guxojnë që mendimin e tyre ta kamuflojnë si fakt. Patjetër duhet të jetë i qartësuar kufiri se çfarë janë fakte dhe çfarë janë informacione e çfarë është koment, supozim ose qëndrim i autorit që të mund të shmanget dezinformimi dhe manipulimi me publikun.

14 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, *Kodi i gazetarëve të Maqedonisë, Parimet e sjelljes* (Shkup, SHGM:2001). I disponueshëm më 25.2.2017: http://znm.org.mk/?page_id=1412

15 ibid

Në rastin LGBTI dhe të tjerët për portalin *Puls 24*, Qendra LGBTI për Mbështetje, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë dhe Koalicioni “Të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive Margjinale” dorëzuan ankesë deri te Komisioni i Ankesave për shkrimin me titull “Komuniteti LGBTI, organizator i protestave para Gjykatës Kushtetuese së bashku me LSDM-në dhe SOROS”, i publikuar në portalin e internetit *Puls24* (www.puls24.mk). Në ankesë thuhet se shkrimi përmban diskriminim dhe gjuhë të urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI, duke e prezantuar si “kërcënim për vlerat tradicionale maqedonase dhe si bashkësi që tenton shkatërrimin e shtetit përkatësisht rendit shtetëror dhe kushtetues”. Komisioni e pranoi ankesën si të bazuar. Autori i panjohur i shkrimit, pa asnjë fakt, konfirmon se komuniteti LGBT është organizator i protestave dhe pyet se vallë me këtë bashkim “LGBT, LSDM dhe SOROS dëshirojnë t’i shkelin vlerat tradicionale maqedonase”. Shtohet edhe se “qytetarët që i respektojnë vlerat tradicionale janë të tmerruar nga ky bashkim...qytetarët thonë se LGBT ka shumë të drejta në vend, por nuk kanë të drejtë ta shkatërrojnë shtetin dhe Kushtetutën dhe më së paku të përzihen në punën e Gjykatës Kushtetuese”. Cilët qytetarë? Në shkrim nuk ka asnjë fjalë nga ndonjë qytetar e lëre më qytetarët, si fakt për mbështetjen e pohimeve. Nuk është bërë asnjë hulumtim që i dëshmon qëndrimet e autorit të shkrimit për komunitetin LGBTI, i cili do të ishte shkas për komentim.



Reformat nuk siguruan paanshmëri politike të mediave

Sot, sistemi mediatik funksionon në kuadër të kornizës së përcaktuar institucionale, sipas së cilës mediat, veçanërisht ato elektronike, funksionojnë si të mëvetëshme, subjekte të pavarura sipas rregullave të demokracisë parlamentare dhe ligjshmërisë së ekonomisë së tregut. Të gjithë radiodifuzuesit, komerciale ose publike, nuk mund të jenë në “duart e ndonjë subjekti politik”. Por, edhe përkundër këtij fakti, situata reale tregon qartë se gjenden mënyra që radiodifuzuesit të instrumentalizohen politikisht.

Shembuj për anshmëri partiake të mediave janë komentet editoriale të cilat rekomandojnë mbështetje të ndonjë partie politike. Por, ekziston edhe propagandë e njëanshme, e cila vihet re në raportimin i cili përfaqëson një palë të caktuar politike dhe pikëpamje të caktuara. Shembujt e këtillë janë të shumtë, ndërsa Komisionit i janë drejtuar politikanë të cilët janë ankuar për raportim të njëanshëm, pa u respektuar Kodi i gazetarëve. Këta shembuj tregojnë se në praktikë partitë politike vazhdimisht gjejnë mënyra për të ndikuar ndaj politikës editoriale të mediave.

Pothuajse nuk ka media, posaçërisht ato që transmetojnë program informativ, të cilat nuk vërehet mbështetje ndaj një opsioni të caktuar politik, ndërsa disa të tjera as që tentojnë ta fshehin një gjë të tillë. Edhe qytetarët e zakonshëm e dinë cili grup, apo cili individ qëndron pas një stacioni të caktuar televiziv apo radioje. Politikanët i shfrytëzojnë mediat për qëllimet e tyre politike, ndërsa pronarët si njëra palë ashtu dhe tjetra (politikanët dhe mediat) për qëllimet e tyre korporative.¹⁶

Që nga formimi, e deri më sot mediat elektronike (dhe pronarët e tyre e gazetarët që punojnë në to) në vazhdimësi ndodhen në fokusin e betejave politike midis pushtetit dhe opozitës, duke mos arritur të luftojnë për autonomi në fushën mediatike, përkatësisht për pavarësi nga politika. Fakti që një pjesë e madhe e mediave janë të lidhura me subjekte politike e konfirmon tezën se mediat elektronike fillimisht janë mjet për arritjen e qëllimeve politike dhe artikullimin e interesave politike. Edhe përkundër faktit që normat ligjore radiodifuzive përmbajnë masa për mbrojtjen e mediave dhe gazetarëve nga lloje të ndryshme të ndikimit të grupeve ose individëve, praktika tregon se partitë politike (veçanërisht ato të

¹⁶ Open Society Institute EU Monitoring and Advocacy Program, *Television across Europe: regulation, policy and independence* (Budapest: 2005), i disponueshëm më 15 февруари 2017, https://www.opensocietyfoundations.org/sites/default/files/summary_20051011.pdf

pushtetit, të cilat shfrytëzojnë autorizimet shtetërore) kanë arritur ta imponojnë kontrollin e tyre ndaj televizioneve komerciale. Kjo, sidomos është e dukshme nga ndikimi që bëjnë pronarët e stacioneve më të mëdha televizive ndaj politikës së tyre editoriale. Ato në vazhdimësi i shfrytëzojnë mediat e tyre, jo vetëm për mbështetjen e bizneseve personale, por edhe për promovim personal politik.

Struktura pronësore e televizioneve komerciale është faktori kyç, i cili tregon dhe dëshmon se ekziston lidhje direkte e partive politike dhe një pjesë të mediave komerciale, veçanërisht televizioneve. Fakti që një pjesë e madhe e pronarëve të televizioneve komerciale, përkatësisht pjesëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, janë politikisht aktiv, është indikator për varshmërinë politike të gazetarëve dhe redaktorëve të këtyre mediave. Ka një numër të madh të hulumtimeve dhe shkrime të cilat qartë tregojnë se ata “diktojnë” se çfarë do të transmetohet në program.

Nuk mund të flitet për pavarësi të televizioneve komerciale, kur një numër i madh i pronarëve (ose pjesëtarë të familjes së tyre të ngushtë) janë aktiv politikisht, ndërsa në periudha të ndryshme kanë pasur ose kanë pozicione të rëndësishme në Qeveri ose Kuvend. Kjo, padyshim do të thotë se ata në raportimin televiziv në plan të parë i vënë interesat e subjekteve politike të cilave u takojnë.

Edhe përkundër faktit që edhe Kushtetuta edhe ligjet (të harmonizuara me standardet ndërkombëtare) garantojnë pavarësi editoriale nga partitë politike dhe institucionet shtetërore, te disa televizione komerciale dhe portale ekziston një mbështetje e heshtur, ndërsa te një pjesë mbështetje e hapur ndaj opsioneve të caktuara politike. Kjo vërehet përmes përfaqësimit të një opsioni/ partie politike dhe aktivitetet e saj (qëndrime, aksione, nisma, propozime dhe të ngjashme) në programet informative të televizioneve komerciale.

2. Kodi përcakton distancën e gazetarëve nga subjektet politike

Këshilli i Evropës i rekomandon vendeve anëtare që t’i inkurajojnë organizatat mediatike që në mënyrë vullnetare t’i përforcojnë pavarësinë editoriale dhe gazetareske përmes dokumenteve në redaksitë e tyre ose përmes masave të tjera vetërregulluese. Në Maqedoni akt vet-rrregullues është Kodi i Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë. Në të, në pjesën për parimet e sjelljes theksohet:

„Detyrë dhe e drejtë e gazetarëve është të këmbëngulin ta pengojnë censurën dhe ta pengojnë shtrembërimin e lajmeve. Duke e ndjekur rolin e tyre në ndërtimin e demokracisë dhe shoqërisë civile, gazetarët do t’i mbrojnë të drejtat e njeriut, dinjitetin dhe lirinë, do ta respektojnë pluralizmin e ideve dhe qëndrimeve, do të kontribuojnë për përforcimin e shtetit të së drejtës dhe për kontrollimin e pushtetit dhe të subjekteve të tjera të jetës publike“.

Më tej, në pikën 10 të Kodit rregullohet çështja e diskriminimit politik.

„Gazetari me vetëdije nuk do të krijojë e as do të përpunojë informacione të cilat i rrezikojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk do të flasë me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë dhe diskriminim mbi çfarëdo qoftë baze (kombëtare, fetare, racore, gjinore, sociale, gjuhësore, të orientimit seksual, politike...)“.

Lidhur me politikën dhe ndikimin e partive politike, në pikën 14 të Kodit thuhet: *„Raportimi nga proceset politike, veçanërisht nga zgjedhjet, duhet të jetë i paanshëm dhe i balancuar. Gazetari duhet të sigurojë distancë profesionale nga subjektet politike“.*

Në interpretimin për zbatimin e këtij parimi, në Doracakun për etikë në gazetari¹⁷ theksohet se mediat dhe gazetarët e kanë për detyrë në mënyrë kritike t'i ndjekin proceset politike dhe përdorimin e fuqisë politike dhe ekonomike, që në vete nënkupton se ata duhet të vendosin kufij ose distancë në komunikimin me subjektet politike dhe të pamundësojnë çfarëdo lloj ndikimi të tyre. Gjithashtu, theksohet se ekziston dallim thelbësor dhe mospërputhshmëri midis profesionit gazetaresk e propagandës politike dhe në këtë drejtim gazetarët janë të detyruar të bëjnë dallimin e qartë midis raportimit gazetaresk dhe komunikimit politik.

Në përcaktimet përmbyllëse të Kodit të Shoqatës së Gazetarëve të Maqedonisë theksohet: *„...gazetarët do ta pranojnë gjyqin sa i përket profesionit vetëm nga kolegët e tyre dhe do të jenë jashtë ndikimit politik dhe çfarëdo qoftë tjetër ndikimi“.*

Siç mund të konkludohet, Kodi i gazetarëve të Maqedonisë i përshkruan qartë standardet profesionale dhe etike gazetareske dhe normat si mekanizëm mbrojtës i profesionit gazetaresk. Megjithatë, njohuritë nga praktikat paralajmërojnë për mospërputhje midis normatives dhe reales.

3. Mediat me mision ideologjik- politik

Lajmet në televizione shpesh nga aspekti përmbajtësor i ngjajnë njëri tjetrit. Shkrimet propaganduese, me përmbajtje të njëjtë dhe me paralajmërime të njëjta mund të ndiqen në lajmet e mbrëmjes në të gjitha televizionet pro-qeveritare. Dhe kjo nuk ndodh vetëm me televizionet, por edhe me shumë portale. Shpeshherë mund të lexohen informacione njëdimensionale, përkatësisht lajme e raporte të cilat fillojnë dhe përfundojnë me sukseset e pushtetit. Shpeshherë në një kronikë mund të shihen nga tre analistë të cilët e demonizojnë opozitën dhe i arsyetojnë hapat e pushtetit.

17 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, *Kodi i gazetarëve të Maqedonisë, Parimet e sjelljes* (Shkuo, SHGM:2001). I disponueshëm më 25.2.2017: http://znm.org.mk/?page_id=1412

Programet informative, në tërësi bazohen në ngjarje që ndodhin gjatë ditës, ndërsa roli i gazetarëve është të vlerësojnë se cilat nga ato ngjarje ose tema është e interesit publik. Por, në lajmet e më shumë mediave vërehet se shmangen temat e interesit publik, ndërsa fokusi vihet te aktivitetet protokollare dhe promovuese të zyrtarëve të pushtetit. Për fat të keq, jo vetëm mediat komerciale, por, edhe shërbimi radiodifuziv publik shpeshherë i shkel standardet profesionale, të cilat përcaktojnë se gazetaria profesionale duhet në mënyrë kritike t'i ndjek politikat e pushtetit dhe të sigurojë balancim në raportimin për aktorët e ndryshëm politik dhe grupet.

Çfarë mund të jetë garanci për politikë të pavarur editoriale të medias, përkatësisht që ajo të jetë në nivelin më të lartë profesional? Njëra nga mënyrat është përpunimi i "modelit" në të cilin mediat dhe opinioni do të mësojnë në mënyrë kritike ta observojnë dhe ta prezantojnë realitetin shoqëror (veçanërisht atë që ndodh në skenën politike) dhe në këtë mënyrë aktivisht të kontribuojnë në procesin e krijimit dhe zbatimit të politikave për të gjitha çështjet dhe problemet e karakterit publik. Në momentin kur mediat do ta tejkalojnë komunikimin e njëanshëm, përkatësisht do të mundësojnë sistem participues, i cili do t'u mundësojë qytetarëve në mënyrë aktive të ndikojnë ndaj politikave publike, atëherë ato do të bëjnë një hap drejt realizimit të idealit demokratik- komunikim të dyanshëm në sferën publike. Kjo do të thotë se mediat (veçanërisht shërbimi publik) përveç që kanë detyrë që shikuesve t'u sigurojnë lajme objektive dhe skemë të llojllojshme programore, janë të detyruar që në programet e tyre informative të sigurojnë hapësirë për shprehje të lirë të mendimeve dhe bindjeve të qytetarëve dhe organizatave qytetare. Përveç kësaj, mediat janë të detyruara në mënyrë reale t'i tregojnë ngjarjet me trajtim të barabartë të qasjeve të ndryshme e mendimeve dhe nxitjen e formimit të lirë të mendimit për ngjarje e çështje të ndryshme.

4. Vendimet e Komisionit të Ankesave të lidhura me paanshmërinë politike

Komisioni i Ankesave në kuadër të Këshillit të etikës në media në Maqedoni shpeshherë ka zgjidhur lëndë në të cilat konstatohet se është shkelur Kodi i gazetarëve, në bazë të diskriminimit politik ose mos-balancimit politik. Në Komision kanë arritur 11 parashtresa të qytetarëve ose politikanëve, të cilët ankohen ndaj mediave të cilat kanë informuar në mënyrë të njëanshme, nuk e kanë siguruar palën e dytë ose pa bazë kanë fyer apo kanë akuzuar politikanë ose gazetarë. Të tillë janë, për shembull rastet *Lidija Dimova për republika.mk*, *Radmilla Sheqerinska për kurir.mk dhe media të tjera*, *Geroski për Kanal 5*, *Davkova dhe Vankovska për Alsat M*, në të clat paraqiten kritika dhe akuza nga ana e mediave ndaj personave të lartpërmendur, por ato nuk janë konsultuar fare, që në fakt është praktikë e keqe, sepse në shumë media ka vetëm një palë.

Në rastin *Dimova për Republika*, ish deputetja nga radhët e LSDM-së ankohej ndaj shkrimit të publikuar në median onlajn *Republika* me titull: "Agjentët marrin më shumë se sa meritojnë". Sipas saj, teksti është tendencioz dhe e prish reputacionin e saj si deputete dhe si njeri. Komisioni i Ankesave, vendosi se Republika e ka shkelur Kodin e Gazetarëve të Maqedonisë, ndërsa në mesin e neneve të shkelura është edhe neni 10, sipas të cilit gazetari me vetëdije nuk do të krijojë dhe nuk do të përpunojë informacione, të cilat nxisin diskriminim mbi baza politike. Komisioni konstatoi se teksti është përplot me fyerje dhe diskualifikime personale ndaj deputetes Dimova, ndërsa gazetarët duhet të jenë të përgjegjshëm për fjalën e thënë publike.

Në rastin *Sheqerinska për Kurir dhe disa media online*, Radmilla Sheqerinska deputete dhe zëvendëskryetare e LSDM-së, dërgoi ankesë për tekstet e publikuara në median onlajn *Kurir* me titull: „Sheqerinska e spiunon Maqedoninë te zyrtari i panjohur francez me prejardhje greke“ dhe „Me diplomatët grekë, LSDM-ja vazhdon të punojë kundër Maqedonisë“, nga autori i panjohur, ndërsa u publikuan më 8 dhe 10 nëntor të vitit 2014. Sheqerinska ankohej edhe ndaj mediave onlajn Netpress, Press24, Deneshen, Fallanga, Vistina, të cilët e publikuan tekstin e parë. Edhe në këtë rast, Komisioni vendosi se është shkelur Kodi i gazetarëve në disa nene, në mesin e tyre edhe neni 10. Për këtë rast, Komisioni vendosi se media dhe gazetari nuk duhet të publikojnë material (informacion, foto, mendim, koment) që ka për qëllim të përhap armiqësi dhe urrejtje, ose ku ekziston mundësi e madhe se materiali do të shkaktojë armiqësi ose urrejtje ndaj secilit, për shkak të racës, përkatësisë etnike, gjinisë, fesë, përkatësisë politike, orientimit seksual, të metave fizike, etj.

Në rastin *Geroski për Kanal 5*, bëhet fjalë për ankesë të parashtruar nga kryeredaktori i portalit *Plusinfo* dhe gazetës *Sloboden Peçat*, Branko Geroski për intervistën e Lidija Bogatinovës me Ivica Bocevskin, e transmetuar në lajmet e televizionit Kanal 5 më 13 nëntor të vitit 2014. Ankesa është pranuar, ndërsa Kodi i gazetarëve të Maqedonisë është shkelur në nenet 10, 11 dhe 16. Në ankesë thuhet se në intervistë janë publikuar kualifikime fyese dhe shpifëse për Geroskin, pa u paraqitur kurrfarë dëshmish dhe me qëllim të qartë të shkaktohet dëm ndaj personalitetit dhe nderit të tij. Në rastin konkret bëhet fjalë për deklarin e redaktore Bogatinova: "Deri ku do të shkojë ky manipulim me vetëdije me interesat e Maqedonisë, kur edhe vet Venizelos pardje deklaroi se nuk do të ketë kurrfarë lëvizje në negociatat për emrin deri në zgjedhje? A do të thotë se Geroski është grek më i madh se Venizelos?" Geroski, gjithashtu thekson se në fund të intervistës Bogatinova flet për „...ata lluma që tentojnë të prishin pozicionet e Maqedonisë në negociatat për emrin". Komisioni veçanërisht e theksoi mos-pranimin e fyerjeve nga ana e bashkëbiseduesit në intervistë. Kjo konsiderohet si përgjegjësi e gazetarit, i cili është përgjegjës edhe për fjalën e thënë nga bashkëbiseduesit, sepse përmes tij, qëndrimet dalin në opinion dhe për këtë është i detyruar të distancohet nga gjuha fyese, promovimi i stereotipeve apo diskriminimi politik.

Rasti *Siljanovska dhe Vankovska për Alsat M* përfundoi me marrëveshje midis palëve pas ndërmjetësimit nga ana e Zyrës ekzekutive të Këshillit të Etikës. Në Komisionin për Ankesa kishte mbërritur ankesë nga profesoreshat Gordana Siljanovska- Davkova dhe Biljana Vankovska, të cilat ankoheshin për rubrikën “Sabotazha” në emisionin 360 gradë, e transmetuar në 10 prill të vitit 2015. Siç theksuan profesoreshat, në këtë rubrikë gazetari bën konstruksion dhe lidhje kauzale midis dy ngjarjeve të cilat nuk kanë as lidhje kohore e as thelbësore dhe lë të kuptohet se dy profesoreshat janë të përmendura si persona që me kërkesë të ministres së Punëve të Brendshme kanë dhënë “shërbime” dhe janë “nxjerrë nga krevati për ta punuar me urdhër të dikujt”. Theksohet se edhe në kronikë janë shfrytëzuar pamje nga paraqitja mediatike e profesoreshave në mënyrë selektive. Me kërkesë të profesoreshave, redaksia e emisionit 360 gradë kërkoi falje, ndërsa kronika ishte tërhequr nga kanali Youtube i Alsat M dhe nga profili i autorit Sreqko Popovski në Fejsbuk.



Gazetari nuk do flasë me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë dhe diskriminim

Sefer Tahiri

1. Gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi në media

Parandalimi ose kufizimi i gjuhës së urrejtjes përkatësisht kontrolli ose vetëkontrolli i mediave dhe aktorëve të përfshirë në produksionin mediatik, në kuptimin e përhapjes së këtyre porosive nuk do të thotë kufizim i lirisë së shprehjes. Një thënie e njohur thotë "Nuk ka liri për armiqtë e lirisë".

Kjo do të thotë se liria e shprehjes nuk është absolute përkatësisht se ajo mund të kufizohet kur dikush do ta keqpërdor që t'i shkel; të drejtat e të tjerëve në shoqëri ose do t'i cenojë disa qëllime të verifikuara legjitime të interesit publik. Duke pasur parasysh se gjuha e urrejtjes mund të nxisë dhunë, por mund të shpie edhe drejt diskriminimit, të nxisë ose të arsyetojë ksenofobi, antisemitizëm ose forma tjera të jotolerancës, konsiderohet se nevoja e kufizimit është legjitime dhe e arsyeshme që të pamundësohet keqpërdorimi i lirisë së shprehjes dhe shkejla e të drejtave të tjetrit.

Analiza e Shkollës për Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun për raportimin e mediave për tema sensitive etnike¹⁸ tregon se në dy dekadat e kaluara dhe në gjysmën e dekadës së fundit në Maqedoni u vërejtën numër i madh i shembujve të raportimit të pavëmendshëm ose të qëllimshëm, në të cilin mungon ndjeshmëria për marrëdhëniet ndëretnike, ndërkulturore dhe ndërfetare në shoqërinë e Maqedonisë.

Vallë mediat janë kreative të gjuhës së urrejtjes? Në disa situata të caktuara mund të kualifikohen si të tilla, por ata më shumë janë kanal ose instrument për përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit, e promovuar nga partitë politike, pushteti, institucionet dhe disa grupe radikale shoqërore. Pikërisht për këtë, shpesh theksohet se mediat kanë përgjegjësi dhe duhet të jenë të kujdesshme që të mos prodhojnë dhe transmetojnë porosi të gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit. Në të kundërtën, ata kontribuojnë për përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe krijojnë klimë të volitshme që kjo gjuhë të fitojë në intensitet. Gazetarët, redaktorët dhe veçanërisht kryeredaktorët, që janë kreatorë të politikës redaktuese në një media të caktuar janë përgjegjës për përmbajtjet e publikuara në media, kanë përgjegjësi të madhe para publikut, sepse gjuha e urrejtjes dhe shprehjet që përmbajnë elemente të saj kanë ndikim të dëmshëm nëse përhapen përmes mediave.

18 Vesna Shopar, redaktore, *Raportimi për tensionet ndërreligjioze dhe ndëretnike: rëndësia pas titujve*, (Shkup: Shkolla e Lartë për Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun, 2013), i disponueshëm më 2 shkurt, 2017, <http://www.unescochair-vs.edu.mk/attach/Znacenjeto-zad-naslovite.pdf>

Gazetarët çdoherë shkruajnë për diversitetet, për dallime që bazohen në përkatësinë etnike, religjionin, racën, gjininë, orientimin seksual, prejardhjen sociale etj.

Duke u nisur nga ky fakt, mediat kur shkruajnë për tema sensitive shoqërore mundet qëllimisht ose pa qëllim të shkaktojnë urrejtje. Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve me Kodeks të veçantë etik¹⁹ i obligon gazetarët që të mbajnë llogari për humanizmin dhe mbrojtjen e të drejtave njerëzore. Kjo do të thotë se nga gazetari dhe redaktori pritet vetëdije për përgjegjlsinë e punës së tij. Gazetari duhet të jetë moral, por edhe i motivuar tu shërbejë dësgjuesve, shikuesve dhe demokracisë.

2. Çfarë parashikon Kodi i gazetarëve të Maqedonisë?

Sipas nenit 10 të Kodit të Gazetarëve në Maqedoni, gazetari nuk ka të drejtë në shkrimet e tij të përdor gjuhë të urrejtjes ose të nxisë dhunë e diskriminim mbi çfarëdo baze. Në Doracakun e etikës në gazetari jepet interpretimi plotësues dhe kahe për zbatimin e këtij neni. Thuhet madje se gazetarët duhet të kenë kujdes kur gjuha e urrejtjes vjen veçanërisht nga personalitete publike ose përfaqësues të institucioneve publike dhe në situata të këtilla duhet ta kontestojnë ose ta kritikojnë gjuhën e këtillë dhe jo vetëm ta përcjellin. Gjithashtu thuhet se forma dhe zhanri, në të cilin mund të paraqitet gjuha e urrejtjes mund të jetë e ndryshme (informacion, fotografi, mendim, koment). Pa dallim se si është forma ose zhanri, gazetari duhet patjetër të vlerësojë se vallë ekziston probabilitet se me publikimin e tyre mund të “shkaktohet armiqësi ose urrejtje ndaj dikujt për shkak të racës, përkatësisë etnike, gjinisë, fesë, përkatësisë politike, orientimit seksual, të metave fizike etj.”²⁰

Mediat në përgjithësi, duhet të përmbahen nga publikimi i çfarëdo forme të gjuhës së urrejtjes përkatësisht gazetarët dhe redaktorët nuk duhet vetë të jenë autorë të porosive të tilla. Ata nuk duhet as të reprodukojnë gjuhë të urrejtjes, por kjo nuk do të thotë se nuk duhet aspak të raportojnë për situatat kur gjuha e urrejtjes vjen nga goja e aktorëve shoqërorë. Në situata të këtilla është veçanërisht e rëndësishme të identifikohet gjuha e urrejtjes tek aktorët tjerë dhe t’i bëjnë me dije publikut implikimet e mundshme nga shfrytëzimi i një gjuhe të këtillë.

Këtu parasëgjithash mendohet për politikanët, deklaratat dhe intervistat e tyre, veçanërisht për porositë e drejtpërdrejta që përmbajnë gjuhë të urrejtjes.

Gazetarët dhe redaktorët duhet të jenë shumë të kujdesshëm dhe selektivë kur bëhet fjalë për porosi që përmbajnë gjuhë të drejtpërdrejt të urrejtjes, për sh-

19 International Federation of Journalists, *IFJ Declaration of Principles on the Conduct of Journalists*, (Bordeaux: International Federation of Journalists, 1954), i disponueshëm më 3 shkurt 2017, <http://www.ifj.org/about-ifj/ifj-code-of-principles/>

20 Tamara Čausidis dhe Zoran Bojarovski, *Doracku për etikë në gazetari*, (Shkup: 2012), i disponueshëm më 12 shkurt 2017, <http://znm.org.mk/wpcontent/uploads/2016/03/Прирачник-за-етика-во-новинарството-мај-2012.pdf>

kak të faktit që Maqedonia është nënqijll me specifika etnike dhe fetare. Për këtë flasin rastet e ndërtimit të kishës- përkujtimore në Kalanë e Shkupit në vitin 2012, protestat kundër deklaratave të politikanëve për vrasjet që ndodhën tek Liqeni i Smillkovës, vokabulari i ish ministres Jankullovska në bisedat e përgjuara, të publikuara nga opozita, parullat dhe porosinë e theksuara gjatë protestave dhe kundër-protestave politike etj.

Redaktorët duhet të jenë të kujdesshëm jo vetëm në raport me gjuhën e drejtpërdrejt të urrejtjes në formë të qëndrimeve zyrtare ose mendimeve personale të politikanëve ose personaliteteve publike, por edhe në rastet kur kjo gjuhë përdoret edhe nga publiku. Kjo para së gjithash ka të bëjë me komentet e lexuesve që publikohen në mediat onlajn. Ngjashëm si me rubrikën "Letrat e lexuesve" në gazeta, edhe këtu roli i redaktorëve është shumë i rëndësishëm. Në fakt, mediat onlajn, si edhe mediat tradicionale, kanë përgjegjësi që të mos publikojnë komente që i tejkalojnë kufijtë e kritikës publike dhe që përmbajnë porosi eksplicite të gjuhës së urrejtjes.

Për këtë qëllim redaktorët duhet çdo ditë të angazhohen ta organizojnë punën e mediave me qëllim që të pengohet publikimi i porosive të gjuhës së urrejtjes. Ata nuk duhet të jenë vetëm përzgjedhës të zakonshëm të informacioneve që i grumbullojnë gazetarët dhe nuk duhet të lejojnë që media të shndërrohet në transmetues i zakonshëm i deklaratave të politikanëve që përdorin diskurs etnonacionalist dhe agresiv propagandistik. Shembuj të këtillë mund të gjejmë shpesh në mediat proqeveritare: "Tradhëtarë nga të cilët Maqedonia është e sulmuar dhe për shkak të këtij fakti mund të vijë deri te luftërat vëllavrasëse"²¹ ose "Qelbësira për të cilët nevojitet pllaka e betonit" etj.

Shembull karakteristik është deklarata e Milenko Nedelkovskit, autor i emisionit "Milenko Nedelkovski show" në TV Kanal 5, e dhënë në cilësinë e anëtarit të organizatës joqeveritare Lëvizja Qytetare për Mbrojtjen e Maqedonisë e njohur në opinionin maqedonas si GDOM në bisedë të drejtpërdrejt në TV Sitel. Në këtë rast kemi pasur lëshim nga ana e redaktorit të lajmeve në Sitel, i cili kërkoi falje vetëm pasi bashkëbiseduesi thjesht e zbrazi "arsenalin" e tij të fjalëve fyese para kamerës. Kur flitet për lidhje të drejtpërdrejt në radioprograme ose programe televizive, redaktorët përkatësisht moderatorët e emisioneve nevojitet të ndërpresin përdorimin e këtij fjalori. E njëjta duhet të ndodh edhe atëherë kur gazetari raporton në transmetimet e drejtpërdrejta të ngjarjeve siç janë protestat, demonstratat ose trazirat. Kur papritmas do të paraqitet gjuhë e urrejtjes në situatat e këtilla, gazetari duhet menjëherë të ndërhyjë, të distancohet në mënyrë të qartë ose të ndërpresë bashkëbiseduesin.

21 Mkdnews, Pandov: Republika e Maqedonisë është sulmuar nga tradhtarë dhe spiunë vendas në bashkëpunim me shërbimin e huaj, i disponueshëm më 7 prill, 2015, <http://www.mkdnews.com/2015/04/pandovrepublika-makedonija-e-napadnata-od-domashni-predavnici-i-shpioni-vosorabotka-so-stranska-sluzhba/>

3. Vendimet e Komisionit të Ankesave pranë Këshillit të Etikës në Media në Maqedoni

Një numër i madh i qytetarëve dhe subjekteve ankohen nga prania e gjuhës së urrejtjes në përmbajtjet mediatike. Komisioni ka shqyrtuar 56 nga 149 raste, në të cilat konstatohet se është shkelur neni 10. Më shpesh bëhet fjalë për gjuhë të urrejtjes mbi bazën e orientimit seksual dhe mbi bazën e përcaktimit politik të individëve dhe grupeve të prekura. Më së shpeshti gjuha e urrejtjes shfrytëzohet nga mediat onlajn dhe nga disa gazetarë që janë autorë emisionesh.

Ekziston fushatë e fuqishme mediatike, e mbështetur nga pushteti, cak i së cilës janë mediat dhe gazetarët kritikë, të cilat trajtohen si tradhtarë, veçanërisht ata që mbështeten nga Sorosi dhe fondacionet e huaja. Në këtë fushatë të orkestruar, të cilën e zhvillojnë gazetarët, por edhe disa media, shfrytëzohet gjuhë e drejtpërdrejt e urrejtjes, shpifje, kërcënime, thirrje për linçim publik etj.

Në rastin Jovanovski për Televizionin Kanal 5, gazetari Borjan Jovanovski reagoi ndaj edicionit të ditë televiziv të *Kanal 5* të datës 14 dhjetor të vitit 2014. Sipas tij, bëhet fjalë për kronikë në të cilën “në mënyrë skajshmërisht joprofesionale dhe joetike vihet në pikëpyetje integriteti profesional, si dhe integriteti i disa kolegëve tjerë. Komisioni konstatoi se bëhet fjalë për kronikë televizive me zhanër të papërcaktuar, koment ose diçka tjetër. Poashtu konstatoi se ka shumë citate, të cilat nuk dihet se kur janë thënë. Në kronikën televizive manipulohet me deklaratat. Komisioni konstatoi se në kronikë është shkelur neni 19, veçanërisht në pjesën e cenimit të drejtave dhe lirive njerëzore si dhe nxitjes së urrejtjes për shkak të qëndrimeve politike, sepse televizioni ka publikuar postime të Twitterit dhe një link që shpie tek një shkrim tjetër, prej të cilit dalin konkluzione se gazetari i përmendur bën aktivitete kundër interesave shtetërore.

Në rastin Cvetkovska për *Vest*, gazetarja Sashka Cvetkovska reagoi ndaj shkrimit me titull “Dramë dashurie në Zhelezarë të Shkupit- ka rrahur të dashurën dhe gjysmëlakuriqe e ka nxjerrë në rrugë”, i publikuar më 24 janar të vitit 2017 në gazetën ditore *Vest*, shkrim që u paralajmërua edhe në ballinë. Në arsyetimin e ankesës theksohet se bëhet fjalë për storje tabloide në të cilën për gruan e kësaj shoqërie raportohet në mënyrë seksiste, diskriminuese dhe diskredituese. Në ankesë theksohet edhe se shkrimi në mënyrë suptile sugjeron pabarazi gjinore përmes diskreditimit dhe diskualifikimit personal të viktimës. Komisioni e pranoi ankesën dhe konstatoi se në shkrim janë përdorur fraza që përmbajnë konotacione seksiste, stereotipizuese dhe diskriminuese, duke mos marrë parasysh se bëhet fjalë për ndonjë tragjedi familjare.

Gazetari do të respektojë privacinë e personalitetit, përveç kur kjo është në kundërshtim me interesin publik. Gazetari është i detyruar të respektojë dhimbjen dhe zinë personale.

Mirçe Adamçevski

1. Çfarë është privacia?

Ku përfundon privacia dhe ku fillon interesi publik dhe e kundërta? Kjo çështje është dilemë e përhershme gazetareske. Fakt është se privaten nga publikja e ndan thujse një kufi i panjohur, i cili shpejt tejkalohet, qoftë me arsye ose jo.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Themelore e mbron të drejtën e respektimit të privacisë (neni 8) dhe të drejtën e lirisë së shprehjes (neni 10), si liri dhe të drejta themelore njerëzore. Asnjëra nga ato dy të drejta nuk është absolute, që do të thotë se mund të kufizohen për shkak të mbrojtjes së ndonjë të drejte ose interesi tjetër. Kështu, e drejta e respektimit të privacisë mund të kufizohet nëse interesi publik e arsyeton shkeljen e privacisë. Gjithashtu edhe liria e shprehjes mund të kufizohet për shkak të mbrojtjes së ndonjë jete personale ose familjare nëse nuk ekziston interes dominues politik.²²

Nocioni privaci, edhe atë shumë gjerë është përkufizuar në Rezolutën nr. 428 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës²³ nga viti 1970.

E drejta e respektimit të privacisë para së gjithash bazohet mbi të drejtën e çdo individit që të jetojë jetën e tij me përzierjen minimale të të tjerëve.

Kjo ka të bëjë me jetën private dhe familjen, integritetin moral dhe fizik, nderin dhe reputacionin, shmangien që individit të prezantohet në dritë jo të vërtetë, publikimi i fakteve jorelevante dhe të pakëndshme, publikimi i paautorizuar i fotografive private, mbrojtja nga spiunimi dhe vëzhgimi i paarsyeshëm, mbrojtja nga keqpërdorimi i komunikimeve private, mbrojtja nga zbulimi i informacioneve të dhëna ose të pranuar në besueshmëri. Disa thonë që jeta private është manifestimi i vërtetë i parimit të lirisë së individit, përderisa për të tjerët ai është burim i të drejtave subjektive të llojit të veçantë, i të drejtave të personit.²⁴

Problem i veçantë është privacia e personaliteteve publike. Edhe ata kanë të drejtën e mbrojtjes së privacisë së tyre, por në masë shumë më të vogël se sa per-

22 Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut*, (Strazbur: Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, 2017), i disponueshëm më 1 prill 2017, http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf

23 Council of Europe, Parliamentary Assembly, *Declaration on Mass Communication Media and Human Rights*, (Strasbourg, 1970), <http://assembly.coe.int/nw/xml/Xref/Xref-XML2HTML-EN.asp?fileid=15842&lang=en>

24 Snezhana Terpevska, Liria e shprehjes dhe rregullimi mediatik, (Shkolla e Lartë për Gazetari dhe Marrëdhënie me Publikun, Shkup: 2010)

sonat që nuk janë të njohur në publik. Në Rezolutën nr, 1165 nga viti 1988 për të drejtën e privacisë qartë është theksuar se personat publik patjetër duhet të jenë të vetëdijshëm për pozitën që kanë në shoqëri, prandaj automatikisht kjo shpie drejt interesit të zmadhuar të publikut për privacinë e tyre.²⁵

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në të gjitha lëndët, që kanë të bëjnë me të drejtat e privacisë dhe lirisë së shprehjes këmbëngul të gjejë dhe vendos baraspeshë midis tyre. Ndryshe sa i përket mediave, këtu nuk ka hamendje. E drejta e qytetarëve për informim transparent dhe objektiv nënkupton edhe raportimin për privacinë e personaliteteve publike, veçanërisht për politikanët ose persona tjerë publikë, kur për këtë ekziston interes publik. Mediat janë të obliguara ta mbrojnë dhe ta promovojnë interesin publik, përkatësisht t'i shërbejnë vetëm interesave të publikut.

Kur bëhet fjalë për mbrojtjen e privacisë në Maqedoni edhe në mediat maqedonase shpesh haset mosnjohje e madhe, por edhe shkelje e (pa) qëllimshme e kësaj të drejte. Mediat shpesh për shkak të mosdijes, ndërsa më shpesh në kërkim të sensacioneve, ashpërsisht ndërhyjnë në privacinë e disa personaliteteve, veçanërisht në raste të tragjedive ose sëmundjeve. Veçanërisht brengos shkelja e privacisë në mediat onlajn. Nisur nga kjo, pjesa më e madhe e vendimeve të Komisionit të Ankesave i përket shkeljes së privacisë në mediat onlajn, që më shpesh bëhet përmes marrjes së përmbajtjeve dhe fotografive.

Fotografia paraqet të dhënë biometrike personale, që hyn në kategorinë e të dhënave të ndjeshme personale, të cilat kanë edhe shkallë të veçantë të mbrojtjes dhe sipas rregullit nuk guxon të përpunohen pa pajtimin e subjektit të të dhënave personale ose pa ekzistimin e bazës ligjore²⁶. Pajtueshmëria e shfrytëzuesit të publikojë fotografi të veta në profilin e tij privat, pa dallim se sa shfrytëzues do të mund ta ndjekin, nuk do të thotë automatikisht edhe pajtueshmëri ata që ripublikohen në faqe tjera të internetit ose media. Megjithatë nëse individit ka zgjedhur opsionin e publikimit "publik", ka interpretime të ndryshme sa i përket ligjshmërisë dhe legjitimitetit të publikimit të kësaj fotografie pa pajtueshmërinë e tij.

2. Kodi i Gazetarëve është i qartë

Pikërisht për shkak të këtyre dilemave në rajon ndërmerren hapa që në kodet gazetareske të inkorporohen kahe se si tu ndihmohet mediave që të mos i shkelin parimet e respektimit të privacisë. Kështu, përkaj rëndësisë së rregullave në kodekse, për ambientin mediatik onlajn inkorporohen edhe rregulla të reja. Në Serbi, Këshilli i Shtypit përgatiti edhe kahe për këtë. Në njërën prej tyre për trajtimin e shkrimeve dhe fotografive private, të publikuara në rrjetet dhe platformat

25 Council of Europe Parliamentary Assembly, *Resolution 1165 (1988) Right to Privacy*, i disponueshëm më 10 janar 2017, <http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=16641&lang%20=en>

26 ibid

sociale zbatohet rregullu në të cilin thuhet se të dhënat dhe shkrimet private, duke përfshirë këtu edhe fotografitë private, videot dhe përmbajtje tjera që personi i ka publikuar në rrjetet publike ose platforma tjera mund të publikohen në media vetëm me pajtueshmëri paraprake, përveç në rastet kur interesi i publikut mbizotëron të drejtën e privacisë.²⁷

E drejta e privacisë dhe interesi publik në Kodin e Gazetarëve të Maqedonisë janë rregulluar me më shumë parime (nene të Kodit).²⁸ Që në Parimet e sjelljes është e shkruar se detyrë themelore e gazetarëve është t'i respektojnë të vërtetën dhe të drejtën e publikut, të jetë i informuar në pajtim me nenin 16 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, e cila garanton liri të shprehjes së mendimit, lirinë e të folurit, të paraqitjes publike, informimit publik, qasjen e lirë deri te informacionet, lirinë e pranimit dhe transmetimit të informacioneve, ndalimin e censurës.

Në nenin 1 të Kodit të gazetarëve në Maqedoni qëndron se gazetari ka të drejtën e qasjes së lirë deri te burimet e informimit që janë me interes publik. Fakti që interesi publik është i rregulluar me nenin e parë të Kodit të gazetarëve më së miri flet për nevojën e publikut çdoherë të ketë në dispozicion informacione të sakta, të verifikuara dhe informacione në kohë. Neni 7 u rekomandon gazetarëve të shmangin hyrjen në jetën private të personaliteteve, përveç nëse sjellja e një personi publik në jetën private ka ndikim ndaj interesit publik. Gazetari gjithashtu është i detyruar ta respektojë dhimbjen dhe zinë personale. Në Doracakun për etikë në gazetari²⁹ jepen kahe të detajuara për atë se në çka duhet të kenë kujdes gazetarët që të mos e shkelin këtë parim, por duke mbajtur llogari për interesin publik.

Këshilli gjerman i shtypit në Kodin e tij lidhur me mbrojtjen e privacisë thotë:

„Shtypi e ruan jetën private dhe sferën intime nga njerëzit. Megjithatë, nëse sjellja private është e lidhur me interesin publik, për të mund të raportohet. Duhet të synohet që me publikimin të mos shkelen të drejtat e personaliteteve që nuk marrin pjesë në të. Shtypi e respekton të drejtën e çdo njeriu që të vendos për publikimin e të dhënave që lidhen me atë personalitet dhe garanton mbrojtjen e të dhënave në kuadër të redaksisë.”³⁰

27 Savet za stampu, *Smernice za primenu Kodeksa novinara Srbije u onlajn okruzenju*, i disponueshëm më 3 mars 2017, http://www.savetzastampu.rs/doc/savet-za-stampu_kodeks-i-onlajn-mediji.pdf

28 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, *Kodi i gazetarëve të Maqedonisë, Parimet e sjelljes* (Shkuo, SHGM:2001). I disponueshëm më 25.2.2017: http://znm.org.mk/?page_id=1412

29 Tamara Çausidis dhe Zoran Bojaroskyi, *Doracaku për etikë në gazetari*, (Shkup: 2012), i disponueshëm më 12 shkurt 2017, <http://znm.org.mk/wpcontent/uploads/2016/03/Прирачник-за-етика-во-новинарството-мај-2012.pdf>

30 Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë, *Kodi i gazetarëve të Maqedonisë, Parimet e sjelljes* (Shkuo, SHGM:2001). I disponueshëm më 25.2.2017: http://znm.org.mk/?page_id=1412

Komisioni i Ankesave i Shtypit Britanik, në Kodin e tij, kur bëhet fjalë për interesin publik midis tjerash thekson se “në rastet në të cilat përfshihen fëmijë më të rinj se 16 vjeç redaktorët janë të obliguar të dëshmojnë se ekziston interes i jashtëzakonshëm publik, që të mospërfilltet interesi i fëmijës, i cili është më i rëndësishëm”. Sipas këtij Kodi, fëmija më i ri se 16 vjeç nuk guxon të fotografohet, përveç se me lejen e prindërve të tyre, kujdestarëve ose personave tjerë të moshuar që janë përgjegjës për të.³¹

3. Vendimet e Komisionit të Ankesave që lidhen me shkeljen e privacisë

Komisioni i Ankesave nga 150 parashtresa të shqyrtuara, në 15 ka vërtetuar shkeljen e parimit të privacisë së individit. Konstatim i përgjithshëm është se sipas numrit të shkeljeve të këtij neni, i krahasuar me të tjerët, kjo bëhet në nivel më të ulët, por kjo nuk do të thotë se kjo shkelje është më pak e rëndësishme se sa tjerat, sepse shpesh bëhet me vetëdije, ndërsa më rrallë nga padija ose pakujdesia e gazetarit. Por ndonjëherë edhe ankuesit që konsiderojnë se u është cenuar privacia nuk kanë të drejtë.

Kështu në rastin Gjorgji Ugrinovski për javoren *Fokus* nga personi Gjorgji Ugrinovski u parashtrua ankesë për shkrimin me titull “Bizneset milionëshe të familjes së Vevçanit”, i publikuar në javoren Fokus. Në ankesë thuhet se në disa pjesë të shkrimit të përmendur janë thënë të pavërteta dhe raportimi nuk është i saktë dhe nuk është korrekt, se është bërë shpifje, është cenuar privacia dhe nuk është përfaqësuar pala e dytë.

Siç mund të konstatohet në vetë tekstin, autori i analizon raportet familjare, politike dhe biznesore të ankuesit Ugrinovski me persona të politikës. Tek ky shkrim i shkruar në këtë mënyrë, Komisioni, së pari konstatoi se është me interes publik, sepse përfshin analizën e punës dhe relacionet e personaliteteve politike dhe zyrtarëve publikë dhe me këtë kanë pranuar të jenë objekt i mbikëqyrjes publike dhe të kritikës së fuqishme potenciale nga ana e mediave në aspektin e mënyrës se si i kryenin dhe i kryejnë funksionet e tyre. Për shkak të kësaj, Komisioni i Ankesave konstatoi se parimi i respektimit të privacisë në këtë rast nuk është shkelur.

Në nenin 7 të Kodit të Gazetarëve, gjithashtu rekomandohet që të shmangët sensacionalizmi. Në këtë periudhë, shkeljet që i bëjnë disa media më shpesh janë të lidhura me përmbajtje të kopjuara nga rrjetet sociale dhe transmetimi i tyre përmes titujve sensacionalë, pa bërë llogari se me këtë shkelet privacia e dikujt.

Për përmbajtjet e rrjeteve sociale mund të konsiderohet se janë të sferës publike. Megjithatë për shfrytëzimin e këtyre përmbajtjeve për publikim në media, patjetër duhet të merret leja paraprake, vetëm nëse interesi i publikut mbizotëron të drejtën e privacisë.

31 ibid

Kështu në rastin *Angella Ilievska* për *Netpress.com.mk*, ankesa është parashtruar për shkrimet “Maqedonia- peng i qejfeve të Vanhautes” dhe “FOTO: Vallë Vanhauete shndërrohet në idhull i vërtetë i LSDM-së?”, i publikuar në portalin e internetit *Netpress.com.mk*. Në ankesë pohohet se shkrimet kanë prishur reputacionin e Ilievskës si aktiviste qytetare dhe person i ri. Thuhet edhe se është marrë fotografia nga profili personal dhe është keqpërdorur në mënyrë të rëndë. Përveç kësaj, në shkrim ka edhe koment seksist. Komisioni vlerësoi se kur do të lidhen fotografia e publikuar në shkrim dhe konstatimet seksiste të dhëna në formë pyetësore, vënë në pyetje dinjitetin e ankueses dhe reputacionin e saj në komunitet. Përveç kësaj, autori i shkrimit nuk ka theksuar se ka marrë leje për marrjen e fotografive të Ilievskës nga profili i saj në rrjetin social Fejsbuk. Siç më tej konstatoi Komisioni, jeta personale e ankueses, e cila nuk është as zyrtare e zgjedhur e as e emëruar dhe publikimi i të dhënave të saj personale në formë të fizionomisë së vërejtur në fotografi, nuk mund të konsiderohet çështje e interesit publik që mbizotëron mbi të drejtën e saj për privaci, e cila është e garantuar me Ligjin për mbrojtjen e të drejtave personale. Nisur nga kjo Komisioni konstatoi shkëlqen e parimit për respektimin e privacisë.

Sipas nenit 7 të Kodit të gazetarëve të Maqedonisë, duhet të shmangët publikimi i fotografive ose xhirimeve të personave që kanë ndërruar jetë, për shkak të respektimit të dhimbjes dhe zisë personale. Në të bëjnë pjesë edhe xhirimet nga vetëvrasjet, madje edhe nëse janë bërë në vende publike. Përrashtim bëjnë rastet kur xhirimi është bërë për shkak të mbrojtjes së interesit publik dhe nëse personat e prekur japin leje për këtë.

Në rastin Daniell Kallajxhievski për *Plusinfo.mk* është parashtruar ankesë për fotografitë “Pamje e tmerrshme e vajzës së pafat në Parkun e Qytetit (Galeria)”, të publikuara në portalin e internetit *Plusinfo.mk*. Në ankesë thuhet se me publikimin e fotografive është shkelur privacia dhe publikimi i këtyre fotografive të personit të vdekur paraqet mosrespektim i tij, si dhe mosrespektim i dhimbjes së familjes së tij dhe më të afërmeve. Në përgjigjen e ankesës nga portali u theksua se “vetëdjegia e një gruaje 45 vjeçare, si i vetmi i atij lloji në historinë e Maqedonisë (...) paraqet ngjarje publike, për të cilën mediat zakonisht raportojnë me shkrim, fotografi dhe video”. Komisionit nga media e apostrofuat u ofruan adresa mediash në të cilat mund të gjenden dhe shihen raste të vetëvrasjeve në tërë botën. Gjithashtu, u shtua se “në fotografitë e Plusinfos nuk ka elemente të mjaftueshme që të identifikohet fytyra e viktimës ose gjendja në të cilën gjendet ajo”. Gjatë vendimarrjes, Komisioni i Ankesave i mori parasysh edhe rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare Botërore për parandalimin e vetëvrasjeve, ku midis tjerash thuhet se duhet t’i shmangët përskrimi eksplicit i metodës së përdorur gjatë vetëvrasjes ose tentimit për kryerjen e saj, fotografi ose video- xhirime të vendit të vetëvrasjes nuk duhet të përdoren veçanërisht kur kjo e bën vendin dhe metodën të qartë për lexuesin ose shikuesin.³²

32 World Health Organization, *Prevention of Suicide: A Resource for Media Professionals*, (Geneva: World

Komisioni i Ankesave konstatoi se është shkelur Kodi i gazetarëve në Maqedoni dhe se publikimi i fotografive të viktimës mund në mënyrë plotësuese ta zmadhojë dhimbjen e famijes dhe të afërmeve të saj përkatësisht se nuk janë respektuar dhimbja dhe zia personale, pa dallim që nuk është publikuar identiteti i gruas. Raportimi për ngjarjen ka mundur të jetë profesional edhe pa publikimin e fotografive të të ndjerës.



Gazetari do të ruajë reputacionin dhe dinjitetin e profesionit të tij, do të nxisë solidaritetin e ndërsjellë dhe diversitetin e qëndrimeve dhe nuk do ta përdor median e tij për qërim hesapesh me personalitete, duke përfshirë edhe kolegët e tij.

Mirçe Adamçevski

1. Qërim hesapesh me personalitete, përfshirë edhe kolegë-gazetarë

Vërtetimi i nenit apo parimit të veçantë, sipas të cilit gazetarët duhet të ruajnë reputacionin e profesionit dhe nuk do ta përdorin median për qërim hesapesh me personalitetet, duke përfshirë edhe kolegët e tyre, nuk është veçori e të gjitha këshillave të shtyp ose për etikë në media. Shkeljet etike “gazetari kundër gazetarit” janë më të përshtatshëm për shqyrtim në kuadër të këshillave të nderit, që janë pjesë e shoqatave të gazetarëve. Bëhet fjalë për një lloj vetërregullimi mediatic, që meret ekskluzivisht me gazetarët. Në Maqedoni, duke pasur parasysh se nuk është miratuar Kod i veçantë për sjelljen etike në media, Këshilli i Etikës në Media udhëhiqet sipas Kodit të përhershëm të gazetarëve në Maqedoni.

Mungesa e një neni ose qëndrimi të këtillë në kodet e këshillave etike ose këshillave të shtypit në shumë vende, nuk duhet të kuptohet se është e panevojshme, e as se vetëm në Maqedoni ka “qërim hesapesh” të mediave me mediat. Në vende tjera këto çështje zgjidhen në kuadër të parimeve që i përmbajnë kodet gazetareske. Deri në përgatitjen e Kodit të ri për etikën e mediave, edhe Kodi ekzistues gazetaresk mundëson miratimin e vendimeve valide, sepse në të janë rregulluar parimet e njëjta etike dhe profesionale, ndërsa reputacioni dhe dinjiteti i gazetarit janë pjesë e sjelljes etike të mediave.

Njëra nga shtetet e rralla, në Kodin e së cilës flitet për sjelljen e gazetarëve ndaj gazetarëve është Lituania. Në Kodin etik të gazetarëve të këtij vendi midis tjerash qëndron se:

„7. Në raportet e tyre afariste gazetarët duhet të mbajnë baraspeshë midis garës së ndershme dhe solidaritetit profesional.

8. Gazetari nuk do t'i pengojë kolegët e tij në grumbullimin e informacioneve, nuk do t'i orientojë gabimisht dhe nuk do t'i paraqes tek autoritetet.

9. As gazetarët e veçantë, as redaksitë nuk do të konfrontohen përmes mediave masive për shkak të llogarive të vjetra. Sjellja e këtillë jo vetëm që e dëmton reputacionin e profesionit të tyre, por edhe reputacionin e tyre profesional.”³³

33 Stevan Niksic, Ana Davico, *Etika novinarstva - Prirucnik za profesionalne novinare*, (Beograd, CPM> 2004), I disponueshëm më 11 janar, 2017 <https://www.scribd.com/document/26507848/Etika-novinarstva>

2. Ruajtja e reputacionit dhe dinjitetit

Në përditshmërinë mediatike maqedonase shpesh ndodh shkelja e parimeve të profesionalizmit dhe etikës. Shoqatat e gazetarëve në shtetet me traditë të gjatë demokratike me kalimin e viteve kanë këmbëngulur që t'i shmangin ose reduktojnë në minimum shkeljet e parimeve themelore etike dhe profesionale.

Trupat vetërregulluese në këto shtete, fillimet e të cilave janë para qindra viteve, janë njëra nga mënyrat që të pengohen deklaratat e këtilla nga ana e vetë mediave. Miratohen kode në të cilat inkorporohen parime, të cilat vënë në pah se si mediat duhet të ballafaqohen me sjellje joetike, midis tjerash edhe me cenimin e reputacionit dhe dinjitetin e personave dhe gazetarëve. Në Maqedoni kjo dukuri është shumë e përhapur, veçanërisht në mediat onlajn. Ekzistojnë “media” dhe “gazetarë” që pajtohen të punojnë joprofesionalisht, propagandikisht, të cilët janë pa përgjegjësi dhe janë të përgatitur të bëjnë gjithçka për para dhe/ose për ndonjë privilegj tjetër.

“Gazetarët” dhe “mediat” e këtillë janë rrezik për profesionin dhe për shoqërinë, aq sa janë edhe ata që i shfrytëzojnë. Disa thonë që këtë e bëjnë sepse mbi kokë u qëndrojnë pronarët me kërcënime të ndryshme, ndërsa mbi kokat e pronarëve qëndron biznesi dhe elitat politike ose e gjitha bëhet në një raport klientelist.

Asnjë politikë redaktuese nuk përmban parimin se mediat duhet të “pështyjnë” dikë ose të qërojnë hesapet midis tyre. Përkundrazi, ata pajtohen se së pari duhet të bëjnë gjithçka për publikun, me qëllim që t'i besojë medias dhe se vendimet editoriale nuk miratohen nën ndikimin e interesave të jashtme, presioneve politike ose komerciale ose çfarë do qofshin interesa personale. Dhe për këtë shkak përmbajtjet duhet të bëhen sipas standardeve më të larta profesionale dhe etike dhe si të tilla duhet t'i ofrohen publikut. Në fund të fundit, mediat varen edhe nga besimi i publikut. Edhe pse kjo në Maqedoni nuk është fakt, megjithatë drejt kësaj duhet të synohet.

Anemi Hogenbom në librin “Gazetari universal” shkruan:

„Nëse dëshironi të bëheni propagandist, punësohuni në përgatitjen e reklamave, në qeveri ose në politikë. Gazetari nuk duhet të jetë i besueshëm ndaj askujt dhe ndaj asgjëje, përveç gazetave dhe lexuesve: ndaj asnjë partie politike, burimi, interesi komercial ose ndonjë interesi tjetër, pavarësisht se e kanë merituar atë. Shumë është vështirë që dikush të merret me gazetari të balancuar dhe pa konflikt interesi. Në gazetën Washington Post ekziston rregulli me të cilin u ndalohet gazetarëve të marrin pjesë në çfarëdo aktiviteti politik. Kjo ka të bëjë edhe me marshet protestuese dhe demonstrata. Dhe kështu, kur një grup gazetarësh janë parë në demonstrata për mbrojtjen e të drejtës së abortit u është thënë se nuk do tu lejohet të shkruajnë asgjë në temën mbi abortin”.³⁴

34 David Randall, *The Universal Journalist*, 4th edition, (Pluto Press, 2007)

Ekzistojnë norma, profesionale dhe etike, që duhet të respektohen. Në radhë të parë këtu është respektimi i interesave dhe qëllimeve të përbashkëta të komunitetit mediatic. Pastaj është brenga për prestigjin e profesionit: të mos lejohen veprime kriminale, të mos merren dhurata, shërbime, privilegje që e komprometojnë pastërtinë morale të gazetarit, të mos lejohet të shfrytëzojë pozitën zyrtare për qëllime personale (shantazhe dhe kërcënime), të mos bien pre e presionit për mospublikimin e shkrimeve dhe të mos shkruhen materiale të porositura në favor të çfarëdo interesash.

Gazetarët duhet tu ndihmojnë kolegëve të tyre që janë gjendur në situatë rëndë. Duhet të mbrohen të drejtat e veta autoriale dhe të respektohen të huajat, të respektohet e drejta nëse dikush nuk dëshiron të përmbush detyra të punës që është në kundërshtim me bindjet dhe parimet e tij. Në disa vende në këto norma janë të përfshira edhe detyrimet për ndihmë të ndërsjellë në “pjesët” teknike të bashkëpunimit, nxitjen e këmbimit të informacioneve ndërgazetareske (të dhënat), kërkim i përbashkët pas informacioneve dhe kontakteve afariste. Në këtë drejtim është edhe qëndrimi i Deklaratës së Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve (IFJ) në të cilën thuhet: Gazetari do ta konsiderojë si shkelje serioze profesionale këtë që vijon: plagjiatët, prezantimi i rrejshëm qëllimkeq; shpifjet, fyerjet, nënshtrimin, akuzat e pabaza, marrjen e mitës në çfarëdo forme në bazë të publikimit ose mospublikimit.³⁵

Ose gjithë këtë që e thamë më lartë në një fjali: në punën e tyre gazetarët udhëhiqen nga etika e profesionit të tyre, e ruajnë reputacionin, dinjitetin dhe integritetin e profesionit të tyre, bashkëpunojnë midis tyre dhe kultivojnë raporte kolegjiale dhe solidaritet profesional.

3. Vendimet e Komisionit të Ankesave që lidhen me reputacionin dhe dinjitetin e profesionit

Komisioni i Ankesave pranë KEMM, nga 149 ankesa të shqyrtuara, në 21 vërtetoi shkeljen e nenit 16 përkatësisht të parimit për ruajtjen e reputacionit dhe dinjitetit të profesionit. Shqyrtimet e Komisionit tregojnë se diskriminohen gazetarët dhe individët që si duket janë problem i kundërshtarëve të profesionalizmit në media.

Në rastin Jovanovski për *Kanal 5*, gazetari Borjan Jovanovski iu drejtua Komisionit të Ankesave, si njëri nga personalitetet që përmenden në edicionin e ditari televiziv të Kanal 5, i transmetuar më 19.11.2014.


Sipas Jovanovskit, bëhet fjalë për kronikë në të cilën në “mënyrë joprofesionale dhe joetike vihet në pikëpyetje integriteti profesional, si dhe integriteti i ko-

35 International Federation of Journalists, *IFJ Declaration of Principles on the Conduct of Journalists*, (Bordeaux: International Federation of Journalists, 1954), i disponueshëm më 3 shkurt 2017, <http://www.ifj.org/about-ifj/ifj-code-of-principles/>

legëve tjerë". Komisioni i Ankesave kërkoi përgjigje nga kryeredaktorja e Kanal 5, Lidija Bogatinova lidhur me parashtresën. Në përgjigjen e saj ajo ofroi disa postime Twiteri nga Borjan Jovanovski dhe një link që aspak nuk është i lidhur me parashtruesin e ankesës. Komisioni e pranoi parashtresën e Jovanovskit dhe konstatoi shkelje të Kodit të Gazetarëve të Maqedonisë në tri nene, duke përfshirë edhe shkeljen e nenit 16. Komisioni konstatoi se as gazetarët, e as redaktorët nuk do të duhej të lejonin që përmes mediave të tyre të qërojnë hesapet me personalitete tjera dhe kolegë të tyre. Sjellja e këtillë jo vetëm që e ul integritetin dhe dinjitetin e tyre, por edhe e rrënon reputacionin e profesionit gazetaresk në përgjithësi dhe e ul besueshmërinë e publikut ndaj mediave. Madje, përkundrazi, gazetari është i detyruar të mbrojë kolegët që vuajnë për shkak të aktiviteteve profesionale.

Në rastin TV 21 për *Telegraf.mk*, u dorëzua ankesë për fotografimin e publikuar në shkrim me titull "GJERMANI VJEN: Hajndëllin e priti vetëm ambasadorja Althauzer" (foto), i publikuar në portalin *Telegraf.mk*

Televizioni ankohej për raportim jo të saktë dhe jokorrekt, për diskriminim dhe fyerje të medias, për shkak të errësimit të logos së televizionit në fotografimin e publikuar, por ankohej edhe për papërgjegjësi ndaj kolegëve. Në përgjigjen e portalit thuhet se raportin jokorrekt dhe jokolegjial e ka iniciuar reporteri i TV 21, i cili ka qenë në vendin e njëjtë ku ka qenë edhe fotoreporter i *Telegraf.mk*, i cili ka fotografuar ardhjen e diplomatit amerikan. Komisioni konstatoi se kolegët kanë mundur paraprakisht të merren vesh për atë se si do ta kryejnë punën. Lufta për informacion të shpejtë dhe cilësor nuk duhet të shpie drejt konflikteve midis mediave. Ankesa u pranua vetëm në aspektin e shkeljes së nenit 16, në të cilin flitet për atë se gazetarët në punën e tyre duhet të këmbëngulin që të mbajnë balancim midis konkurrencës së ndershme dhe solidaritetit profesional, ndërsa u hodhën poshtë pohimet për diskriminim dhe fyerje të medias.



Vendimet e Komisionit

PUBLIKIMI I INFORMACIOEVE TË SAKTA DHE TË VERFIKUARA (neni 1)

Ankesa: Jane Diemski për Kurir

Konteksti

Portali i internetit *Kurir* më 15 maj të vitit 2015 në kuadër të rubrikës “Maqedonia” publikoi shkrim me titull “Krahu shantazhues intelektual i LSDM-së me disa skandale”. Në shkrimin, i cili nuk ishte i nënshkruar nga autori, ndërsa nga aspekti i zhanrit është përzierje e raportit me komentit, ndërtohet konstrukcion rreth lidhshmërisë midis partisë opozitare LSDM me sektorin joqeveritar, ndërsa konfirmohet se vendimet kyçe të kësaj partie i miratojnë personalitete që nuk janë pjesë e organeve të partisë, por janë intelektualë dhe aktivistë joqeveritarë që kanë ndikim të fuqishëm ndaj liderit të opozitës maqedonase, Zoran Zaev.

Ankesa

Gazetari dhe aktivisti joqeveritar Jane Dimeski më 17 qershor të vitit 2015 dorëzoi parashtresë deri te Komisioni i Ankesave, në të cilën thuhet se në shkrim raportimi është jo i saktë dhe jo korrekt.

Përgjigja e medias

Zyra ekzekutive e KEMM, në pajtim me nenin 12 të Rregullores së Komisionit për Ankesa, pas pranimit dhe shqyrtimit të ankesës, kontaktoi me portalin e internetit *Kurir* me kërkesë që kolegji i redaksisë të deklarohet lidhur me pohimet e ankesës. Tek Komisioni i Ankesave pranë SEMM *Kurir* nuk ofroi asnjë përgjigje lidhur me pretendimet e ankuarit.

Vendimi i Komisionit

Komisioni i Ankesave vendosi se ankesa në shkrime është e bazuar dhe se me përmbajtjen e shkrimit të publikuar janë shkelur katër nene të Kodit të gazetareve të Maqedonisë, nenet 1, 10, 13 dhe 15.

Arsyeshmëria e vendimit

Në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik të vitit 2015, Komisioni i Ankesave i shqyrtoi pretendimet e ankuarit Jane Dimeski dhe analizoi përmbajtjen e shkrimit të publikuar. Në shkrim transmetohen deklarata të individëve për punën e Lubomir Fërçkovskit si ish ministër, për Vladimir Millçinin (në cilësinë e kryetarit të OJQ) dhe për Branko Geroskin e Sasho Ordanoskin si gazetarë. Siç mund të shihet në vetë shkrimin, autori konfirmon se njeriu i parë i opozitës Zoran Zaev ka qenë i këshilluar

nga Lubomir Fërçkovski (ish ministër) nga Branko Geroski dhe Sasho Ordanoski (gazetarë) dhe nga njeriu i parë i Fondacionit Soros në vend, Vlladimir Millçin (ish kryetar i kësaj organizate joqeveritare), ndërsa qëndrimet e tyre të shprehura janë bërë më pas qëndrime të Zaevit dhe të LSDM-së. Për këtë pohim autori nuk ka ofruar asnjë dëshmi ose deklaratë, nuk ka theksuar se vallë bëhet fjalë për spekulim ose për supozim, e as nuk e ka siguruar palën e dytë, përkatësisht nuk u ka lejuar personave të lartpërmendur ta shprehin qëndrimin e tyre për këto pohime.

Më tej, autori nuk bën dallim statusor midis personave të përmendur. Komisioni konstatoi se në shkrimin konkret, qëllim legjitim gazetaresk është ish ministri Lubomir Fërçkovski, i cili si ish bartës i funksionit publik mund t'i nënshtrohet debatit mediatik politik, akt që është në pajtueshmëri të plotë me Deklaratën e Komitetit të ministrave të Këshillit të Evropës për debat politik në media.

Komisioni vlerësoi edhe se autori nuk bën dallim midis fakteve dhe mendimeve, midis lajmit dhe komentit dhe një pjesë e pohimeve të tij për Ordanoskin, në kolumnë kohë më parë i ka konfirmuar edhe Dragan Pavloviq- Llatas dhe transmeton citate të tij, në të cilat janë përmendur fyerje vullgare. Për këtë, Komisioni konstatoi se autori nuk e kultivon kulturën e të folurit dhe etikën, duke transmetuar përmbajtje që paraqesin komunikim të pashembullt me publikun.

Për shkak të kësaj që u theksua, Komisioni për Ankesa vlerësoi se në shkrimin "Krahu shantazhues intelektual i LSDM-së me skandale të shumta" është shkelur neni 1 i Kodit të gazetarëve të Maqedonisë, sipas të cilit gazetari duhet të publikojë informacione të sakta dhe të verifikuara. Nëse informacioni nuk mund të verifikohet ose nëse bëhet fjalë për supozim përkatësisht për spekulim, kjo duhet të thuhet dhe të publikohet. Saktësia e informacionit duhet të verifikohet aq sa është e mundur. Verifikimi i të dhënave dhe saktësia janë imperativë morale të gazetarisë, prandaj gazetari është i detyruar ta verifikojë informacionin nga më shumë burime. e së paku nga dy burime që nuk kanë ndërlidhje mes vete. Gazetari duhet të sigurojë "palën e dytë" përkatësisht tu jep mundësi të gjithë të prekurve në një produkt gazetaresk ta shprehin qëndrimin e tyre, veçanërisht në rastet kur shfaqen dyshime dhe akuza ose kur dikush është objekt i sulmit dhe kritikës.

Komisioni i Ankesave konkludoi se në shkrimin kontestues është shkelur neni 10 i Kodit të gazetarëve, ku thuhet se gazetari me vetëdije nuk do të krijojë e as që do të përpunojë informacione që i cenojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk do të flasë me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë e diskriminim mbi baza politike. Kodi etik dhe profesional i gazetarëve parashikon përgjegjësi të veçantë për fjalën e thënë publike. Qëndrimet e tyre janë faktor i rëndësishëm në formësimin e opinionit publik dhe për këtë shkak gjuha e urrejtjes është në kundërshtim me etikën gazetareske. Media dhe gazetari nuk duhet të publikojnë përmbajtje që kanë qëllim të përhapin armiqësi dhe urrejtje ose përmbajtje, për të cilat ekziston mundësi e madhe se mund të shkaktojnë armiqësi dhe urrejtje ndaj dikujt, për shkak të përkatësisë së tyre politike.

Gjithashtu, Komisioni erdhi në konkludim se në shkrim është shkelur edhe neni 13 i Kodit, në të cilin thuhet se gazetari duhet të bëjë dallime midis fakteve dhe mendimeve, midis lajmit dhe komentit.

Patjetër duhet të bëhet i qartë kufiri se çfarë janë faktet dhe informacionet, e çfarë është komenti, supozimi ose qëndrimi i autorit që të shmanget dezinformimi dhe manipulimi i publikut.

Dhe e katërta, Komisioni i Ankesave vërtetoi se në shkrim është shkelur edhe neni 15, ku thuhet se gazetari patjetër duhet ta kultivojë kulturën e të folurit dhe etikën. Me profesionin gazetaresk nuk përkon komunikimi i pashembullt me publikun.

Ankesa. Ksenofon Ugrinovski për Sloboden Peçat

Konteksti

Gazeta e përditshme Sloboden Peçat, në dymëshin e 22 dhe 23 tetorit të vitit 2014, në kuadër të rubrikës “Maqedoni” publikoi shkrimin me titull “Ejakulimi jashtë gruas nuk pranohet”. Bëhet fjalë për raport gazetaresk, në të cilin gazetari në mënyrë kritike e vështron cilësinë e librit të ri nga lënda “Arsimi qytetar” në kuadër të mësimit në arsimin fillor. Gazetarja përmes hulumtimit individual dhe qëndrimeve të bashkëbiseduesve synon të informojë publikun për përmbajtjen e librave rreth kësaj problematike dhe vallë nxënësit kanë mundësi të lexojnë përmbajtje të librave rreth kësaj lënde dhe të fitojnë dije në pajtim me kuptimin bashkëkohor të raporteve shoqërore në një shoqëri liberale dhe demokratike, siç duhet të jetë shoqëria maqedonase.

Ankesa

Ksenofon Ugrinovsk, njëri nga autorët e librit Arsimimi qytetar për klasën e tetë, më 24 dhjetor të vitit 2014 dorëzoi parashtrësë te Komisioni për Ankesa, në të cilin thuhet se gazetarja në mënyrë selektive ka cituar pjesë të librit me qëllim që të tregohet fotografia e shtrembëruar për përmbajtjen e saj. Në fakt bëhet fjalë për formulimin si vijon: “Qytetarët luajalë janë të përgatitur t’i ndjekin rregullat dhe aktet në shoqëri, edhe me çmimin të heqin dorë nga liria e tyre.

Autori konfirmon se edhe pse në libër janë përmendur edhe forma tjera të luajalitetit qytetar, gazetarja konsideron se me këtë është shterur përmbajtja e librit. Gjithashtu, ai vëren se në shkrimin gazetaresk nuk ka citim të saktë të një pjese të librit, prej ku mund të nxirret konkluzioni i gabuar.

Përgjigja e medias

Në gazetën Sloboden Peçat, më 12 nëntor të vitit 2014, Zyra ekzekutive e KEMM drejtoi shkresë me kërkesë që të deklarohet lidhur me pretendimet e ankesës. Gazeta e përditshme Sloboden Peçat ditën e njëjtë u përgjigj me shkresë formale,

në të cilën në tërësi qëndron pas shkrimit dhe pas autorit të saj dhe kërkoi që ankesa të hudhet poshtë, duke ofruar argumentet e veta lidhur me pretendtimet e ankuesit. Në fakt, në shkresën lidhur me shkrimin kontestues, thuhet se me asnjë fjalë ose aludim në asnjë mënyrë nuk janë fyer ose shpifur autorët e librit të përmendur, në kuptimin e dispozitave të Ligjit për përgjegjësi qytetare për shpifje dhe fyerje. Më tej, në përgjigjen e medias theksohet se në procedurën e përgatitjes së shkrimit kontestues gazetarja Miroslava Bërnis ka konsultuar burimet e domosdoshme, ndërsa lexuesve që tu paraqiten pjesët kontestuese të librit dhe mendimi relevant i ekspertëve për to janë cituar: (1) vetë libri si burim i pakontestueshëm i shkruar, (2) Lenka Gogoska, profesore shumëvjeçare e Fakultetit Pedagogjik (3) ish ministri i Arsimit dhe Shkencës Nenad Novkovski dhe 4) Tatjana Gogoska, magjistre e komunikologjisë dhe hulumtuese e ndikimit të mediave ndaj zhvillimit të fëmijëve. Burimet janë të ekspertizës dhe politikisht neutrale. Si burime nuk janë konsultuar autorët e librit, sepse për këtë nuk ka pasur as nevojë- gjithçka që kanë pasur të thonë për njësitë metodike që i mësojnë fëmijët i kanë thënë në libër (libri nuk mësohet së bashku me “sçarimet” e autorëve të dhëna në media).

Në përgjigjen e Sllobodan Peçat konstatohet edhe se, siç mund të lexohet në tekst, burimet e pavarura dhe neutrale i konfirmojnë dhe i mbështesin rezultatet nga hulumtimi i autores, por edhe këndin e shkrimit gazetaresk. Theksohet edhe se në shkrimin gazetaresk nuk ka komentim!

Vendimi i Komisionit

Komisioni i Ankesave pranë Këshillit të Etikës në Media vendosi që ankesa është e bazuar. Është shkelur neni 1 i Kodit të gazetarëve të Maqedonisë: “Gazetari ka të drejtën e qasjes tek të gjitha burimet e informacionit që janë me interes publik. Gazetari duhet të publikojë informacione të sakta, të verifikuara dhe nuk do të fshehtë të dhëna thelbësore dhe do të falsifikojë dokumente. Nëse informacioni nuk mund të vërtetohet ose bëhet fjalë për supozim përkatësisht spekulim, kjo duhet të thuhet dhe të publikohet. Saktësia e informacionit duhet të verifikohet sa më shumë që është e mundur.

Komisioni i Ankesave pranë Këshillit të Etikës në Media në Maqedoni konstatoi se bëhet fjalë për shkrim në të cilin plotësisht dhe padyshim është respektuar interes publik. Por, u vërejt se gazetarja nuk ka siguruar “palën e dytë”, përkatësisht nuk u ka dhënë mundësi të gjitha palëve të prekura në shkrimin gazetaresk të thonë qëndrimin e tyre.

Veçanërisht që bëhet fjalë për shkrimin në të cilin objekt i kritikës janë librat e arsimit fillor. Gjithashtu edhe titulli i pjesës më të madhe nuk i përgjigjet përmbajtjes së shkrimit.

Komisioni rekomandon se gazetari çdoherë duhet të synojë që të ruajë kontekstin origjinal të të gjitha citateve ose fragmenteve. Që të mos ndodh që raportimi gazetaresk ta ndryshojë kuptimin e fjalisë, deklaratës ose citatit.

Arsyetimi i vendimit

Komisionit të Ankesave iu drejtua qytetari Ksenofon Ugrinovski, njëri nga autorët e librit *Arsimi qytetar për klasën e tetë*, për të cilin ka vërejtje në pjesën e librit, autor i së cilit është ai. Sipas tij në shkrimin gazetaresk problematizohen disa përmbajtje të njësisë mësimore Lualajiteti qytetar, pa u sqaruar e tërë përmbajtja e njësisë mësimore. Gjithashtu ai vëren se nuk është cituar saktë një pjesë e librit, çka mund të shpie drejt konkluzionit të gabuar.

Komisioni për Ankesa i pati parasysh qëndrimet e redaktorëve të gazetës gjatë shqyrtimit të parashtresës. Ai konstatoi se autori ka prekur një temë e cila padyshim se është e interesit publik, se nuk ka komente të tij, se ka bashkëbisedues relevant që janë të njëzëshëm në kritikën për pjesët e “kontestuarat” të librit. Pikërisht kritika e përgjithshme e ekspertëve e imponon nevojën që të pyetet edhe “pala e dytë”, përkatësisht autorët e librit, që të mund t’i përgjigjen kritikave.

Komisioni konstatoi se nga autori Ugrinovski nuk është kërkuar deklaratë, madje as që është kontaktuar. Sa i përket citatit të gabuar, i cili mund të jetë edhe gabim “teknik” ose i “rastësishëm”, është theksuar se kjo mund të çojë në përfundimin se bëhet fjalë për kontekstualizimin e tekstit. Komisioni për Ankesa në rastin konkret shqyrtoi vetëm tekstin e gazetarit dhe mori vendimin se në kontekstin e tekstit është shkelur neni 1 i Kodit të Gazetarëve të Maqedonisë.

GAZETARI DO TA RESPEKTOJË PRIVACINË E PERSONIT (neni 7)

Avokati i Popullit për portalet *Republika*, *Press24*, *Kurir* dhe *Puls24*

Konteksti

Më 25 nëntor të vitit 2014 katër shkrime të ngjashme u publikuan në portalet në vijim: *Republika* publikoi shkrimin me titullin “Kristijano Ronalldo i regjistruar në klasën e parë” (foto), *Pres24* publikoi shkrimin me titull “FOTO: Kristijano Ronaldo është nga Shutka- fotografia që e bëri të qesh Maqedoninë”, *Kurir* publikoi shkrimin me titull “FOTO: Dëshmi se Kristijano Ronaldo është nga Shutka”, ndërsa *Puls24* publikoi një shkrim me titull “Foto: Ronaldo u regjistrua në klasën e parë”. Në këto shkrime ka fotografi të fëmijës në të cilën shihet një copë e listës evidentuese në shkollë fillore të një nxënësi që është regjistruar në klasën e parë në vitin shkollor 2014/2015.

Ankesa

Në zyrën e Këshillit të Etikës në Media me ankesë u drejtua zëvendësja e Avokatit të Popullit, Vaska B. Mustafa, në të cilën thekson se shkrimet e publikuara në portalet *Republika*, *Pres24*, *Kurir* dhe *Puls24*, të cilat janë gjithashtu të publikuara edhe në disa portale lokale dhe zbavitëse, “i përqeshin pjesëtarë e bashkësisë rome” me atë që publikojnë fotografi të listës evidentuese të një nxënësi të klasës së parë dhe me një ton ironik në kuptimin e emrave të romëve, me të cilat i pagëzojnë fëmijtë e tyre”.

Përgjigja e medias

Zyra e Këshillit të Etikës në Media, menjëherë pas pranimit të ankesës, në pajtim me nenin 12 të Rregullores së Komisionit të Ankesave, e drejtoi tek portalet e lartpërmendur të internetit. Në afatin e parashikuar, përgjigje dërgoi vetëm kryeredaktorja e portalit *Puls24*, Emilija Velinovska. Në përgjigjen e saj, redaktorja Velinovska pohon se bëhet fjalë për përmbajtje të kopjuar, ndërsa fotografia është marrë nga rrjeti social Fejsbuk. Velinovska, më tej, thekson se në çdo rast është bërë lëshim i paqëllimshëm, pa asnjë qëllim për fyerje. Sipas Velinovskës, portali nuk ka politikë të atillë të punës dhe deri më tani nuk është ballafaquar me probleme të ngjashme, prandaj shpreson se në të ardhmen nuk do të përsëritet.

Njëkohësisht, Velinovska kërkoi falje për siç tha lëshimin e paqëllimshëm dhe e informoi Komisionin se nëse është e nevojshme portali edhe publikisht do të kërkojë falje. Redaktorja e njoftoi Komisionin për Ankesa se përmbajtja në fjalë është tërhequr nga *Puls24*.

Vendimi i Komisionit

Parashtresa është pranuar. Kodi i gazetarëve të Maqedonisë është shkelur në nenet 7, 9 dhe 10. Neni 7 ka të bëjë me atë se gazetari do ta respektojë privacinë e individit, neni 9 konfirmon se gazetari nuk guxon të intervistojë ose fotografojë fëmijë nën 16 vjeç pa pajtueshmërinë e prindërve ose kujdestarëve, ndërsa neni 10 kërkon nga gazetari që të respektojë të drejtat dhe liritë, të mos përdor gjuhën e urrejtjes dhe të mos nxisë diskriminim mbi çfarëdo baze. Përveç kësaj, Komisioni rikujton edhe se trajtimi i fëmijëve në media është rregulluar edhe me dokumentet ndërkombëtare dhe legjislaturën vendase., të cilat midis tjerash, përshkruajnë se nuk guxohet të manipulohet me emocionet fëmijërore ose të publikohet identiteti i fëmijës pa pajtimin e prindit ose kujdestarit.

Arsyetimi i vendimit

Komisioni i Ankesave konkludoi se shkrimet e publikuara nuk përputhen me temën të karakterit publik, por përkundrazi në to publikohen përmbajtje që kanë për qëllim që të tërheqin lexues për shkak të argëtimit, pa pasur llogari për atë se vallë janë shkelur të drejtat e dikujt, në rastin konkret të drejtat e një fëmije të bashkësisë rome. Komisioni vërtetoi se janë shkelur nenet 7 dhe 9 të Kodit të gazetarëve të Maqedonisë, sepse informacionet për jetën private të një personi të caktuar mund të publikohen vetëm nëse sjellja e atij personi në jetën private ka ndikim ndaj interesit publik.

Në këtë rast, Komisioni vërtetoi se portalet e lartpërmendur kanë publikuar dokument që e zbulon identitetin e nxënësit adoleshent, pa qenë të vetëdijshëm se mund t'i bëjnë dëm nxënësit. Emri dhe mbiemri i adoleshentit në asnjë rast nuk duhet të komentohet ose përmendet në asnjë kontekst në media dhe pa pajtueshmërinë e prindit të tij ose kujdestarit, sepse mbrojtja e privacisë është e drejtë njerëzore.

Komisioni i Ankesave vërtetoi edhe se portalet kanë shkelur nenin 10 të Kodit, sepse kanë publikuar fotografi të një adoleshenti, por edhe një pjesë të listës evidentuese nga shkolla fillore.

Dushica Mërgja për *Sitel* (edicioni elektronik)

Konteksti

Edicioni elektronik i Televizionit Sital më 25 prill të vitit 2016 publikoi shkrimin me fotografinë e marrë nga një status privat në rrjet publik, i titulluar: “Ngrenë “revolucion”, ndërsa të dielën në Austri, Stamboll dhe nëpër restorante e det”. Kopja elektronike (printskrin) e statusit tregon persona aspak të njohur për publikun e gjërë dhe jo personin e apostrofuar në shkrim.

Ankesa

Gazetarja Dushica Mërgja, person i apostrofuar në shkrim, më 26 prill të vitit 2016 parashtrori ankesë në Komisionin e Ankesave pranë KEMM për përmbajtjen me titull “‘‘Ngrenë ‘‘revolucion’’, ndërsa të dielën në Austri, Stamboll dhe nëpër restorante e det’’, e publikuar në edicionin elektronik të TV Sitel. Në parashtrësë ajo thekson se me përmbajtjen e publikuar i cenohet privacia.

Përgjigja e medias

Zyra ekzekutive e KEMM, në pajtim me nenin 12 të Rregullores së Komisionit të Ankesave, pas pranimit të shqyrtimit të ankesës, vendosi kontakt me Televizionin Sittel dhe kërkoi nga kolegji redaktues të deklarohet lidhur me pretendimet e ankesës. Kryeredaktori i Sittelit, Dragan Pavloviq- Llatas, në përgjigjen e tij midis tjerash nënvizoi se redaksia e televizionit nuk mban përgjegjësi, veçanërisht për faktin që një lajm i tillë nuk ekziston në programin televiziv.

Vendimi i Komisionit

Parashtrësja është pranuar. Kodi i gazetarëve të Maqedonisë është shkelur në nenet 7, 1, 13 he 16.

Arsyetimi i vendimit

Në mbledhjen e mbajtur më 20 maj të vitit 2016, Komisioni i Ankesave i shqyrtoi pretendimet e ankueses Dushica Mërgja dhe bëri shqyrtimin e përmbajtjes së përmendur. Komisioni konstatoi se në shkrimin “‘‘Ngrenë ‘‘revolucion’’, ndërsa të dielën pushojnë në Austri, Stamboll dhe në restorante e det’’, ka printskrin (kopje elektronike) nga personi Dushica Mërgja, ku shkruan se është në një restorant peshku, por në printskrin vërehen dy meshkuj dhe një fëmijë, së cilit nuk i shihet fytyra. Komisioni konstatoi se personat në fotografi nuk janë të njohur për publikun e gjerë dhe nuk janë bartës të funksioneve publike, përderisa personi Dushica Mërgja është e njohur si gazetare/ redaktore e televizionit 24.

Gjatë vendimarrjes Komisioni e mori parasysh faktin që në faqen e internetit të TV Sitel, në fund të saj, qëndron se të drejtat e autorit të faqes i takojnë TV Sitel dhe është vënë logo për mbrojtjen e të drejtave të autorit. Gjithashtu Komisioni gjatë shqyrtimit konstatoi se në faqen e Shoqatës tregtare radiodifuzive Sitel nuk ka impresum me emra të redaktorëve dhe gazetarëve. Komisioni shqyrtoi edhe regjistrin e domeneve të internetit në Maqedoni në MARnet dhe konstatoi se domeni i internetit sitel.mk me shifër regjistruese NEXT-R36628 është pronë e TV Sitel DOOEL Shkup, me adresën rrga 1732 6p.2, Shkup, 1000, MK.

Në mënyrë plotësuese Komisioni bëri shqyrtim edhe në regjistrin e radiodifuzuesve, i shpallur në faqen e internetit të Agjencisë për Audio dhe Shërbime Audiovizuale Mediatike, ku janë publikuar emrat e kryeredaktorëve të të gjitha televizioneve

në shtet. Nga regjistri qartë konstatohet se kryeredaktor i TV Sitel është Dragan Pavloviq- Llatas.

Në pajtim me këtë që u tha më lartë, Komisioni konstatoi se faqja e internetit sitel.mk është pronë e Sitelit, ndërsa për të drejtat e autorit të përmbajtjeve mediatiqe dhe të personit juridik, por edhe për atë që është publikuar përgjigjet kryeredaktori Dragan Pavloviq Llatas.

Komisioni vërtetoi se personat në fotografinë e publikuar në faqen e internetit sitel.mk gjithashtu duhet të gëzojnë mbrojtjen e jetës private, që në këtë rast nuk është bërë nga ana e medias, sepse jeta e saj private në asnjë rast nuk mund të paraqes interes publik.

Nisur nga kjo, Komisioni vërtetoi se me përmbajtjen e publikuar është shkelur neni 7 i Kodit të gazetarëve në Maqedoni, sipas të cilit informacione të jetës private të ndonjë personi mund të publikohen vetëm nëse sjellja e tij në jetën private ka ndikim ndaj interesit publik.

Komisioni i Ankesave vërtetoi se është shkelur neni 1 i Kodit të gazetarëve të Maqedonisë, sipas të cilit verifikimi i të dhënave dhe saktësia janë imperativë moralë në gazetari dhe prandaj gazetari është i obliguar që të verifikojë informacionin që sa më shumë burime. Në këtë rast nuk është pyetur Dushica Mërgja, ndërsa është shfrytëzuar postimi i huaj në Fejsbuk.

Më tej Komisioni konstatoi se është shkelur neni 13, sipas të cili gazetarët kanë të drejtën e mendimit, qëndrimin ose gjykimit vlerësues, por nuk guxon që mendimin e vet ta kamuflonjë si fakt. Në informacion konfirmohet se “nxënësit e protestave të dhunshme në Shkup, që u nxitën dhe u mbështetën nga LSDM-ja, në ditët e punës ngrenë “revolucion”, ndërsa për fundjavë shkojnë në udhëtime luksoze. Gjithashtu edhe thuhet se “ata që janë më të zëshëm gjatë protestave në të cilat shkatërrohen simbolet e historisë maqedonase dhe goditet policia, shëtisin jashtë vendit, në destinacione të shtrenjta, në të cilat shpenzojnë shumë para. Që ironia të jetë më e madhe në proesta flasin për varfëri tek qytetarët.” Në këtë mënyrë Mërgja është cak i komenteve, pa pasur asnjë fakti në informacion. As ka qenë jashtë vendit. e as që duket në fotografinë e përmendur.

Më tej Komisioni i Ankesave konstatoi se është shkelur edhe neni 16, sipas të cilit gazetarët e as redaktorët nuk do të duhej të lejonin të qëronin hesapet me personat dhe me kolegët e tyre përmes mediave të veta. Sjella e këtilla jo vetëm që e ul integritetin dhe dinjitetin, por e rrënon reputacionin e profesionit gazetaresk, por edhe e ul besueshmërinë e publikut ndaj mediave. Përveç qërrim të hesapeve me Mërgjën, bëhet fjalë edhe për sulm ndaj personaliteve dhe një fëmije, të panjohut në publik, ndërsa është publikuar printskrin i statusit të saj.

GAZETARI NUK DO TË FLASË ME GJUHËN E URREJTJES (neni 10)

Koalicioni “Të drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara” për Sitel 3

Konteksti

Në emisionin kontaktues “Ha byrek” të TV Sitel 3, nga 25 shkurti i vitit 2015, moderatori dhe redaktori i emisionit Janko Illkovski gjatë lidhjes së një shikuesi përdori fjalor që nuk e kultivon kulturën e të folurit dhe etikën dhe sillet në mënyrë diskriminuese ndaj komunitetit LGBT.

Ankesa

Koalicioni “Të drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara” më 11 mars të vitit 2015 dorëzoi ankesë për emisionin “Ha byrek”. Ankuesi theksoi se në emision është përdorur gjuha e urrejtjes ndaj pjesëtarëve të komunitetit LGBT.

Përgjigja e medias

Më 14 mars të vitit 2015 KEMM dërgoi shkrim deri te Sitel 3, në të cilin kërkoi që televizioni të deklarohet lidhur me pohimet në të. As media, as autori i emisionit nuk u përgjigjën ndaj ankesës së kësaj organizate joqeveritare.

Vendimi i Komisionit

Komisioni i Ankesave pranë Këshillit të Etikës vendosi se ankesa është e bazuar, ndërsa janë shkelur nenet 10, 11 dhe 15 të Kodit të gazetarëve në Maqedoni.

Arsyetimi i vendimit

Në mbledhjen e mbajtur më 10 qershor të vitit 2015, Komisioni i Ankesave i shqyrtoi pohimet e ankuesit Koalicioni “Të drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara” dhe bëri shqyrtimin e emisionit në fjalë. Në videomaterialin e emisionin qartë dëgjohej pjesa që nënvizohet në ankesë. Më konkretisht paraqitet shikuesi dhe thotë “...për homoseksualët që paraqiten duhet [.....]³⁶” ndaj së cilës moderatori përgjigjet: “Mosni, dëgjojnë edhe fëmijë të vegjël, të mos u japim asociacione të këqija. Hajde, diçka më kulturore që mund të thuash. Nuk është patjetër aq në mënyrë vullgare të thuhet, edhe pse unë pajtohem, do të lëshoja të thuash çfarëdo që do”.

Komisioni i Ankesave vlerësoi se në emisionin “Ha byrek” gazetari dhe media kanë

³⁶ Fragmenti i deklaratës me qëllim nuk citohet, me qëllim që edhe vetë autorët të mos e „reprodukojnë” gjuhën e urrejtjes.

shkelur nenin 10 të Kodit të gazetarëve, sipas të cilit gazetari nuk do të flasë me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunën dhe diskriminimin mbi çfarëdo baze (kombëtare, fetare, racore, gjinore, sociale, gjuhësore, orientimit seksual, politike). Në rastin e përmendur, media dhe gazetari publikuan material që ka për qëllim që të përhapë armiqësi ose urrejtje ndaj pjesëtarëve të këtij komuniteti. Obligim i gazetarëve dhe mediave është t'i mbrojnë individët dhe grupet nga padrejtësia dhe diskriminimi, të kryera nga organet dhe institucionet publike, nga ndërmarrje private ose kushdo qoftë. Kodi etik dhe profesional i gazetarëve u rekomandon përgjegjësi të veçantë për fjalën e thënë publike. Qëndrimet e tyre janë faktorë të rëndësishëm në formësimin e opinionit publik, për shkak të së cili gjuha e urrejtjes është e papërputhshme me etikën gazetareske. Media dhe gazetari nuk duhet të publikojnë përmbajtje (informacione, fotografi, mendim, koment), që kanë qëllim të përhapin armiqësi dhe urrejtje, e as çfarëdo lloj përmbajtjesh tjera, për të cilat ekziston mundësi e madhe që mund të shkaktojnë armiqësi dhe urrejtje sipas përkatësisë së ndonjë bashkësie.

Gjithashtu, Komisioni konkludoi se në emisionin e përmendur, në kundërshtim me nenin 11, gazetari nuk u është përmbajtur standardeve të përgjithshme e të pranuarra për dinjitet dhe respektimin e diversiteteve në Maqedoni dhe i shkel të gjitha pikat e nenit të përmendur. Në të vërtetë, fyerja mbi përkatësinë etnike, kombëtare, politike, gjinore ose orientimit seksual është e lejuar vetëm nëse ajo është e rëndësishme për kuptimin e storjes.

Gazetari patjetër duhet të jetë i vetëdijshëm për temat e ndjeshme etnike, kulturore, religjioze, seksuale dhe të tjera dhe t'i trajtojë në pajtim me këtë. Gazetari patjetër të jetë i vetëdijshëm për pasojat dhe efektet e fjalëve të tij, patjetër duhet të ketë kujdes gjatë përzgjedhjes së fjalëve dhe nuk guxon të fyejë ose përqesh. Gazetari profesional asnjëherë nuk do të flasë për personalitete mbi bazën e stereotipeve dhe paragjytimeve për racën, gjininë, moshën, religjionin, përkatësinë etnike, orientimin seksual, të metat fizike, pamjen ose statusin social. Gjuha e gazetarëve duhet të jetë e matur dhe neutrale kundrejt atij që ofron konkluzione apo gjykime të gatshme ose përdor fjalor që kufizohet me gjuhën e urrejtjes. Çdoherë duhet të shmangen fraza që në vete përmbajnë çfarëdo konotacioni shovinist, seksist ose çfarëdo konotacioni tjetër diskriminues. Gazetari është përgjegjës për deklaramet nga ana e bashkëbiseduesve, sepse përmes tij ato qëndrime fitojnë publicitet, për atë është i obliguar që ta parafrazojë ose të distancohet nga gjuha fyese ose promovimi i stereotipeve ose diskriminimit.

Komisioni i Ankesave vërtetoi se në rastin konkret, në kundërshtim me nenin 15 të Kodit, gazetari nuk e ka kultivuar kulturën e të folurit dhe etikës. E papërputhshme me profesionin gazetaresk është komunikimi i pashembullt me publikun. Gazetari patjetër duhet të ketë në mendje standardet morale të publikut të cilit i drejtohet.

Gazetari në punën e tij nuk duhet të përdor përmbajtje të pashembullta dhe shqetësuese.

Më tej, gjatë vendosjes Komisioni e mori parasysh edhe nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas së cilit çdo njeri ka të drejtën e lirisë së shprehjes përkatësisht lirinë e mendimit dhe lirinë e pranimt e transmetimit të informacioneve dhe ideve. Realizimi i këtyre lirive përfshin obligime dhe përgjegjësi dhe për këtë shkak mund të jetë objekt i disa formaliteteve, kushteve, kufizimeve dhe sanksioneve të parashikuara me ligj. Këto kufizime në një shoqëri demokratike paraqesin masa të domosdoshme për të mbrojtur disa qëllime të përcaktuara legjitime: siguria shtetërore, integriteti territorial dhe siguria publike, mbrojtja e rendit dhe pengimi i trazirave dhe krimeve, mbrojtja e shëndetit dhe moralit, reputacioni dhe të drejtat e të tjerëve, pengimi i përhapjes së informacioneve të besueshme ose ruajtja e autoritetit dhe paanshmëria e gjyqësorit.

OSBE për TV Sitell

Konteksti

Më 26 shkurt të vitit 2015 në ditarin e TV Sitell në orën 18 nga Kavadari u lidh drejtpërdrejt moderatori televiziv Milenko Nedellkovski, si anëtar i Lëvizjes Qytetare për Mbrojtjen e Maqedonisë e njohur në opinionin maqedonas si GDOM dhe bashkëbiseduesi shprehu mendime dhe qëndrime që përmbajnë gjuhë të urrejtjes.

Ankesa

Në Zyrën ekzekutive të KEMM më 4 mars të vitit 2015, Misioni i OSBE-së në Maqedoni parashtrori ankesë lidhur me deklaratën e Milenko Nedellkovskit e dhënë në Kavadar në ditarin e TV Sitel. OSBE në letrën e saj pohon se deklarata e Nedellkovskit, sipas së cilës një numër i madh i personave, pjesa më e madhe gazetarë dhe politikanë, duhet të “të groposen thellë dhe mbi ta të vihet një pllakë e trashë, e fuqishme, me armaturë dhe me beton, me qëllim që të mos kenë më asnjë lloj ndikimi mbi atë që ndodh”, si dhe vërejtje tjera të tij, duke tejkalluar linjën e kuqe të gjuhës së urrejtjes është veprim që nuk mund të tolerohet. Në vazhdim të letrës së Misionit të OSBE-së thuhet se “vërejtjet e Nedellkovskit janë vazhdimësi e praktikave negative të gjuhës së urrejtjes, si pjesë e deklarimeve të tij të rregullta. Misioni i OSBE-së në Shkup është përfshirë në projekte kundër gjuhës së urrejtjes. Nëse në media lejohet përhapja e kësaj gjuhe, komprometohen dhe nënvlerësohen angazhimet tona”, thuhet në reagimin e Misionit të OSBE-së. Sipas tij, Misioni i OSBE-së në Shkup “refuzon çfarëdo kontakti me Nedellkovskin dhe me të gjitha mediat që do t’i mundësojnë platformë që t’i shpreh porositë e tilla të tmerrshme”.

Përgjigja e medias

Zyra e KEMM pas pranimit të ankesës më 5 mars të vitit 2015 realizoi kontakt me redaktorin e ditarit të Sitel Valentin Nikollovski, ndërsa më pas pasoi edhe takim me redaktorin përgjegjës të Televizionit, Dragan P. Llatas. Pas takimit, redaktori përgjegjës Llatas dorëzoi edhe përgjigje zyrtare lidhur me pretendimet e ankuesit. Në përgjigje thuhet se Sitel nuk ka asnjë përgjegjësi për deklaratën e personit, e cila është dhënë në transmetim të drejtpërdrejt dhe për të cilën redaktori i ditarit, Valentin Nikollovski menjëherë pas bërjes së deklaratës është distancuar nga e njëjta. Në përgjigje theksohet se rasti i apostrofuar nuk është pjesë e programit të Sitelit, por deklaratë personale e një burimi të njohur, e dhënë drejtpërdrejt, ndërsa Siteli nuk ka ndikim ndaj saj. Llatas theksoi se TV Sitel konsideroi se OSBE nuk ka mandat, as të drejtë të marrë qëndrim selektiv se me disa media do të komunikojë, e me të tjerë jo, prandaj qëndrimin e saj e konsideron si presion ndaj medias dhe tek personal i shefit të Misionit të OSBE-së.

Vendimi i Komisionit

Komisioni i Ankesave të Këshillit të Etikës në Media vendosi se ankesa e Misionit të OSBE-së është e bazuar. Kodi i gazetarëve në Maqedoni është i shkelur në nenet 10 dhe 11.

Arsyetime i vendimeve

Në mbledhjen e mbajtur më 20 mars të vitit 2015, Komisioni i Ankesave shqyrtoi pretendimet e ankuesit përkatësisht Misionit të OSBE-së në Maqedoni, përgjigjen e kryeredaktorit të TV Sitel Dragan P. Llatas dhe bëri shqyrtimin e lajmeve në fjalë. Nga videomateriali i lajmeve të TV Sitel, të transmetuara më 26 shkurt të vitit 2015, u vërtetua se Milenko Nedellkovski në pyetjen e gazetarit se çfarë do t'i porosis atë mbrëmje qytetarët në Kavadar, përgjigjet: "Po, do t'i porosis që kjo betejë finale e popullit maqedonas me tradhtarët në radhët e tij duhet të përfundojë në atë mënyrë që ata janë tradhtarë, qelbësira maqedonase, për fat të keq maqedonase, të groposen thellë dhe mbi ta të vendoset një pllakë e trashë, e fuqishme, me armaturë dhe e rëndë e betonit që më të mos kenë asnjë ndikim mbi atë që ndodh. Gjithashtu do të porosis se pajtohem me pohimin e Sasho Ordanovskit se në Maqedoni ka mashtrues (v.j bashkëbiseduesi e përdor fjalën *bitanga*). Por sipas meje mashtrues është pikërisht Sasho Ordanovski, njeri që 20 vite është lobues kosovar, i financuar nga nëntoka shqiptare e Kosovës, mashtrues është një njeri siç është Zoran Zaev, i cili është bashkëpunëtor i shërbimeve të huaja të inteligjencës dhe materialet i përdor për blekmejlim politik, do të thotë për shantazh politik, mashtrues është një njeri siç është Branko Geroski, i cili në shkrimet e tij pranonte se kur ka qenë ministre e Punëve të Brendshme, Dosta Dimovska, të cilën ai e quan Dostiç, është lajmëruar dhe ka pasur sukses të sigurojë lirimin e njerëzve që janë marrë me tregti përkatësisht kanë shitur materiale narkotike, janë marrë me tregëti me drogë. Me mashtrues të këtillë kemi punë, prandaj atyre duam tu bëjmë pllakë betoni, të cilën nuk do të mund as ta ngrenë". Pas përfundimit të lidhjes së drejtpërdrejt redaktori- moderator personalisht dhe në emrin e TV Sitel u distanca nga vokabulari i Nedellkovskit.

Komisioni e përshëndet dhe e vlerëson faljen e redaktorit, por një gjë e tillë nuk e ul peshën e gjuhës së urrejtjes, e shprehur nga bashkëbiseduesi. Gjatë marrjes së vendimit, Komisioni e mori parasysh nenin 10 të Konventës Evropiane për te Drejtat e Njeriut dhe Rekomandimin e R (97) 20 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për "gjuhë të urrejtjes" nga viti 1997, kur nocioni "gjuhë e urrejtjes" përkufizohet se i përfshin të gjitha format e shprehjes me të cilat përhapen, nxiten, promovohen ose arsyetohen urrejtja racore, ksenofobia, antisemitizmi ose forma tjera të urrejtjes të bazuara mbi jotolerancën.

Gjatë vlerësimit të dëshmive dhe vërtetimit të gjendjes faktike, Komisioni i mori parasysh qëllimin, përmbajtjen përkatësisht kontekstin e shprehjes dhe pasojat e

mundshme. Në rastin konkret u konstatua se bashkëbiseduesi ka pasur qëllim që të nxisë ose arsyetojë urrejtjen ndaj personave që i takojnë një grupi me pikëpamje të ndryshme politike nga ato që ai i ka.

Fakt plotësues është që kjo gjuhë vjen nga një person publik- gazetar, në kohën e tensioneve politike dhe është transmetuar në televizion kombëtar komercial maqedonas- TV Sitel. Sa i përket pasojave të mundshme, Komisioni vlerësoi se deklaratat e dhëna, përveç që e shkelin dinjitetin e individëve, gjithashtu mund të shprien drejt cenimit të rendit dhe qetësisë publike, të nxisin dhunë midis grupeve të caktuara shoqërore përkatësisht krim të urrejtjes ndaj personave që janë objekt i një gjuhe të këtyllë.

Për këtë shkak, Komisioni vlerësoi se media dhe gazetari kanë shkelur nenin 10 të Kodit, sipas të cilit gjuha e urrejtjes është e papërputhshme me etikën gazetareske. Rregullat etike dhe profesionale të gazetarëve u rekomandojnë përgjegjësi të veçantë për fjalën e thënë publike, sepse qëndrimet e tyre kanë ndikim të madh në formësimin e opinionit publik. Gjithashtu Komisioni erdhi në konkluzion se në rastin konkret gazetari nuk u është përmbajtur standardeve të përgjithshme të pranuar për dinjitetin dhe respektimin e diversiteteve përkatësisht se gazetari është përgjegjës edhe për deklaratimet nga ana e bashkëbiseduesve, sepse përmes tij këto qëndrime fitojnë publicitet, prandaj është i detyruar që t'i parafranojë ose qartë të distancohet nga gjuha e urrejtjes.

GAZETARI DUHET TË BËJË DALLIMIN MIDIS FAKTEVE DHE MENDIMIT (neni 13)

Mitko Andreevski për Veçerin

Konteksti

Gazeta ditore Veçer në numrat e 16, 17 dhe 18 nëntorit në publikimin elektronik të 15, 16 dhe 17 nëntorit të vitit 2016, në faqen kryesore, ndërsa edhe në faqet e brendshme, në rubrikën “Lajme”, publikoi një serë tekstesh me mbititull “Përse në Strumicë gazi është më i shtrenjtë se sa rryma?!” dhe me titujt “Pajtashi partiak i Zaevit merr miliona nga banorët e Strumicës përmes gazsjellësit”, më pas “Pajtashi i Zaevit ka marrë nga banorët e Strumicës 2.5 milion euro për 3 vjet!” dhe “Skandalin e tenderit të Zaevit dhe bashkëpartiaktut të tij Andreevski do ta kontrollojë Antikorrupsioni”. Bëhet fjalë për hulumtim, në të cilin media flet për furnizimin e Strumicës me gaz. Media përmes hulumtimit tenton të dëshmojë se furnizimi i qytetit me gaz bëhet në kurriz të qytetarëve, të cilët paguajnë shumë shtrenjtë, ndërsa fitimi i çmimeve tejet të larta shkon te kompania “SI EN XHI Sistem”, pronar dhe drejtor i së cilës është anëtar i trupave të partisë politike LSDM dhe i afërt i liderit të saj.

Ankesa

Zotëriu Mitko Andreevski, pronar dhe drejtor i “SI EN XHI Sistem”, përmes zyrës së avokatit Filip Medarski, parashtrori ankesë te Këshilli i Etikës në Media në Maqedoni lidhur me tre tekste. Në ankesë theksohet se në tekste raportimi është i pasaktë dhe jokorrekt, nuk është përfshirë pala e dytë dhe është shpifur. Parashtruesi i ankesës në shtojcë ka paraqitur edhe dëshmi- Kërkesë për përgënjeshttrim, kërkim falje dhe tërheqje publike të teksteve, për të cilat pohon se i është dorëzuar kryeredaktorit të gazetës, ndërsa paraqiti edhe vërtetime për praninë nga dërgesat me postë.

Përgjigja e medias

Zyra ekzekutive e KEMM-it, në pajtim me nenin 12 të Rregullores së Komisionit për Ankesa, pas pranimit të ankesës, kontaktoi me gazetën Veçer dhe kërkoi që kolegji i redaktues të prononcohet lidhur me ankesat. Nga atje nuk pati përgjigje.

Vendimi i Komisionit

Komisioni e pranoi ankesën dhe vlerësoi se është shkelur Kodi i Gazetarëve të Maqedonisë në nenet 1, 3 dhe 13. Komisioni konstatoi se bëhet fjalë për tekste në të cilat shkruhet për tema të interesit publik, por media nuk e ka siguruar “palën e dytë”, nuk e ka publikuar përgënjeshttrimin, përkatësisht nuk iu ka dhënë

mundësi të gjitha palëve të përfshira në tekstin gazetaresk ta shprehin qëndrimin e vet. Përveç kësaj, në tekste janë plasuar edhe komente, pa u bartur llogari për mungesën e fakteve.

Arsyetimi i vendimit

Në mbledhjen e mbajtur më 26 dhjetor të vitit 2016, Komisioni për Ankesa i shqyrtoi pohimet e parashtruesit të ankesës dhe shqyrtoi tekstet e parashtruara. Fillimisht, anëtarët e Komisionit konstatuan se bëhet fjalë për tre tekste analitike në seri dhe për rrethana të njëjta, sipas të cilave vendosën që tekstet ti bashkjojnë në një lëndë dhe të vendosin në tërësi. Komisioni vlerësoi se që të tre tekstet kanë të bëjnë me tema të interesit publik, sepse në to në mënyrë kritike analizohet puna e politikanëve dhe bartësve të funksioneve publike, në rastin konkret të kryetarit të Strumicës dhe liderit të LSDM-së Zoran Zaev, të Mitko Andreevskit, kryetar i Komisionit për Energjetikë në LSDM dhe drejtues i shoqatës “SI EN XHI SISTEM DOOEL- eksport import, Shkup” dhe të drejtorit të Ndërmarrjes Publike për Veprimtari Energjetike “Strumica gaz”, Zoran Kitanov. Si bartës të funksioneve publike, ndërsa në pajtim me Deklaratën për Lirinë e Debateve Politike në Këshillin e Evropës, ata i nënshtrohen mbikëqyrjes publike dhe kritikës lidhur me mënyrë në të cilën e kanë kryer ose e kryejnë funksionin e tyre (në atë masë që është e nevojshme që të sigurohet ushtrimi i funksioneve në mënyrë transparente dhe me përgjegjësi) dhe prej këtu ata nuk duhet të gëzojnë mbrojtje më të madhe të imazhit dhe të të drejtave të tjera nga individët e zakonshëm (neni III, IV dhe VI i Deklaratës).

Komisioni konstatoi se në tekstet “Pajtashi partiak i Zaevit merr miliona nga banorët e Strumicës përmes gazsjellësit” i publikuar në 16 nëntor të vitit 2016, “Pajtashi i Zaevit ka fituar nga banorët e Strumicës 2.5 milion euro për 3 vjet!” i publikuar në 17 nëntor të vitit 2016, autori e ka përdorur termin “pajdash”, i cili i dedikohet Andreevskit. Në fjalorin e gjuhës maqedonase termi “pajdash” është arkaizëm, pezhorativ nga fjala turke „pâydaş“, që do të thotë shok, mik dhe bashkëpunëtor. Kjo fjalë nuk ka përmbytje ofenduese si të tillë, megjithatë gazetari ka të drejtë të përdor edhe fjalë më të ashpra, ta teprojë dhe të provokojë, me qëllim që ta tërheq vëmendjen e opinionit ndaj mbrojtjes së interesit publik³⁷.

Gjatë marrjes së vendimit, gjithashtu, Komisioni konstatoi se anëtarët e saj nuk mundën dhe nuk kanë të drejtë ti vërtetojnë faktet e paraqitura në tekst, përkatësisht detyrë e tyre është të analizojnë zbatimin e standardeve etike dhe profesionale gjatë krijimit të prodhimit gazetaresk. Nisur nga ky fakt, Komisioni vlerësoi se autori i teksteve “Miku partiak i Zaevit merr miliona nga banorët e Strumicës përmes gazsjellësit” dhe “Miku i Zaevit ka fituar nga banorët e Strumicës

³⁷ Kjo theksohet në më shumë vendime gjyqësore të GJEDNJ, për shembull në Dichand and others v. Austria.

2.5 milion euro për 3 vjet!" ka vepruar pa pasur kujdes ndaj standardeve profesionale të profesionit gazetaresk dhe edhe pse për pohimet e tij ka kërkuar qëndrim nga Komuna e Strumicës nuk i ka dhënë mundësinë të gjitha palëve të përfshira ta tregojnë qëndrimin e tyre, përkatësisht konkretisht nuk ka kërkuar qëndrim edhe nga parashtruesi i ankesës, Andreevski. Postulat i profesionit gazetaresk është se kur hedhen dyshime dhe aty ku janë të përfshirë më shumë persona që janë objekt i kritikës, patjetër duhet të kërkohet qëndrim nga të gjithë personat e përmendur. Nëse nuk është e mundur që të sigurohet qëndrim nga të gjithë të përfshirët, një gjë e tillë duhet në mënyrë të thuktë të theksohet.

Nga dëshmitë e paraqitura dhe nga fjalja "Andreevski dje në përgënjeshttrim tha se nuk janë të vërteta informacionet se ka fituar dy tenderë nga Strumica, por të dhënat e Byrosë për Furnizime Publike e konfirmojmë atë që e publikoi Veçer", Komisioni konstatoi se Andreevski ka dërguar përgënjeshttrim në gazetën Veçer, i cili është pranuar, por autori vetëm ka njoftuar se ka mbërritur përgënjeshttrimi në redaksi, me të cilin hidhen poshtë informacionet e publikuara. Me mos publikimin e përgënjeshttrimit (korigjimit) në përputhje me standardet gazetareske, por edhe siç parashikojnë nenet 17 dhe 18 të Ligjit për Media, autori dhe gazeta sërish nuk kanë vepruar në pajtim me standardet profesionale të profesionit gazetaresk. Korigjimi është edhe e drejtë kushtetuese, kështu që media ia ka mohuar këtë të drejtë Andreevskit dhe ka publikuar vetëm se ka mbërritur përgënjeshttrimi, me të cilin mohohen informacionet.

Më tej, Komisioni vlerësoi se në dy nga tre tekstet nuk është përkufizuar se çfarë janë fakte dhe çfarë informacione dhe çfarë është supozim apo qëndrim i autorit. Në tekstin "Pajtashi i Zaevit ka fituar nga banorët e Strumicës 2.5 milion euro për tre vjet!" autori thekson: "Kombinimet tenderiale të Zaevit, familjarët e tij dhe bashkë-partiakët nuk janë risi për banorët e Strumicës. Mediat e publikuan të gjithë zinxhirin e tenderit të kryetarit të komunës së Strumicës përmes të cilit miliona euro të banorëve të Strumicës kanë përfunduar në firmat e Vices, por edhe babait, xhaxhait, kushërinjve dhe shokët e afërt të klanit Zaev". Në këtë mënyrë, ndërsa në bazë të pohimeve të përmendura më herët në tekst, autori qëndrimin e tij e mbulon në formën e faktit dhe informacioneve, më çka e dezinformon dhe e manipulon opinionin. Për këtë pohim, autori nuk thekson ndonjë fakt konkret.

Në tekstin "Skandali tenderial i Zaevit dhe bashkëpartiakut të tij Andreevski do ta kontrollojë Antikorrupsioni!" autori thekson: "Skandali i tenderit të Zaevit me kryetarin e tij partiak të Komisionit për Energjetikë është vetëm një nga një sërë tenderësh të cilët Zaev i ka ndarë për familjarët, miqtë dhe bashkë-partiakët. Mediat publikuan zinxhir të plotë të tenderëve të cilët Zaev ua ka ndarë vëllait të tij, xhaxhait, kushërinjve dhe të dëgjueshmëve partiak, me çka nga xhepi i qytetarëve të komunës së Strumicës janë marrë miliona euro". Në këtë mënyrë, ndërsa në bazë të pohimeve të mëhershme në vet tekstin, autori gjithashtu qëndrimin e tij

e mbulon në formë të faktit dhe informacioneve, me çka e dezinformon dhe e manipulon opinionin. Edhe për këtë pohim autori nuk paraqet fakt konkret.

Për shkak të të lartpërmendurës, Komisioni për Ankesa, konkludoi se tekstet e kontestueshme të publikuara në botimin e shtypur dhe në portalin onlajn të gazetës, gazeta ditore Veçer e ka shkelur nenin 1 të Kodit të Gazetarëve të Maqedonisë, sipas të cilit gazetari duhet të publikojë informacione të sakta, të konfirmuara dhe nuk do të fsheh të dhëna thelbësore dhe të falsifikojë dokumente. Nëse informacionet nuk mund të konfirmohen, ose bëhet fjalë për supozim, përkatësisht spekulim kjo duhet të tregohet dhe të publikohet. Vërtetësia e informacioneve duhet të kontrollohet aq sa të jetë e mundur. Përzgjedhja e fakteve duhet të sigurojë informacion objektiv dhe shqyrtim të të gjitha aspekteve të rëndësishme të temës për të cilën flitet. Gazetari duhet të sigurojë “palën e dytë”, përkatësisht t’i japë mundësi të gjitha palëve të përfshira në prodhimin gazetaresk ta paraqesin qëndrimin e tyre. Kjo posaçërisht në rastet kur gazetari hedh dyshime ose akuza, apo kur dikush është objekt i sulmit dhe kritikës.

Komisioni konkludoi gjithashtu se është shkelur neni 3, sipas të cilit media, përkatësisht gazetari duhet të sigurojë publikimin e korrigjimit, përgënjeshttrimit ose përgjigjes në rastin kur përcaktohet e pavërteta e informacionit. Përgjegjësia morale për informacionin e pavërtetë bie mbi gazetarin dhe për këtë është e rëndësishme që ai vet të ndikojë dhe të sigurojë publikimin e përgënjeshttrimit, korrigjimit ose përgjigjes në median në të cilën është publikuar informacioni, ndërsa autor i së cilës është vetë ai. Në këtë mënyrë, gazetari e mbron edhe integritetin personal, por edhe integritetin e medias në të cilën punon. Të gjitha gabimet duhet të konfirmohen dhe të korrigjohen. Pranimi i gabimit është guxim, ndërsa fshehja e tij nuk përputhet me integritetin dhe dinjitetin profesional.

Komisioni konkludoi gjithashtu se është shkelur neni 13, sipas të cilit gazetari duhet të bëjë dallimin midis fakteve dhe mendimeve, midis lajmit dhe komentit. Gazetarët e kanë të drejtën e mendimit të tyre, qëndrimin dhe gjykimin, por nuk guxojnë që mendimin e tyre personal ta kamufljnë si fakt. Duhet të jetë e qartë se çfarë janë faktet dhe informacionet, çfarë është komenti, supozimi ose qëndrimi i autorit me qëllim që të shmanget dezinformimi dhe manipulimi i opinionit.

Jane Dimeski për Kurir

Konteksti

Portali onlajn *Kurir* në 15 qershor të vitit 2016 në rubrikën Maqedoni, publikoi tekst me titullin: “Krahu shantazhues intelektual i LSDM-së me një sërë aferash”. Bëhet fjalë për tekst gazetaresk, i cili duhet të jetë vështrim dhe që nuk ka autor. Në tekstin “Krahu shantazhues intelektual i LSDM-së” kritikohen individë, gazetarë e profesorë, të cilët quhen kriminelë, hajna, gazetarë policor.

Ankesa

Te Zyra Ekzekutive e Këshillit të Etikës në Media në Maqedoni në 17 qershor të vitit 2016, personi Jane Dimeski parashtroi ankesë në të cilën theksohet se raportimi në tekst nuk është i saktë dhe nuk është korrekt.

Përgjigja e medias

Zyra Ekzekutive e Këshillit të Etikës në Media në Maqedoni, në pajtim me nenin 12 të Rregullores së Komisionit për Ankesa, pas pranimit dhe shqyrtimit të ankesës, me portalin onlajn *Kurir* me kërkesë që kolegji i editorial të deklarohet lidhur me pohimet në ankesë. Deri në mbledhjen e Komisionit për Ankesa pranë KEMM-it, *Kurir* nuk dha përgjigje për pohimet e parashtruesit të ankesës.

Vendimi i Komisionit

Komisioni për Ankesa vlerësoi se ankesa lidhur me tekstet, ka bazë dhe se është shkelur Kodi i Gazetarëve të Maqedonisë në nenet 1, 10, 13 dhe 15.

Arsyetimi i Vendimit

Në mbledhjen e 6 korrikut të vitit 2016, Komisioni për Ankesa i shqyrtoi pohimet e parashtruesit të ankesës Jane Dimeski dhe shqyrtoi tekstin e përmendur. Në tekstin "Krahu shantazhues intelektual i LSDM-së me një sërë aferash", mes të tjerash është theksuar: "Me hapat e fundit të cilat i ndërmerr kryetari i LSDM-së Zoran Zaev, opinionit iu bë e qartë se me partinë më të madhe opozitare maqedonase dhe njëherësh me gjithë opozitën nuk udhëheq Zaev, por i njëjti verbërisht i dëgjon dhe vetëm i përsërit qëndrimet e paraqitura nga krahu i shantazhuar intelektual i LSDM-së, i cili në realitet udhëheq me partinë. Zaev në periudhën e kaluar pa dyshime i ndiqte urdhrat e një grupi të personave të cilët janë të njohur për veprime anti-shtetërore, të bazuara në destruktivitet dhe komplekse personale, por edhe persona të cilët pas vetes kanë një sërë skandalesh dhe aferash. Në fakt, qëndrimet e Zaevit të ndërtuara pa mendime të shprehura më parë nga Lubomir Fërçkovski, Branko Geroski, Sasho Ordanoski dhe njeriu u parë i fondacionit të Sorosit në vend Vlladimir Millçin. Ajo që kjo katërshe do t'ia urdhëronte Zaevit, e njëjta menjëherë bëhej qëndrim edhe i liderit opozitar. Por, kush është i ashtuquajtur i krahu i shantazhuar intelektual, i cili për momentin i dikton qëndrimet e Zaevit dhe LSDM-së? Fërçkovski, Geroski, Ordanoski dhe Millçin pas vetes kanë një sërë aferash, të cilat tani në mënyrë skajshmërisht të papërgjegjshme dhe të dëmshme veprojnë, duke e mbajtur peng tërë shtetin dhe gjithë qytetarët."

Më tej, autori në tekst përcjellë deklarata të personave për punën e Lubomir Fërçkovskit si ministër, ndërsa më pas për punën e Vlladimir Millçinit (në cilësinë e kryetarit të OJQ-së) dhe të Geroskit dhe Ordanoskit si gazetarë. Siç mund të shqyrtohet në tekst, autori pohon se njeriu i parë i opozitës Zoran Zaev është këshilluar nga Lubomir Fërçkovski (ish ministër), Branko Geroski (gazetar) dhe

njeriu i parë i fondacionit të Sorosit në vend Vlladimir Millçin (kryetar i dikurshëm i OJQ-së) dhe qëndrimet e shprehura të Ordanoskit (gazetar) janë bërë edhe qëndrime të Zaevit dhe LSDM-së. Për këtë pohim, autori nuk ka ofruar kurrfarë dëshmie ose deklarate, nuk shkruan nëse bëhet fjalë për spekulim ose supozim, ndërsa as për këtë konstatim nuk ka siguruar palën e dytë dhe personave të lartpërmendur nuk iu ka mundësuar ta tregojnë qëndrimin e tyre për këtë pohim.

Gjithashtu, autori nuk bën dallimin statusor midis personave të përmendur, nuk bën dallimin midis interesit publik dhe interesit të publikut. Në tekstin konkret, qëllimi legjitim i kritikës gazetareske është ish ministri Lubomir Fërçkovski, i cili si ish bartës i funksionit publike është në mbikëqyrje dhe kritikë publike, në pajtim me Deklaratën për Lirinë e Debatit Politik në Media të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

Më tej, autori nuk bën dallimin midis fakteve dhe mendimit, midis lajmit dhe komentit dhe tregon se një pjesë të pohimeve për Ordanoskin paraprkishtë i ka konfirmuar edhe në kolumnën e paradokohshme edhe gazetari Dragan Pavloviq Llatas dhe citon pjesë ku janë përdorur fjalë vulgare. Për shkak të kësaj, Komisioni konstatoi se autori nuk e ka ruajtur kulturën e të folurit dhe etikës, duke përcjellë përmbajtje të cilat paraqesin komunikim të pashembullt me opinionin.

Në bazë të konstatimeve të lartpërmendura, Komisioni për Ankesa konkludoi se bëhet fjalë për shkelje të katër neneve të Kodit të Gazetarëve të Maqedonisë edhe atë nenit 1, 10, 13 dhe 15.

Në tekstin "Krahu shantazhues intelektual në LSDM me një sërë aferash", i publikuar në 15 qershor të vitit 2015, portali onlajn Kurir e ka shkelur nenin 1 të Kodit, përkatësisht detyrimin për të publikuar informacione të sakta dhe të verifikuara. Në tekst nuk ka "palë të dytë", përkatësisht asnjërit nga personat e përmendur në të nuk i është dhënë mundësia për ta treguar qëndrimin e vet. Kjo sidomos në rastet kur gazetari paraqet dyshime ose akuza, ose kur dikush është objekt i sulmit dhe kritikës, siç është rasti me tekstin e përmendur.

Komisioni për Ankesa konkludoi se në tekstin e kontestueshëm është shkelur neni 10 i Kodit, ku thuhet se gazetari me vetëdije nuk do të krijojë e as do të përpunojë informacione të cilat i rrezikojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, nuk do të flasë me gjuhën e urrejtjes dhe nuk do të nxisë dhunë dhe diskriminim në baza politike. Në rastin konkret, që nga fillimi i tekstit është e qartë se bëhet diskriminim politik i disa individëve. Këtë e tregon qartë nëntitulli: "Me hapat e fundit të cilat i ndërmerr lideri i LSDM-së Zoran Zaev, opinionit iu bë e qartë se me partinë më të madhe opozitare maqedonase dhe njëherësh me gjithë opozitën nuk udhëheq Zaevi, por i njëjti verbërisht i dëgjon dhe vetëm përsërit qëndrimet e shprehura nga krahu i shantazhuar intelektual në LSDM, e cila në të vërtetë udhëheq partinë". Gjithashtu edhe fjalia si dhe shumë të tjera se "Zaev në periudhën e kaluar pa dyshime i ndiqte urdhrat e një grupi të personave të cilët janë të njohur për veprime anti-shtetërore, e bazuar në destruksion dhe komplekse personale, por edhe persona të cilët pas vetes kanë një sërë skandalesh dhe aferash".

DISTANCA PROFESIONALE E SUBJEKTEVE POLITIKE (neni 14)

Ankesa: Lidija Dimova kundër Republikës

Konteksti

Edicioni onlajn i revistës “Republika” më 11 nëntor të vitit 2014 publikoi shkrimin me titull “Agjentët që marrin më shumë se sa meritojnë” i cili në aspektin e zhanrit është përzjerje e raportit dhe komentit. Në këtë shkrim akuzohen disa personalitete publike se punojnë për interesa të huaja, edhe pse në shkrim nuk vërtetohet konstatimi i titullit, ndërsa bëhet fjalë për shpifje të hapur.

Жалба

Lidija Dimova, deputete e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dorëzoi ankesë në të cilën kofirmon se shkrimi i “Republikës” nuk është i saktë dhe ka gënjeshtër tendencioze dhe si rezultat i kësaj konsideron se është cenuar reputacioni i saj si njeri, deputete e opozitës. Në ankesë theksohet se ajo ka frikë për sigurinë e saj, për shkak të fakti që shkrimi padyshim bën thirrje për urrejtje dhe dhunë.

Përgjigja e medias

Komisioni i Ankesave më 20 nëntor kërkoi përgjigje nga kryeredaktori i edicionit onlajn të “Republikës”, Biljana Zafirova. Në përgjigjen e saj më 28 nëntor thotë se gazetarët kanë obligim të shtrojnë dilema dhe çështje për punë që janë të rëndësishme në shoqëri. “Pikërisht këtë edhe e kemi bërë- ngritëm dilemë përkatësisht shtruar pyetjen: Kujt i përgjigjet plasimi i informacioneve që nuk janë në interes të Maqedonisë dhe të cilat i dëmtojnë pozicionet maqedonase për emrin? E gjithë kjo ishte e mbështetur me shkëputje të deklaratave dhe qëndrimeve të personave të përmendur për temën për të cilën flasim. Kryesisht, artikulli është i mbështetur me printskrin dhe linqe të deklaratave e qëndrimeve të personave të përmendur. As deklaratat nuk janë të menduara, e as fotografitë printskrin janë të falsifikuara dhe të montuara.” Në përgjigje thuhet edhe se në shkrimin e publikuar në asnjë moment nuk bëhet thirrje për linçim publik dhe se nuk rrezikohet asnjë jetë.

Vendimi i Komisionit

Komisioni vendosi se ankesa është e bazuar, ndërsa Kodi i gazetarëve të Maqedonisë është i shkelur në nenet 1, 10 dhe 13.

Arsyetimi i vendimit

Komisioni i Ankesave konstatoi se në shkrimin e përmendur, pa autor të shënuar, bëhet fjalë për shkeljen e rëndë të tri neneve të Kodit të gazetarëve të Maqedonisë. Më konkretisht në shkrim nuk ka “palë të dytë”, ndërsa autori i panjohur nuk ka

verifikuar të dhënat dhe saktësinë e tyre, që janë imperative morale të gazetarisë. Në shkrim gjithashtu nuk bëhet dallimi midis fakteve dhe mendimeve dhe midis lajmit e komentit. Gazetarët kanë të drejtë të kenë mendimin e tyre, qëndrimin dhe gjykimin vlerësues, por autori i panjohur mendimin e tij personal e kamuflon si fakt. Vlerësim i Komisionit është se edhe në shkrim plasohen dezinformata dhe manipulime për shkak të motiveve politike. Gjithashtu, shkrimi është përplot fyerje dhe diskualifikime personale.

Komisioni i Ankesave vë në pah se Kodi etik dhe profesional i gazetarëve i rekomandon përgjegjësi të veçantë për fjalën e shprehur publike. Qëndrimet e tyre janë faktorë të rëndësishëm në formësimin e opinionit publik dhe për këtë shkak gjuha e urrejtjes është e papërputhshme me etikën gazetareske.

Komisioni konstatoi se shkrimi është përplot me pohime të pambështetura me fakte dhe argumente, veçanërisht në fillimin dhe fundin e shkrimit. Pohimi se një individ punon për interesa të huaja, nëse nuk mbështetet tek informacionet e verifikuara është shpifje dhe përhapje e urrejtjes. Për më tepër, titulli "Agjentë që marrin më shumë nga se meritojnë" vetvetiu është pohim i fuqishëm që aspak nuk korrespondon me përmbajtjen e shkrimit. Kjo aspak nuk është çështje ose dilemë në të cilën në shkrim jepet përgjigje. Ky pohim me asgjë nuk është mbështetur në shkrim dhe prandaj mund të vlerësohet si shpifje.

Ankesa: Artan Grubi për Tetova sot

Konteksti

Në portalin *Tetova sot* më 28 shkurt të vitit 2015 është publikuar shkrimi me titull "Lodraxhiu ka frikë që të mos i plasë lodra, kërkon ekspert nga Brukseli". Në këtë shkrim theksohen konstruksione ndaj Artan Grubit, deputet dhe shef i kabinetit të kryetarit të BDI-së.

Ankesa

Te Zyra Ekzekutive e Këshillit të Etikës në Media më 6 mars të vitit 2015 nga ana e Artan Grubit është parashtruar ankesë, në të cilën thuhet se shkrimi përmban fyërje, gënjeshtër, shpifje, urrejtje dhe sjellje joetike për shkak të motiveve politike.

Përgjigja e medias

Zyra ekzekutive e Këshillit, menjëherë pas pranimit të ankesës, e ridërgoi deri te portali i internetit *Tetova sot* me kërkesë që kolegji i redaksisë të deklarohet rreth pretendimeve në ankesë. Në përgjigjen e redaksisë së *Tetova sot* thuhet se pjesërisht pajtohen me argumentet e parashtruara lidhur me informimin joetik, duke u nisur nga ideja për vendosjen e standardeve etike në media. Theksojnë edhe se shkrimi konkret është i menduar në formë të kozerisë, i cili si zhanër gazetaresk mundëson lirinë më të gjerë të shprehjes, e cila nuk është edhe aq strikte si raporti dhe nuk ka për qëllim të diskreditojë, të fyejë dhe tu kundërvihet standardeve etike. Në vazhdim të përgjigjes thuhet se janë të hapur për bashkëpunim edhe për qartësimin e situatës dhe se qëndrojnë në disponim në procesin e mëtejshëm të dialogut dhe ndërmjetësimit dhe se i pranojnë propozimet e KEMM.

Vendimi i Komisionit dhe arsyeshmëria

Artan Grubi pas përgjigjes së marrë nga redaksia e *Tetova sot*, theksoi se pret tërheqje të shkrimit ndaj të cilit ka reaguar si dhe publikimin e kërkim faljes deri te ai në hapësirën e njëjtë ku është publikuar shkrimi.

Me kërkesë të Grubit nga *Tetova sot* u përgjigjën se shkrimi është menjanuar, por dhe nuk shohin nevojë për falje sepse bëhet fjalë për kozeri! Pas kësaj Komisioni u drejtua sërish te Artan Grubi me kërkesë që të deklarohet se vallë është i kënaqur vetëm me menjanimin e shkrimit, me shënimin se nëse nuk deklarohet në periudhën e përfshirë me afatet e Rregullores së Këshillit, procedura do të ndërpritet. Artan Grubi nuk u deklarua.

Duke pasur parasysh se u tejkaluan afatet që parashikon Rregullorja, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik të vitit 2015, Komisioni i Ankesave vendosi ta mbyllë rastin.

GAZETARI DO TË RUAJË REPUTACIONIN DHE DINJITETIN E PROFESIONIT TË TYRE (neni 16)

Branko Geroski për Kanal 5

Konteksti

Televizioni Kana 5, në lajmet e 13 nëntorit të vitit 2014 transmetoi intervistë në studio të kryeredaktores Lidija Bogatinova me Ivica Bocevskin, ish zëvendëskryeministër për integritet evropian. Shkas i intervistës ishin marrëdhëniet greko-maqedonase dhe çështja e emrit. Por në të u përmendën edhe personalitete nga Maqedonia që “janë jashtë politikës aktuale” dhe të cilët gjoja kanë “manipuluar me interesat e Maqedonisë”.

Ankesa

Gazetari Branko Geroski, i cili është njëri nga të përmendurit në intervistën e Lidija Bogatinovës me Ivica Bocevskin, parashtrori ankesë deri te Këshilli i Etikës në Media. Në ankesë, ai thekson se fjalitë e thëna në intervistë janë kualifikime shpifëse dhe fyese dhe i shkaktojnë dëm reputacionit dhe nderit të tij. Bëhet fjalë për deklaratën e Bogatinovës: “Deri ku do të shkojë manipulimi i këtillë i vetëdijshëm me interesat e Maqedonisë, kur edhe vetë Venizellos pardje deklaroi se deri në zgjedhje nuk do të ketë kurrëfarë zhvendosjesh në negociatat për emrin. Apo duket se Geroski është grek më i madh edhe se Venizellos?” Në fund të intervistës Bogatinova flet për “...ata agjentë që tentojnë t’i cenojnë pozitat e Maqedonisë në negociatat për emrin”. Geroski në ankesë shton: “Duke pasur parasysh se në intervistë konkretisht përmenden dy emra, unë dhe Lubomir Fërçkovski, dukshëm është se cilësimi i zonjës Bogatinova ka të bëjë me mua.”

Përgjigja e medias

Zyra ekzekutive e KEMM drejtoi shkresë me kërkesë që kryeredaktorja e Kanal 5, Lidija Bogatinova të deklarohet lidhur me pretendimet e ankesës. Kanal 5 përkatësisht Bogatinova në përgjigjen e saj kërkoi që Komisioni të pyet Geroskin çfarë ka shkruar dy ditë para intervistës me Bocevskin përkatësisht vallë e di se çka ka deklaruar Venizellos tre ditë para deklaratës së Geroskit.

Ajo në përgjigje shkruan: “Venizellos deklarantën e ka dhënë të hënë më 10 nëntor të këtij viti, ndërsa Geroski në portalin e tij shkruante gjerësisht ditën e ardhshme, të martën më 11 nëntor. Negociatat u mbajtën më 12 nëntor, ndërsa unë me Bocevskin biseduam një ditë më pas.” Ajo apostrofoi që Komisioni të kërkojë nga Geroski të dorëzojë linqet e përmendura të shkrimeve.

Vendimi i Komisionit

Ankesa pranohet. Komisioni i Ankesave konstatoi se në intervistën e përmendur bëhet fjalë për shkeljen e tri neneve të Kodit të gazetarëve të Maqedonisë: 10, 11 dhe 16.

Arsyetimi i vendimit

Duke pasur parasysh ankesën dhe përgjigjen, Komisioni i Ankesave konstatoi se bëhet fjalë për intervistë që midis tjerash është shfrytëzuar edhe për shprehjen e raportit jotolerant dhe gjuhë fyese ndaj individëve që mendojnë ndryshe (neni 10). Komisioni veçanërisht e theksoi mospranimin e fyerjeve të bëra nga ana e bashkëbiseduesit në intervistë. Gazetari është përgjegjës edhe për të thënat nga bashkëbiseduesit, sepse përmes tij ato qëndrime fitojnë publicitet, prandaj është i detyruar që të distancohet nga gjuha fyese ose nga promovimi i gjuhës së urrejtjes. (neni 11).

Gjithashtu, as gazetarët, as redaktorët nuk duhet të lejonin të qërojnë hesapet me kolegët e tyre përmes mediave të veta (neni 16). Sjellja e tillë jo vetëm që e ul integritetin dhe dinjitetin e tyre, por e rrënon reputacionin e profesionit gazetaresk në përgjithësi dhe e ul besueshmërinë e publikut ndaj mediave.

Zoran Fidanovski për Netpres

Konteksti

Portali i internetit *Netpres* më 16 mars të viti 2016 publikoi shkrimin me titull “FOTO: LSDM dëshiron ligj për censurë partiake në media”. Bëhet fjalë për shkrim i marrë nga një portal tjetër, në të cilin flitet për aktivitetet e Zoran Fidanovskit, gazetar dhe anëtar i Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale Mediatike (ASHAAM), për të cilat aktivitete autori i shkrimit konsideron se nuk përputhen me funksionin e Fidanovskit në ASHAAM. Ndërsa si ilustrim shfrytëzohen edhe fotografi të dhe profili personal i Fidanovskit në Fejsbuk.

Ankesa

Gazetari dhe anëtar i ASHAAM Zoran Fidanovski më 21 mars të vitit 2016 ngriti parashtrësë deri te Zyra ekzekutive e Këshillit të Etikës në Media në Maqedoni, për shkrimin me titull “FOTO: LSDM dëshiron Ligj për censurë partiake në media”, i publikuar nga ana e portalit *Netpres*. Ai në ankesën e tij thekson se shkrimi përmban insinuata me të cilat drejtpërdrejt sulmohet personaliteti i tij dhe cenohet reputacioni, nderi dhe integriteti profesional, ndërsa si ilustrim shfrytëzohen edhe fotografi nga profili i Fejsbukut, në të cilat ka edhe anëtarë të familjes së tij, të cilët me këtë i janë nënshtruar atakimit ndaj integritetit të tyre.

Fidanovski ankesën e tij e orienton tek një pjesë e shkrimit në të cilin thuhet “Kështu gazetari Zoran Fidanovski, i cili duket i afërt i LSDM-së, edhe më tej në terren i ofron mbështetje maksimale partisë opozitare. Ai ishte pjesë e protestave të mbështetura drejtpërdrejt nga Zoran Zaev”. “Fidanovski ishte i zgjedhur anëtar i Këshillit të Agjencisë, në korrik të vitit 2014. Ka mandat prej 7 viteve. Megjithatë, duket qartë se ose nuk e ka lexuar Kodin etik ose me vetëdije e shkel. Ky gazetar qartë i jep mbështetje LSDM-së, edhe pse kjo është e ndaluar në përshkrimin e vendit të tij të punës”- shkruan Kurir. Në ankesë Fidanovski thekson se shkrimi përmban insinuata me të cilat drejtpërdrejt sulmohet personaliteti i tij dhe cenohen reputacioni, nderi dhe integriteti profesional, ndërsa si ilustrim janë shfrytëzuar edhe fotografi nga profili i tij në Fejsbuk, në të cilat ka edhe anëtarë të familjes së tij, të cilët me këtë veprim u janë ekspozuar sulmeve ndaj integritetit të tyre. Si informacione të pasakta që prezantohen në shkrim Fidanovski i thekson pretendimet në vijim “Edhe pse është e ndaluar në përshkrimin e vendit të tij” dhe “Ose nuk e ka lexuar Kodin etik ose me vetëdije ka zgjedhur të njëjtin ta shkel”. Fidanovski thotë se në protestë ka qenë i pranishëm si qytetar, duke shfrytëzuar të drejtën kushtetuese publikisht të protestojë ndaj çikaje me të cilën nuk pajtohet, ndërsa në rastin konkret nuk pajtohet me vendimin e miratuar nga shumica e Gjykatës Kushtetuese, vendim me të cilin presidenti i shtetit do të mund të falë “kriminelë zgjedhorë, pedofilë dhe narkodilerë”.

Përgjigja e medias

Zyra ekzekutive e KEMM, në pajtim me nenin 12 të Rregullores së Komisionit të Ankesave, pas pranimit dhe shqyrtimit të ankesës, hyri në kontakt me portalin *Netpres*, me kërkesë që kolegji i redaktues të deklarohet lidhur me pohimet në ankesë. Në përgjigjen e kryeredaktorit Dejan Nikollovski thuhet se shkrimi nuk është autorial i Netpressit, por është marrë nga portali Kurir, gjë që është edhe theksuar. Nikollovski thekson se Fidanovski, si anëtar i Agjencisë së Shërbimeve Audio dhe Shërbimeve Audivizuale dhe Mediatike, patjetër është dashur të ketë parasysh se assesi nuk ka guxuar t'ia lejojë vetes pjesëmarrjen në një protestë dhe tubim partiak, sepse siç thuhet “me këtë hap drejtpërdrejt diskreditohet si personalitet, e diskrediton punën e tij dhe institucionin ku punon, më saktësisht e partizon të njëjtin”. Në vazhdim të përgjigjes, kryeredaktori thotë se pjesëmarrja e Fidanovskit në një protestë të opozitës e vë në pikëpyetje profesionalizmin gjatë kryerjes së punës së tij si anëtar i Këshillit të Agjencisë së Shërbimeve Audio dhe Shërbimeve Audiovizuale Mediatike (AMSHAM), për të cilin shkak *Netpres* vendosi të marrë dhe ta bëjë shkrimin e përmendur.

Vendimi i Komisionit

Parashtesa u pranua. Komisioni vërtetoi se Kodi i Gazetarëve në Maqedoni është i shkelur në nenet 1, 13 dhe 16.

Arsyetimi i vendimit

Komisioni i Ankesave vlerësoi se shkelja e nenit 1 të Kodit të Gazetarëve është më i shprehur në rastin konkret, sepse vetë *Netpres* ka bërë vlerësim redaktorial që të publikojë shkrimin. Duke pasur parasysh se bëhet fjalë për shkrim të kopjuar, Komisioni konsideron se portali *Netpres*, para se ta publikojë shkrimin kontestues, duhet të verifikojë faktet dhe ta konsultojë palën e dytë.

Komisioni, gjithashtu, konstatoi se është shkelur neni 13, sipas të cilit gazetarët kanë të drejtë të kenë mendimin e tyre, qëndrimin ose gjykimin vlerësues, por nuk guxojnë që mendimin e tyre ta kamuflojnë si fakt. Për shembull në qëndrimin se “Fidanovski u zgjodh për anëtar të Këshillit të Agjencisë në korrik të vitit 2014. Ka mandat prej 7 vitesh. Megjithatë, siç duket nuk e ka lexuar Kodin etik ose me vetëdije ka vendosur që të njëjtin ta shkel. Ky gazetar publikisht i jep mbështetje LSDM-së, edhe pse kjo është e ndaluar në përshkrimin e vendit të tij të punës...”

Më tej, Komisioni i Ankesave vërtetoi se është shkelur neni 16, sipas të cilit gazetari do të ruajë reputacionin dhe dinjitetin e profesionit të tij, do të nxisë solidaritetin dhe diversitetin e qëndrimeve dhe nuk do ta përdor median e tij për qërim hesapësh me personalitete, duke i përfshirë kolegët e tyre.

Pasqyra e ankesave të dorëzuara te Komisioni i Ankesave

Parashtrues i ankesës dhe emri i medias kundër së cilës është ngritur ankesa	Baza e ankesës	Vendimet e Komisionit të Ankesave	Data e miratimit të vendimeve
Koalicioni "Të drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara" dhe Aleanca e Grave kundër Veçer, puls24.mk, kurir.mk dhe infomax.mk	Gjuhë e urrejtjes, raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Hidhet poshtë, ankesë e vonuar	20.3.2017
Shkolla e mesme private "Jahja Kemal" kundër aa.com.tr	Shpifje	Hidhet poshtë, jashtë kompetencave	14.3.2017
Shkolla e mesme private "Jahja Kemal" kundër aa.com.tr	Shpifje	Hidhet poshtë, jashtë kompetencave	14.3.2017
Enver Gashi kundër telegrafi.com	Mospasja e burimit, shkelja e të drejtave të autorit	Hidhet poshtë, jashtë kompetencave	14.3.2017
Sllagjana Taseva Petrovska kundër Veçerit	Shpifje	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	10.3.2017
Sllagjana Taseva Petrovska kundër kurir.mk	Shpifje	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	10.3.2017
Sllagjana Taseva Petrovska kundër Televizionit Sitel	Shpifje	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	10.3.2017
Transparensi Interneshenëll kundër Televizionit Sitel	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, mospasja e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	10.3.2017
Transparensi Interneshenëll kundër Televizionit Kanal 5	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, mospasja e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, neni 1.	09.3.2017
Transparensi Interneshenëll kundër Televizionit Alfa	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, mospasja e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	09.3.2017
Transparensi Interneshenëll kundër Televizionit Nova	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, mospasja e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	10.3.2017
Transparensi Interneshenëll kundër vecer.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, mospasja e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	09.3.2017
Transparensi Interneshenëll kundër start.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, mospasja e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	09.3.2017

Transparensi Interneshenëll kundër kurir.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, mospasja e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	09.3.2017
Transparensi Interneshenëll kundër republika.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, mospasja e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	09.3.2017
Sashka Cvetkovska kundër Vest	Diskriminim, pabarazi midis gjinive dhe mosrespektim i privacisë personale	Ankesa është e bazuar, nenet 7,8 dhe 11.	09.3.2017
Ilina Arsova kundër ohrid1.com	Shpifje, gjuhë e urrejtjes, mospasja e palës së dytë	Ankesa është e bazuar	09.3.2017
Maksim Dimitrievski kundër zurnal.net	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4, 13 dhe 14.	09.2.2017
Angella Ilievska kundër puls24.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, gjuhë e urrejtjes, diskriminimi, të drejtat e autorit, cenimi i privacisë, anim në informim, mospasja e palës së dytë, fyerje, shpifje	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 7, 10, 13 dhe 15.	09.2.2017
Avokati i Popullit të Republikës së Maqedonisë kundër Televizionit Telma	Diskriminim, fyerje	Ankesa është tërhequr për shkak të kërkimit të faljes nga media	
Shkolla e mesme private "Jahja Kemal" kundër aa.com.tr	Gjuhë e urrejtjes, fyerje	Ankesa është e pabazë	24.1.2017
Mark Branov kundër Nova Makedonija	Raportim jo i saktë	Ankesa është e bazuar, neni 1.	24.1.2017
Jane Dimevski kundër TV NOVA	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, anim në informim, mospasje e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, neni 1 dhe 13.	24.1.2017
Jane Dimeski kundër republika.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, anim në informim, mospasje e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	24.1.2017
Banka Popullore kundër maktel.mk	Titull jo i saktë	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 13 dhe 14.	16.1.2017
Marjan Çabukovski kundër infomax.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, neni 1.	16.1.2017

Jane Dimeski kundër TV NOVA	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, gjuhë e urrejtjes, anim në informim, mospasje e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 13	16.1.2017
Jane Dimeski kundër republika.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, gjuhë e urrejtjes, anim në informim, mospasje e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 16.	16.1.2017
Mitko Andreevski kundër Veçerit	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, mospasje e palës së dytë, shpifje	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 3 dhe 13.	09.1.2017
Jane Dimeski kundër centarnews.net	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt dhe mospasje e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4, 13 dhe 14.	23.12.2016
Jane Dimeski kundër netpress.com.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, anim në informim, mospasje e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4, 13 dhe 14.	23.12.2016
Vanja Micevska kundër Televizionit Nova	Cenimi i privacisë, fyerje	Ankesa është e pabazë	20.12.2016
Milla Carovska kundër TV Sitel	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, cenimi i privacisë, anim në informim, mospasje e palës së dytë, fyerje dhe shpifja	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 8 dhe 13.	20.12.2016
Nëpunësit policorë në Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë kundër press24.mk dhe infomax.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, cenimi i privacisë, reputacionit dhe dinjitetit	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4, 7, 13 dhe 14.	20.12.2016
Shkolla e mesme private "Jahja Kemal" kundër fryma.org	Gjuha e urrejtjes, diskriminimi	Hidhet poshtë, jashtë kompetencave	12.12.2016
Arijanit Xhaferi kundër zhurnal.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 10 dhe 13.	21.11.2016
Xhelal Neziri kundër gostivari24.com	Shpifje	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 4.	21.11.2016
Vanja Micevska kundër reporter.mk	Cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4, 7, 8 dhe 12.	21.11.2016
Marina Janevska kundër dokaz.mk	Shprehje joetike	Ankesa është e bazuar, neni 15.	26.10.2016

German Fillkov dhe Sabina Fakiq kundër TV ALFA	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, gjuha e urrejtjes, cenimi i privacisë, animi në informim, mospasja e palës së dytë, fyerje, shpifje	Procedura ndërpritet për shkak të afateve të tejkaluara sipas Rregullores	26.10.2016
Dimiar Bogov kundër TV 24	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, neni 1.	13.9.2016
Ivana Dimitrovka kundër Utrinski vesnik	Mosmbrojtja e publikut të mitur, cenimi i privacisë, mosmbrojtja e fëmijëve dhe publikut të mitur	Ankesa është e bazuar, nenet 7,8 dhe 9.	01.9.2016
Xhevdet Pozhari kundër zhurnal.mk	Shpifje nga raportimi jo i saktë, cenimi i privacisë, cenimi i nderit dhe reputacionit	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 3 dhe 7.	01.9.2016
Kim Mehmeti kundër zhurnal.mk	Shpifje nga raportimi jo i saktë, cenimi i privacisë, cenimi i nderit dhe reputacionit	Ankesa është e bazuar, nenet 1,3 dhe 7.	01.9.2016
Jugoinfo.mk kundër strumicadenes.mk	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt, të drejtat e autorit të cenuara	Palët janë pajtuar përmes ndërmjetësimit	13.9.2016
Komisioni Shtetëror për pengimin e korrupsionit kundër zhurnal.mk	Pasaktësi, urrejtje ndëretnike dhe diskreditim	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 10, 11 dhe 13.	01.9.2016
Gjorgji Ugrinovski kundër Fokus	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, cenimi i privacisë, mospasja e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, neni 1.	01.9.2016
Todor Tërçevski kundër motika.com.mk	Gjuhë e urrejtjes, diskriminim. raportim jo i saktë dhe jokorrekt, anim në informim, pabarazi e gjinive	Ankesa hidhet poshtë	01.9.2016
Arif Ademi kundër vicoteka.mk	Gjuhë e urrejtjes, diskriminim	Ankesa hidhet poshtë, jashtë kompetencave	04.8.2016
Vasko Magleshev kundër telegraf.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, neni 16.	18.7.2016

Koalicioni "Të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara" kundër puls24.mk	Gjuhë e urrejtjes mbi bazën e orientimit seksual dhe identiteti seksual, shpifje, raportim jo i saktë dhe jokorrekt dhe diskriminim	Ankesa është e bazuar, nenet 10, 11, 13 dhe 14.	18.7.2016
Televizioni kundër telegraf.mk	Diskriminim	Ankesa është e bazuar, neni 16.	18.7.2016
Koalicioni "Të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara" kundër infomax.mk	Gjuhë e urrejtjes mbi bazën e orientimit seksual dhe identiteti seksual, shpifje, raportim jo i saktë dhe jokorrekt si dhe diskriminim	Ankesa është e bazuar, nenet 10, 11, 13 dhe 14.	08.7.2016
Koalicioni "Të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara" kundër zurnal.net	Gjuhë e urrejtjes mbi bazën e orientimit seksual dhe identiteti seksual, shpifje, raportim jo i saktë dhe jokorrekt dhe diskriminim	Ankesa është e bazuar, nenet 10, 11, 13 dhe 14.	08.7.2016
Sasha Bogdanoviç kundër infomax.mk	Fyerje, shpifje, raportim jo i saktë dhe joprofesional	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13	08.7.2016
Sasha Bogdanoviç kundër zurnal.net	Fyerje, shpifje, raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13	08.7.2016
Sasha Bogdanoviç kundër puls24.mk	Fyerje dhe shpifje, raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13	08.7.2016
Elida Zylbeari kundër zhurnal.mk	Gjuha e urrejtjes, cenimi i privacisë, mospasja e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, nenet 13, 15 dhe 16.	08.7.2016
Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë kundër plusinfo.mk	Raportim joprofesional dhe joetik	Ankesa hidhet poshtë për shkak të vonësës	06.6.2016
Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë kundër ALSAT M	Raportim joprofesional dhe joetik	Ankesa hidhet poshtë për shkak të vonësës	06.6.2016
Lëvizja e Majtë "Solidarnost" kundër Dnevnik	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt, gjuhë e urrejtjes, diskriminim, cenim i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 7, 10, 11, 13 dhe 16.	06.6.2016
Ognen Uzunovski kundër infomax.mk	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 7, 10 dhe 13.	06.6.2016

Dushica Mërgja kundër zhurnal.net	Cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet. 7, 1, 13 dhe 16.	06.6.2016
Dushica Mërgja kundër puls24.mk	Cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 7, 1, 13 dhe 16.	06.6.2016
Dushica Mërgja kundër netpress.com.mk	Cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 7, 1, 13 dhe 16.	06.6.2016
Dushica Mërgja kundër TV Sitel	Cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 7,1, 13 dhe 16.	06.6.2016
Dushica Mërgja kundër kurir.mk	Cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 7,1, 13 dhe 16.	06.6.2016
Qendra për Analiza Ekonomike kundër Fokus	Të drejtat e autorit	Ankesa është e pabazë	06.6.2016
Transparensi Intershenëll kundër zhurnal.mk	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	06.6.2016
Ana Simova kundër babinlek.com	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa hidhet poshtë, jashtë kompetencave	10.5.2016
JGBTI Qendra për mbështetje, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriu dhe Koalicioni "Të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara" kundër zurnal.net	Diskriminimi dhe gjuha e urrejtjes	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 10, 13 dhe 14.	11.5.2016
Nikolla Jovanovski kundër TV Sitel	Shkelje e Kodit dhe Ligjit për ASHAAM	Ankesa hidhet poshtë, për shkak të mos ofrimit të informacioneve të plota	24.4.2016
Bratolub Shurllanoviç kundër TV Sitel 2	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa hidhet poshtë, për shkak të mos ofrimit të informacioneve të plota	24.4.2016
Elena Arsova kundër TV Sitel	Shkelje e Ligjit të ASHAAM	Ankesa hidhet për shkak të vonesës	04.4.2016
Bratolub Shurllanoviç kundër TV Sitel	Shkelje e Kodit dhe Ligjit për ASHAAM	Ankesa hidhet poshtë, për shkak të mos ofrimit të informacioneve të plota	24.4.2016
Grupi i punës "Solidariteti për mobilitet" kundër TV Sitel	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet. 1 dhe 13.	11.4.2016
Grupi i punës "Solidariteti për mobilitet" kundër kurir.mk	Gjuhë e urrejtjes	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	11.4.2016
Grupi i punës "Solidariteti për mobilitet" kundër press24.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	11.4.2016
Grupi i punës "Solidariteti për mobilitet" kundër netpress.com.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	11.4.2016

Zoran Fidanovski kundër kurir.mk, denesen.mk, netpress.com.mk dhe TV Sitel	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, cenimi i reputacionit dhe nderit	Ankesa është e bazuar, nenet. 1, 13 dhe 16.	11.4.2016
Koalicioni "Të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara" kundër zurnal.net	Gjuhë e urrejtjes, diskriminim	Ankesa hidhet për shkak të vonesës	21.3.2016
Frosina Pandurska kundër think.mk	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt, nuk është kontaktuar pala e dytë	Ankesa hidhet për shkak të vonesës	23.2.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër kurir.mk 4	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje	Ankesa është e bazuar, nenet 1,13 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër zhurnal.net	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje, cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4, 13 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër kurir.mk 3	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje, cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet. 1, 4, 13 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër puls24.mk 3	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje, cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 1,13 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër republika.mk 2	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje, cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 13 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër netpress.com.mk 2	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje, cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 13 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër denesen.mk	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje, cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër TV Sitel 3	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje, cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4, 13 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër Veçer 3	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 13 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër netpress.com.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje, cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 14.	08.3.2016

MOST dhe Darko Aleksov kundër puls24.mk 2	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje, cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet. 1, 4, 13 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër Veçer 2	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje, cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet. 1, 4, 13 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër kurir.mk 2	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje, cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër puls24.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër republika.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër TV Sitel 2	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër kurir.mk	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 13 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër Veçer	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 13 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov TV ALFA	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 13 dhe 14.	08.3.2016
MOST dhe Darko Aleksov kundër TV Sitel	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, shpifje	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 14.	08.3.2016
Kryepeshkopi Stefan Veljanovski kundër libertas.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, mospasja e palës së dytë, përzjerja e fakteve dhe mendimeve	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4 dhe 11.	08.3.2016
Kryepeshkopi Stefan Veljanovski kundër libertas.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, mospasja e palës së dytë, përzjerja e fakteve dhe mendimeve	Palët u pajtuan përmes ndërmjetësimi	08.3.2016
Artan Grubi kundër Iajmpress.com	Fyerje, shpifje, gënjeshërë, urrejtje, raportim jo etik	Ankesa hidhet poshtë për shkak të vonesës	10.2.2016

Koalicioni "Të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara" kundër "Shoqata HOPS – Opsionet për jetë të shëndoshë dhe Shoqata STAR STAR kundër TV Kanal 5	Mospasja e palës së dytë, mos mbrojtja e të dhënave personale	Ankesa është e bazuar, nenet 7, 10, 11 dhe 13.	11.3.2016
Marjan Nikollovski kundër maktel.mk	Gjuhë e urrejtjes	Ankesa është e bazuar, nenet 7, 10, 11, 15 dhe 16.	17.2.2016
LGBTI- Qendra për Mbështetje, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë dhe Koalicioni "Të drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizuara" kundër puls24mk	Diskriminimin, gjuha e urrejtjes, informim jo i vërtetë, shpifje	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 10, 11 dhe 13.	17.2.2016
Jane Dimeski kundër Dnevnikut	Raportimi jo i saktë dhe jokorrekt, mospasja e palës së dytë	Ankesa është e bazuar, neni 1.	17.2.2016
Vangell Andreski kundër kurir.mk 2	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e pabazë	25.1.2016
Vangell Andreski kundër kurir.mk	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4, 10 dhe 13.	21.1.2016
Vangell Andreski kundër vistina.mk	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e pabazuar	21.1.2016
Vangell Andreski kundër rsm.mk	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e pabazë	21.1.2016
Vangell Andreski kundër netpress.com.mk	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e pabazë	21.1.2016

Vangell Andreski kundër denesen.mk	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e bazuar 1, 4, 10 dhe 13.	21.1.2016
Vangell Andreski kundër infomax.mk	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e bazuar 1, 4, 10 dhe 13	21.1.2016
Sasha Boganoviq kundër infomax.mk	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e bazuar 1, 4, 10 dhe 13	21.1.2016
Sasha Boganoviq kundër kurir.mk	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e pabazë	21.1.2016
Sasha Boganoviq kundër kurir.mk 2	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4, 10 dhe 13	21.1.2016
Sasha Boganoviq kundër press24.mk 2	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4 dhe 13	21.1.2016
Sasha Boganoviq kundër press24.mk	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e pabazë	21.1.2016
Sasha Boganoviq kundër i republika.mk	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4 dhe 13.	21.1.2016

Sasha Boganoviq kundër i evesti.mk	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4 dhe 13.	21.1.2016
Sasha Boganoviq kundër fox.mk	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4 dhe 13.	21.1.2016
Sasha Boganoviq kundër denesen.mk	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4, 10 dhe 13.	21.1.2016
Sasha Boganoviq kundër vistina.mk	Raportim jo i saktë, shpifje, publikimi i të dhënave personale, mos kontaktimi i palës së dytë, diskriminim	Ankesa është e pabazë	21.1.2016
Institucioni Publik Shëndetësor Veles kundër plusinfo.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, dezinformim, përhapje e gënjeshtreve, cenimi i reputacionit	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 3 dhe 4.	21.1.2016
Angella llievska kundër netpress.com.mk, press24.mk, kurir.mk dhe vistina.mk	Diskriminim	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 7, 10 dhe 13.	30.12.2015
Dragan Cvetkovski kundër Veçer	Raportim jo i saktë	Ankesa është e pabazë	14.12.2015
Komisioni i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë kundër puls24.mk	Diskriminim	Ankesa është e bazuar, nenet 9, 10, 11, 13 dhe 15.	03.9.2015
Filip Stojanovski kundër almakos.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, cenimi i reputacionit	Ankesa është e bazuar, neni 1.	03.9.2015
Elida Zylbeari.zhurnal.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 10, 11, 13 dhe 16.	03.9.2015
Sashka Cvetkovska kundër republika.mk	Cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 7 dhe 8.	21.7.2015
Daniell Kallajhieski kundër plusinfo.mk	Cenimi i privacisë	Ankesa është e bazuar, nenet 7 dhe 8.	21.7.2015
Jane Dimeski kundër puls24.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 13 dhe 15.	21.7.2015

Jane Dimeski kundër kurir.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 10, 13 dhe 15.	21.7.2015
Vladimir Sarafov kundër ohridsky.com	Raportim jo i saktë, cenimi i reputacionit, nderit, dinjitetit, cenimi i sigurisë	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 13.	21.7.2015
Vladimir Sarafov kundër dokaz.mk	Raportim jo i saktë, cenimi i reputacionit, nderit, dinjitetit, cenimi i sigurisë	Ankesa është e bazuar, neni 1.	21.7.2015
Transparensi Interneshenëll kundër Dnevnikut	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 3 dhe 13.	08.7.2015
Gordana Siljanovska dhe Biljana Vankovska kundër Alsat M	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Palët u pajtuan me ndërmjetësim	29.4.2015
Meri Jordanovska kundër netpress.com.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 13 dhe 16.	22.4.2015
Meri Jordanovska kundër TV Alfa	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt, nuk është kontaktuar pala e dytë	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 15 dhe 16.	22.4.2015
Meri Jordanovska kundër TV Sitel	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1 dhe 16.	22.4.2015
Kabineti i presidentit të Republikës së Maqedonisë kundër Vest	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e pabazë	21.4.2015
Jane Dimeski kundër dokaz.mk	Gjuhë e urrejtjes	Palët pajtohen me ndërmjetësim	29.4.2015
Jane Dimeski kundër press24.mk	Gjuhë e urrejtjes	Ankesa është e bazuar, nenet 10, 11 dhe 15.	22.4.2015
Jane Dimeski kundër centarnews.net	Gjuhë e urrejtjes	Ankesa është e bazuar, nenet 10 dhe 4.	22.4.2015
Lidija Bogatinova kundër maktel.mk dhe narodenglas.com	Fyerje	Ankesa është e bazuar, nenet 10, 15 dhe 16.	08.4.2015
Bojan Stanishiq kundër Veçer	Gjuhë e urrejtjes	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 10 dhe 13.	08.4.2015
Koalicioni "Të Drejtat Seksuale dhe Shëndetësore të Bashkësive të Margjinalizara" kundër TV Sitel 3	Gjuhë e urrejtjes	Ankesa është e bazuar, nenet 10, 11 dhe 15.	11.6.2015
Artan Grbi kundër almakos.com dhe lajmpress.com	Fyerje, gënjeshtëri, shpifje, urrejtje, raportim jo etik	Palët u pajtuan me ndërmjetësim	23.3.2015
Artan Grbi kundër tetovasot.com	Fyerje, gënjeshtëri, shpifje, urrejtje, raportim jo etik	Procedura mbyllet për shkak të tejkalimit të afateve të Rregullores	08.7.2015
Artan Grbi kundër emisionit "Milenko Nedellkovski show""	Fyerje, gënjeshtëri, shpifje, urrejtje, raportim jo etik	Procedura mbyllet për shkak të tejkalimit të afateve të Rregullores	08.7.2015

OSBE kundër TV Sitel	Gjuhë e urrejtjes	Ankesa është e bazuar, nenet 10 dhe 11.	23.3.2015
Keti Geteva kundër maktel.mk	Gjuhë e urrejtjes	Ankuesi e tërhoqi ankesën	23.3.2015
Vasko Magleshev kundër centarnews.net	Cenimi i privacisë	Jashtë kompetencave-ka të bëjë me Fejsbukun	02.4.2015
Jane Dimeski kundër kurir.mk	Gjuhë e urrejtjes	Ankesa është e bazuar, nenet 10, 13 dhe 15.	10.3.2015
Vladimir Vangellov kundër kurir.mk dhe puls24.mk	Diskriminim	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 10 dhe 13.	23.2.2015
Vladimir Vangellov kundër republika.mk, kurir.mk dhe netpress.com.mk	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa hidhet poshtë për shkak të vonesës	30.1.2015
Marjan Nikollovski kundër lokalno.mk	Gjuhë e urrejtjes, diskriminim	Ankesa është e pabazë	30.1.2015
Marjan Nikollovski kundër okno.mk	Gjuhë e urrejtjes, diskriminim	Ankesa është e pabazë	30.1.2015
Marjan Nikollovski kundër libertas.mk	Gjuhë e urrejtjes, diskriminim	Ankesa është e pabazë	30.1.2015
Marjan Nikollovski kundër Brif.mk	Gjuhë e urrejtjes, diskriminim	Ankesa është e pabazë	30.1.2015
Marjan Nikollovski kundër plusinfo.mk	Gjuhë e urrejtjes, diskriminim	Ankesa është e pabazë	30.1.2015
Marjan Nikollovski kundër a1on.mk	Gjuhë e urrejtjes, diskriminim	Ankesa është e pabazë	30.1.2015
Marjan Nikollovski kundër novatv.mk	Gjuhë e urrejtjes, diskriminim	Ankesa është e pabazë	30.1.2015
Shoqata e Intelektualëve Shqiptarë kundër kumanovskimuabeti.mk	Diskriminim	Procedura mbyllet për shkak të tejkalimit të afatave të Rregullores	30.3.2015
Народен правобрандхетел на Републдека Македондхеја протдhev republika.mk, press24.mk, kurir.mk, puls24.mk	Diskriminim	Ankesa është e pabazë 7, 9 dhe 10.	30.1.2015
Radmilla Shekerinska kundër kurir.mk dhe mediae tjera	Raportim jo i saktë dhe jokorrekt	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 4, 10, 13 dhe 15.	18.12.2014
Borjan Jovanovski kundër TV Kanaë 5	Informim jo i saktë, cenimi i integritetit profesional	Ankesa është e bazuar, nenet 10, 13 dhe 16.	18.12.2014
Branko Geroski kundër TV Kanal 5	Fyerje, shpifje, cenimi i reputacionit	Ankesa është e pabazë, nenet 10, 11 dhe 16.	18.12.2014
Borjan Jovanovski kundër republika.mk		Vendimi është i njëjtë si te ankesa e Lidija Dimovës për republika.mk	

Lidija Dimova kundër republika.mk	Raportim jo i saktë, cenimi i reputacionit, cenimi i sigurisë	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 10 dhe 13.	01.12.2014
Ksenofon Ugrinovski kundër Sllobodен Peçat	Raportim jo i saktë, nuk është kontaktuar pala e dytë	Ankesa është e bazuar, nenet 1, 10 dhe 13, neni 1.	01.12.2014
Ivan S. Mirçevski kundër proverkanafakti.mk	Shpifje	Mendim- jashtë kompetencave të KEMM, ka të bëjë me blog	29.10.2014

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски“, Скопје

342.72/.73:[316.77:174.4(497.7)

ТАХИРИ, Сефер

Известување во интерес на јавноста : заштита на етничките принципи на известувањето низ работата на Комисијата за жалби и поплаки / [Сефер Тахири и Мирче Адамчевски]. - Скопје : Совет за етика во медиумите на Македонија, 2017. - 90 стр. : илустр. ; 21 см

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-65978-3-2

1. Адамчевски, Мирче [автор]

а) Човекови права и слободи - Новинарско известување - Етички аспекти - Македонија б) Етика во новинарството - Македонија в) Етика - Медиуми

COBISS.MK-ID 103386890